

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI XI (XXV) 2023, NR. 37 (190)

Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare

www.zaninalte.al

Tiranë, 2023

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI XI (XXV), qershor - dhjetor 2023 nr. 37 (190)

Nën kujdesin e: H. Bujar Spahiu

Drejtor: Dorian Demetja

Kryeredaktor: Andrin Rasha

Bordi editorial: Prof. Dr. Gjergj Sinani, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, Universiteti Bedër
Dr. Skender Bruçaj, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
PHD. Cand. Elton Karaj, Universiteti Bedër
H. Jusuf Zimeri, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut
MA. Ramadan Shkodra, Bashkësia Islame e Kosovës

Redaktor: Andrin Rasha
Mehmet Disha

Në anglisht: Redaksia

Zani i Naltë

Bordi shkencor: Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati
Prof. Asc. Dr. Saimir Shatku, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Prof. Asoc. Tidita Abdurrahmani, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Prof. Asoc. Dr. Majlinda Peza-Perriu, Universiteti “Al. Xhuvani”, Elbasan
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Ana Uka, Universiteti Bedër
Dr. Agron Tufa, Zvicër
Dr. Ardian Muhaj, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike
Dr. Atakan Derelioglu, SHBA
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Ilirjana Kaceli, Universiteti Bedër
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, Universiteti Bedër
PHD. Cand. Hysni Skura, Universiteti Bedër
MS/MA Fatos Kopliku, Washington DC, SHBA
MA. Sabri Bajgora, Instituti për Hulumtëme dhe Studime Islame, Prishtinë
Msc. Lorela Shehu, Universiteti Florida
H. Resul Rexhepi, Prishtinë
Xhemal Balla, Tiranë

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi / Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Erzen Carja

Fotoja në kopertinë: Godina e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, viti 1938

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50, Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al

Web: www.zaninalte.al

Përmbajtja

Editorial

1. Një shekull “Zani i Naltë”, **Msc. Andrin Rasha** 07

Shkenca Islame

2. Burimet themelore të fesë dhe qytetërimit islam, **Prof. dr. Qazim Qazimi** .. 13

Studime

3. 100 vjet “Zani i Naltë”, **Ramadan Shkodra** 31
4. Xhamia e Namazgjasë dhe rrugëtimi për ndërtimin e saj, **Ma. Dorian Demetja**
..... 36

Histori

5. Xhamia e Qyrjanit institucioni i parë islam në trevën e Krajës, **Hamid Alaj** ... 44

Filozofi

6. Filozofia islame, **Msc. Ana Gjeçi** 61

Përkthime

7. Qëndrimet e autoriteteve të hershme hanafite për imametin, **Msc. Haki Sahitaj** 75

Jurisprudencë

8. Liria e ndërgjegjes dhe besimit, sipas parimeve dhe konventave ndërkombëtare, **Asoc. prof. dr. Sajmir Shatku** 89

Personalitete

9. H. Mustafa Doraci “Hafizi i vogël” (1894-1974) 100

Retrospektivë

10. Lufta e jetës dhe misioni i njeriut 104

Abstracts in English 115

Rregullat e shkrimit 124



Një shekull “Zani i Naltë”

Msc. Andrin Rasha

Abstrakt

“Zani i Naltë”, tribunë e mendimit dhe opinionit mysliman shqiptar e më gjerë, e cila iu drejtua dashamirësve të leximit, studiuesve e hulumtuesve në gjuhën amtare, mbush 100 vjet që nga dita e parë e botimit. Ajo është revista e parë zyrtare e Komunitetit Mysliman Shqiptar, e themeluar nga elita myslimane e kohës pas Kongresit të Parë Mysliman Shqiptar, menjëherë pas themelimit dhe ngritjes së institucionit të Komunitetit Mysliman.

Në artikujt e saj janë trajtuar tema të rëndësishme që pasqyrojnë realitetin dhe problematikat kryesore shoqërore e arsimore. “Zani i Naltë” analizoi e diskutoi rreth problematikave më të rëndësishme të kohës si, marrëdhëniet shoqërore e familjare, emancipimi i gruas myslimane, arsimimi i fëmijëve dhe të rinjve, qëndrimi ndaj së mirës e së keqes, përzgjedhja dhe adoptimi i të mirave të qytetërimit të kohës, kundërshtimi e braktisja e veseve shoqërore, forcimi i vëllazërimit fetar dhe atij kombëtar, të gjitha këto në përputhje me normat, etikën dhe kulturën islame e kombëtare.

Duhet pasur parasysh se kjo revistë, pavarësisht se në pamje të parë shfaqet si një revistë me tematikë fetare, në të u shkruan e botuan tema nga fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe ato me karakter laik, me synimin e vetëm që mesazhi që ato përçonin t’i shërbente popullatës shqiptare islame në veçanti, por edhe ngritjes e lartësimit të të gjithë kombit shqiptar në përgjithësi.

Mund të themi me plot gojën se “Zani i Naltë” ishte një burim i garantuar për edukimin fetar islam të kombit shqiptar, pa lënë mënjanë edhe të ushqyerit e tij me ndjenjat e patriotizmit dhe të ngritjes kulturore e arsimore.

Zani i Naltë, tribunë e mendimit dhe opinionit mysliman shqiptar e më gjerë, e cila iu drejtua dashamirësve të leximit, studiuesve e hulumtuesve në gjuhën amtare, mbush 100 vjet që nga dita e parë e botimit.

“Zani i Naltë” është revista e parë zyrtare e Komunitetit Mysliman Shqiptar, e themeluar nga elita myslimane e kohës pas Kongresit të Parë Mysliman Shqiptar, menjëherë pas themelimit dhe ngritjes së institucionit të Komunitetit Mysliman.

Duke pasur parasysh ngjarjet e fillimit të shekullit XX, si dhe gjendjen e kombit dhe popullit shqiptar, duhet vlerësuar lart pozicionimi dhe përpjekja e elitës myslimane shqiptare për bashkimit e popullit, pa ndasi, me qëllimin e lartë të mbrojtjes së lirisë, identitetit dhe trojeve të këtij populli të lashtë autokton.

Kjo elitë myslimane, e shoqëruar edhe nga elita fetare përfaqësuese e feve të tjera, punoi fort që të mbante zgjuar e ta shtonte atë frymë të dashurisë kombëtare e të vëllazërisë ndër shqiptarët, me synimin e lartë të mbrojtjes së të drejtave të popullsisë shqiptare, kudo që ndodhej, brenda trojeve shqiptare, dhe, mbi të gjitha, për arritjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe ngritjen e mbarëvajtjen e një shteti të ri të konsoliduar dhe me vizion të qartë për të ardhmen.

Ishin këta hoxhallarëve të urtë, të ditur e të mençur, me në krye Haxhi Vehbi Dibrën, që morën mbi supet e tyre fatet e kombit shqiptar.

“...Nëse gjatë historisë në flamurin tonë është pranuar figura e njohur (shqiponja) dhe duke marrë parasysh se tash beqja e kësaj figure prish bashkimin dhe shkakton përçarje dhe fesat (çrregullim) dhe nga kjo ka shumë mundësi, që edhe vendi të pësojë disa rreziqe; pra, me qëllim për të ruajtur bashkimin e popullit dhe për të ndaluar mosmarrveshjet dhe inatet dhe me qëllim që të sigurohet qetësia e përgjithshme, figura e përmendur (shqiponja) a duhet lënë siç është? Duhet.

Kjo fetva është dhënë në bazë të Sheriatit dhe sipas nevojës së kohës dhe vendit... Të veprojmë sipas fetvasë së sipërme dhe të drubemi se mos e hedhim vendin në ndonjë greminë shkatërronjëse...

Nga ju që jeni personalitetet e rralla, të pajisur me dituri, priten shërbime dhe çdo lloj përpjekje, që të bashkuar në mendime dhe veprime me njëri tjetrin dhe të bashkuar e nën udhëheqjen e qeverisë së re, e cila është një dburatë e Perendisë, të shfaqemi ... para botës politike dhe kesisoj të rrisim dhe të sigurojmë opinionin politik në favorin tonë.”¹

Në këtë aspekt, vendimmarrja për themelimin e Komunitetit

1. AQSH., Rsh., Fondi, Qeveria e Përkohshme e Vlorës, Dosja III, 5/2, fleta nr. 632, kopja e fetvasë mbajtur në Vlorë nga Kryemyftiu, H. Vehbi Dibra, viti 1912. H. Vehbi Dibra (1867-1937)-Kryetari i parë i Parlamentit (Pleqësisë) më 1912, si dhe kryetari i parë i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (1923-1929).

Mysliman Shqiptar ishte, njëkohësisht, kërkesë e besimtarëve për mbrojtjen e identitetit të tyre, përmbushje e realitetit shpirtëror e moral të kësaj popullate, si dhe ishte përmbushje e një ëndrre dhe një element shtesë i shtetësisë së myslimanëve shqiptarë.

Pra, në ato momente kthesash të mëdha historike për vendin dhe kombin tonë, këta burra vizionarë gjetën kurajën për të udhëhequr e organizuar jetën e besimtarëve myslimanë shqiptarë, në momente tepër delikate, si ai i shkëputjes e pavarësimit të jetës islame shqiptare nga Shejhul-Islami i Stambollit. Kjo u pasua edhe me ngritjen e institucioneve mbikëqyrëse të përditshmërisë së myslimanëve shqiptarë, si Këshilli i Naltë i Sheriatit, Medreseja e Tiranës, revista “Zani i Naltë”, etj.

Komuniteti Mysliman Shqiptar mori përsipër mbikëqyrjen dhe shtimin e botimit të literaturës së domosdoshme në gjuhën shqipe, duke i mëshuar fort konceptit të mësimit dhe shpjegimit të fesë në shqip, gjë që ndikoi gjerësisht në kultivimin dhe praktikimin e jetës fetare në përditshmërinë e besimtarëve shqiptarë, marrëdhënien e tyre me Zotin e adhurimin ndaj Tij, si dhe bashkëjetesën e harmoninë mes myslimanëve e po ashtu edhe me vëllezërit e motrat e tyre shqiptarë me përkatësi tjetër fetare.

Komuniteti Mysliman, me H. Vehbi Dibrën në krye, ka luajtur një rol të rëndësishëm në vetëdijesimin kombëtar shqiptar. Për të feja dhe kombi kanë qenë dhe janë të pandashëm, prandaj një besimtar mysliman nuk mund të jetë i tillë nëse nuk është atdhetar i mirë.

“...Kemi vllazën edhe një vllazni kombtare të gjithë elementeve q'i gjinden në atdhenë të dashtun t'onën qi këjo vllazni jo se asht vetëm me fjalë, po i madhi Zot në “Kur-ani Qerim” këtë vllazni e vërteton e thotë: ‘...qi këto profet të naltë jo se ishin në kombin e vet me një fe, po ishin vllazën atdheje...’ Këjo vllazni asht një vllazni atdhetare e kështu dhe ne si tham sipri këtë vllazni lypset t'a forcojm e t'a sigurojm.”²

Guximi i treguar nga elita udhëheqëse e Komunitetit Mysliman për themelimin dhe botimin e një reviste të nivelit të “Zani i Naltë” ishte argument i qartë i përgatitjes së tyre fetare e didaktike, si dhe largpamësisë e vizionit që shpalosnin për përballimin e misionit të lartë të shpalljes dhe lartësimit të Fjalës së Zotit, e gjithashtu shërbimit të vendit e popullit shqiptar.

Duhet vënë theksi se që në numrin e parë të “Zani i Naltë”, në kopertinë, shkruhej: “Zani i Naltë”, *revistë fetare, merret edhe me fillosofi, moral, literaturë kombëtare, sociologji*, një tregues i qartë i misionit që

2. Revista “Zani i naltë”, nr. 1, V. I, Tetor 1923, *Hytbeja e parë*, f. 10-13. (Bëhet fjalë për hytben e Myftiut të përgjithshëm, H. Vehbi Dibra.)

do të merrte përsipër kjo revistë, e gjithashtu edhe përkufizues i larmishmërisë së përmbajtjes dhe pasurisë së tematikave të saj në shumë fusha studimi.

Pra “Zani i Naltë”, nëpërmjet programit të saj, synon: “...*Me i a zbulue popullit mysliman shqiptar të vërtetat e besimit në një mënyrë të thjeshtë e të panerlikume..., si dhe me plotsue vllaznin ndërmjet të gjith elementeve në Shqipëni.*” E gjitha kjo me qëllimin kuptimplotë për “*Me forcue themelet e një politikës së shëndoshtë e thjesht kombëtare në Shtetin t'onë.*”³

Revista “Zani i Naltë” ka pasur një jetëgjatësi relativisht të gjatë, pasi botimi i saj ka zgjatur nga viti 1923 deri më 1939, periudhë në të cilën Shqipëria, ashtu sikurse edhe e gjithë bota, hyri në një fazë tjetër historike, atë të Luftës së Dytë Botërore. Në këtë revistë, gjatë gjithë viteve të botimit të saj vërehen tonet patriotike, vëllazëruese dhe atdhetare të bashkëpunëtorëve të saj, të cilët lanë gjurmë të pashlyera me anë të hulumtimeve dhe shkrimeve të tyre. Pikërisht për arsyet e sipërpërmendura, mund të themi me plot gojën se “Zani i Naltë” ishte një burim i garantuar për edukimin fetar islam të kombit shqiptar, pa lënë mënjanë edhe të ushqyerit e tij me ndjenjat e patriotizmit dhe të ngritjes kulturore e arsimore.

3. Revista “Zani i naltë”, nr. 1, V. I, Tetor 1923, *Parathanë e qellim*, f. 5-6.

Në muajin tetor të vitit 1923, doli nga shtypi numri i parë i kësaj reviste, nën drejtimin e Ismail Maçit, i cili u pasua nga figura të tjera si, Shyqyri Myftiu, Isa Domni, Haki Sharofi, të njohur si përfaqësues të elitës së kohës së tyre, të pajisur me kulturë të gjerë, si në shkencat islame, po ashtu të edhe në ato sociale, të cilët, së bashku me elitën e artikullshkruesve, mundësuan që revista “Zani i Naltë” të pozicionohej në qendrën e vëmendjes së të gjitha shtresave intelektuale të kohës, e të mbetej edhe sot e kësaj dite një burim i çmuar informacioni.

Përgjatë 16 viteve të aktivitetit të saj, ajo përfshiu në gjirin e saj një shumëllojshmëri artikujsh, që sot janë dëshmi e qartë jo vetëm e trashëgimisë së pasur kulturore që ajo la pas, por, gjithashtu, edhe e nivelit të lartë të mendimit teologjik e social shqiptar të asaj periudhe.

Për elitën e shquar të asaj kohe, penat e “Zani i Naltë”, lumturia e vendit dhe e kombit arrihet nëpërmjet pavarësisë dhe qytetërimit, vëllazërisë dhe zhvillimit; dhe këto mund të arrihen me anë të dashurisë dhe përkushtimit ndaj atdheut, si dhe me dashurinë e respektin ndaj njëri-tjetrit, myslimanë, të krishterë, ortodoksë apo edhe të tjerë qofshim.

“Zani i Naltë”, nëpërmjet artikujve të saj, nuk i drejtohet vetëm besimtarëve myslimanë, por, në realitet, i drejtohet të gjithë shqiptarëve, brenda dhe jashtë

kufijve të Shqipërisë, për të dhënë kontributin e tyre në shërbim të dashurisë dhe paqes, për të dhënë mesazhet e forcimit të dashurisë ndaj vendit dhe kombit shqiptar.

Duhet pasur parasysh se kjo revistë, pavarësisht se në pamje të parë shfaqet si një revistë me tematikë fetare, në të u shkruan e botuan tema nga fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe ato me karakter laik, me synimin e vetëm që mesazhi që ato përçonin t'i shërbente popullatës shqiptare islame në veçanti, por edhe ngritjes dhe lartësimit të të gjithë kombit shqiptar në përgjithësi.

Në artikujt e revistës janë trajtuar tema të rëndësishme që pasqyrojnë realitetin dhe problematikat kryesore shoqërore e arsimore. “Zani i Naltë” analizoi e diskutoi rreth problematikave më të rëndësishme të kohës si, marrëdhëniet shoqërore e familjare, emancipimi i gruas myslimane, arsimimi i fëmijëve dhe të rinjve, qëndrimi ndaj së mirës e së keqes, përzgjedhja dhe adoptimi i të mirave të qytetërimit të kohës, kundërshtimi e braktisja e veseve shoqërore, forcimi i vëllazërimit fetar dhe atij kombëtar, të gjitha këto në përputhje me normat, etikën dhe kulturën islame e kombëtare.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, duke pasur parasysh vlerën e madhe dhe pozitën e lartë që “Zani i Naltë” gëzon, vendosi të rifillojë botimin e saj në tetor të vitit 2012, ku si kryeredaktor i

saj u emërua z. Genti Kruja, dhe së bashku me bashkëpunëtorët e revistës mundësoi ringjalljen e kësaj tribune të mendimit islam shqiptar dhe jo vetëm. Revista “Zani i Naltë” përfshin artikuj të shumëllojshëm, në të cilët bëhen trajtime akademike të temave të ndryshme të shkencave islame, por edhe ato të fushave të tjera shkencore, duke e bërë atë pasardhëse plot dinjitet të revistës me të njëjtën titull të botuar në vitin 1923.

“Revista ‘Zani i Naltë’, është tribuna, ku shpalosen njohuritë e personaliteteve akademike nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, viset e tjera shqiptare dhe bota, në fushën e teologjisë islame, si në jurisprudencë islame, fikh, tefsir, hadith, ashtu edhe në shkencat shoqërore, si sociologji, filozofi, psikologji, histori, etj. Në çdo numër të saj, ajo boton nga një personalitet shqiptar të kulturës islame, i cili ka lënë gjurmë në historinë e vendit tonë për kontributet e vyera në shumë fusha të jetës, në shërbim të Islamit dhe Atdheut, në të njëjtën kohë, ajo sjell para lexuesit shqiptar ribotimin e një artikulli të zgjedhur nga numrat e vjetër të revistës “Zani i Naltë”.⁴

Vlen të theksohet se në vitin 2015, nën mbikëqyrjen

4. Faik Luli – Islam Dizdari, *75-vjetori i botimit të revistës “Zani i Naltë”*, gazeta “Drita Islame”, nr. 23 (154), viti i VII i botimit, dhjetor 1998, f. 6.

e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe me bashkëpunimin e tri bashkësive islame, Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, u bë e mundur që, për herë të parë, të grumbulloheshin në një botim të vetëm të gjithë numrat e revistës “Zani i Naltë” (1923-1939), në 10 vëllime, që përfshijnë 150 numra të revistës “Zani i Naltë” të përmbledhur në rreth 5000 faqe, të ruajtura në origjinalitetin e tyre.

Revistës “Zani i Naltë”, me rastin e 95-vjetorit të themelimit të

saj, më 28 mars 2018, iu akordua nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z. Ilir Meta, titulli “Naim Frashëri” me motivacionin: “*Në vlerësim të kontributit të saj të gjithanshëm në promovimin e dijes, historisë dhe besimit, duke u ofruar gjithë besimtarëve, krabas dijeve fetare, edhe mesazhe atdashedashurie, paqeje e mirëkuptimi në dobi të harmonisë dhe bashkëjetesës fetare mes shqiptarëve.*”.

Me shpresë dhe mbështetje te Zoti i Madhërisëm, i urojmë revistës “Zani i Naltë” jetë të gjatë dhe suksese të mëtejshme në përmbushjen e misionit të lartë që mbart mbi supet e saj.

Burimet themelore të fesë dhe qytetërimit islam

KUR'ANI burim themelor i fesë dhe i qytetërimit islam
Prof. dr. Qazim Qazimi

Abstrakt

Kur'ani është fjalë hyjnore, ligjërimit i Allahut, libër qiellor, i mrekullueshëm, i paimitueshëm i paarritshëm as në përmbajtje e as në aspektin artistik, pra është "Mu'xhizetun" që i është zbritur Muhamedit (a.s.) përmes Xhibrilit, i përcjellë besnikërisht nga ai, i shkruar që atëherë kur zbriti, i tubuar në një përmbledhje të quajtur "Mus'haf", i ruajtur, i kultivuar e i mësuar përmendësh, dhe leximi i tij është adhurim-ibadet për myslimanët.

Si një vepër hyjnore e shenjtë që është, Kur'ani ka një estetikë të mrekullueshme dhe ndikim emocional mbi myslimanët që e lexojnë apo e dëgjojnë prozën e tij poetike. Madje edhe jomyslimanët janë impresionuar thellësisht nga përkryeshmëria e tij letrare dhe perfeksionimi i paimitueshëm i tij.

Kur'ani nuk është vepër e ndonjë poeti apo artisti. Ai është Fjalë e Zotit, andaj edhe është i përkryer e i mrekullueshëm. E tëra kjo që u tha, është e nevojshme të parashtrohet për t'i mundësuar lexuesit të kuptojë arsyet e stilit të fuqisë magjike të Kur'anit, fuqi që, për fat të keq, asesi lexuesi nuk mund ta ndiejë në përkthim, sado i mirë që të jetë ai.

Duke pasur parasysh vlerat e shumëfishta dhe temat e Kur'anit, që nga ato fetare e shpirtërore, filozofike e sociale, teorike e praktike e deri tek ato shprehimore artistike, është me interes për kulturën islame në përgjithësi, që të zotët e mendjes dhe të penës, të bëjnë më shumë në ndriçimin e vlerave stilistike të Kur'anit, ngase edhe këtu del në shesh mrekullia e shprehjes artistike të Kur'anit dhe pamundësia e imitimit të vlerës estetike të tij.

Kur'ani është libri i fundit qiellor që i zbriti Profetit të fundit, Muhamedit (a.s.), prej Allahut nëpërmjet Xhibrilit. Ai është libri u shenjtë, i mbinatyrshëm-(mu'xhizetun) ligjërim-fjalë e Allahut që i erdhi Muhamedit (a.s.) në mënyrë kronologjike në një periudhë prej 23 vjetësh. Përmban gjithsej 114 sure-kaptina dhe për numrin e tyre nuk ka mospajttime mes dijetarëve. Sa i përket numrit të ajeteve në Kur'an, ekzistojnë mendime të ndryshme mes dijetarëve. Të gjithë ata, pa përjashtim, pajtohen se Kur'ani ka mbi 6000 ajete. Por në mesin e tyre, dikush është dëgjuar të ketë thënë se Kur'ani ka 6204, dikush 6214, ndonjë tjetër 6219, por edhe 6225, 6226, 6236, e 6360 ajete.¹ Shkaku i mos pajtueshmërisë rreth numrit të ajeteve të Kur'anit është se dikush ka numëruar ajetin fillestar: **بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ - Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit**", si ajet përbërës i çdo sureje, por, ka të tjerë, që këtë ajet e kanë numëruar si një ajet i vetëm i sures "En-Neml" e, nga ndonjë tjetër, ajeti në fjalë; (**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit**) është llogaritur si ajet fillues i çdo sureje.

1. El-Imam El-Hafidh Imadud-din Ebu El-Fida' Ismail Ibn Kethir El-Kurejshij, Ed-Dimeshkij, "*Tefsijru El-Kur'ani El-Kerim*", pjesa e parë, f. 7, "Daru El-Hadith", Kajro, 1993/1414 h.

Ekziston edhe një shkak tjetër, që ka bërë që dijetarët të mos kenë mendim unik në lidhje me ajetet e Kur'anit, që ka të bëjë me shkurtesat në fillim të sureve të cilat disa i kanë numëruar si ajete më vete, e të tjerë nuk i kanë numëruar si të tilla. Sado që të jenë numri i ajeteve të Kur'anit, nuk ka dyshim se ai është burimi themelor dhe kryesor i fesë dhe predikimit islam.

Sipas përkufizime të dijetarëve myslimanë, Kur'ani është fjalë hyjnore, ligjërim i Allahut, libër qiellor, i mrekullueshëm, i paimitueshëm i paarritshëm as në përmbajtje e as në aspektin artistik, pra është "*Mu'xhizetun*" që i është zbritur Muhamedit (a.s.) përmes Xhibrilit, i përcjellë besnikërisht nga ai, i shkruar që atëherë kur zbriti, i tubuar në një përmbledhje të quajtur "Mus'haf", i ruajtur, i kultivuar e i mësuar përmendësh, dhe leximi i tij është adhurim-ibadet për myslimanët.²

Kur'ani-Mus'hafi nis me suren "*El-Fatiba*" dhe përfundon me suren "*En-Nas*".

Kur'ani është ligjërim-fjalë e Allahut e jo e Muhamedit (a.s.), siç ka pretenduar ndokush dhe, mu këtu qëndron pamundësia e imitimit të Kur'anit, mrekullia dhe përkryeshmëria e tij.

2. Es-Salih, Dr. Subhi, "*Mebabitbu fi Ulumi El-Kur'an*", f. 21, botimi i pestë, Bejrut, 1968. Shih, Es-Sabunij, Muhammed Alij, "*Et-Tibjan fi Ulumi El-Kur'an*", botimi dytë f. 6, 1980/1400 h., pa vend botimi.

Komentuesit klasik të Kur'anit “*T’xhazin*”, pamundësinë e imitimi të Kur'anit, e shohin në përmbajtjen, formën dhe në stilin e shprehjes së Kur'anit, në shprehjen artistike të paarrtshme të Kur'anit. Komentuesit bashkëkohorë janë të prirë që nën ndikimin e komentimit shkencor të Kur'anit, “*T’xhazin*”, pra pamundësinë e imitimit, ta shohin, ndër të tjera, në parapritjen e Kur'anit ndaj zbulimeve shkencore kozmologjike, gjeologjike, astronomike, atmosferike, hidrologjike, gjenetike, embriologjike, gjeografike, historiografike, etj.

Kur’ani është Fjala e Allahut, përmes të cilit Ai adhurohet deri në Ditën e Kiametit. Ai është autokton, nuk ndryshon, nuk transformohet dhe nuk zëvendësohet asnjë fjalë e vetme e tij me diçka tjetër. Duhet pasur kujdes ngase është shumë e rrezikshme që të bëhet lidhja e Kur’anit me disa teori shkencore jo të vërtetuara shkencërisht. Ndodh, shpeshherë, që teoritë shkencore të mos jenë të sakta dhe të nivelit shkencor. Kjo mundëson që të bëhemi shkaktarë për një gabim të pafalshëm ndaj njollosjes së Kur’anit, duke provuar harmonizimin e ajeteve të Kur’anit me teori të pavërtetuara.

Është realitet i pamohueshëm se Kur’ani përmend disa mrekulli që shkenca ende nuk ka arritur t’u japë shpjegime meritore. Kur’ani është një libër që prin në dituri e shkencë

dhe sfidon mbarë dituritë njerëzore. Ai është i tëri mrekulli.

Kur’ani ishte dhe vazhdon të qëndrojë deri në pafundësi si mrekulli e përhershme dhe e pashterueshme. Kur’ani i tëri është mrekulli dhe ai ka më shumë se një mrekulli dhe ato janë të natyrës e fushave ndër më të ndryshmet. Mrekullia e Kur’anit manifestohet në shumë sfera; si në shpalljen e tij, në ligjërimin e tij, në nxënien e tij, në ruajtjen e tij, në vlerat e tij sublime; fetare e shpirtërore, morale e humanitare, ekonomike e sociale, materiale e shkencore.

Meqenëse ligjërimi kur’anor i takon një instance krejt tjetër nga ajo njerëzore, me attribute hyjnore, është shumë vështirë të përcaktohet me leksikun, terminologjitë dhe nocionet e njohura të stilistikës gjuhësore, qoftë edhe asaj arabe, ngase ato në çdo gjuhë, janë të mangëta dhe nuk i përfshijnë veçoritë e këtij ligjërimi hyjnor në tërësi. Kur’ani është i vetmi prej librave qiellorë që nuk ka pësuar ndryshime dhe ka ruajtur origjinalitetin e vet.

Meqë Kur’ani është Fjalë e Allahut, i tëri është pastërti dhe gjithnjë kërkon pastërtinë e shpirtit, pastërtinë e mendimit, pastërtinë e veprimit e motiveve dhe qëllimeve për ata që dëshirojnë të depërtojnë në përmbajtjen e tij të thellë. Sa më e madhe të jetë pastërtia shpirtërore dhe fizike e atij që e studion Kur’anin, aq më i thellë dhe më i qartë do të jetë vëllimi i të kuptuarit domethënies së tij.

Kur'ani i është dedikuar mbarë njerëzimit. Ai nuk pranon racizëm, nuk njih kufi kohor e hapësinor të shtrirjes së tij. Por është realitet se Kur'ani nuk i referohet të pabesëve, shpirtligjve, zemër-mbyllurve, anormalëve, injorantëve, etj. Studiuesit e Kur'anit, patjetër, duhet të çlirojnë shpirtin dhe mendjen e tyre nga paragjykimet dhe ideologjitë e ndryshme ideologjike e ateiste, në mënyrë që ta kuptojnë Kur'anin drejt e si duhet.

Për ta mësuar e njohur Kur'anin nuk mjafton vetëm trashëgimia apo përcaktimi fetar, dëshira apo vullneti sa për të lexuar diçka. Për ta lexuar, kuptuar e përjetuar Kur'anin e Madhërisëm, duhet qenë besëmadh, shpirtndritur, zemërdëlirë, mendjehollë e i ditur, por edhe truplarë e i pastër. Në Kur'an thuhet:

وَيَرَى الَّذِينَ أَوْتُوا الْعِلْمَ الَّذِي أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ هُوَ الْحَقُّ وَيَهْدِي إِلَى صِرَاطٍ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ

“E, atyre që u është dhënë dituria, e dinë se ai që të është shpallur ty nga Zoti yt (Kur'ani), është i vërtet dhe udhëzon për në rrugën e Fuqiplotit, të Lavdishmit”³

Kur'ani ka zbritur në një interval kohor prej 22-23 vjetësh, që ka filluar me 1 shkurt të viti 610 me ajetin: **“Lexo në emër të Zotit tënd i Cili ka krijuar”⁴**, për të mbaruar në vitin 632 me ajetin 281 të sures EL-Bekare

3. Kur'ani, Sebe', 34:6.

4. Kur'ani, El-Alek, 96:1.

e ky (sipas mendimet të shumicës së dijetarëve) është ajeti:⁵

وَاتَّقُوا يَوْمًا تُرْجَعُونَ فِيهِ إِلَى اللَّهِ ثُمَّ تُوَفَّى كُلُّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ

“Dhe keni frikë Dītën, kur në të do ktheheni tek Allahu. Pastaj çdokush do të paguhet për atë që ka fituar, dhe atyre nuk ju bëhet e padrejtë”⁶

Tubimi dhe ruajtja e Kur'anit gjatë jetës së Muhamedit (a.s.) bëhej në dy mënyra:

1. Kur'ani vilej dhe ruhej në trurin e besimtarëve, d.m.th. duke e nxënë atë përmendsh dhe ka pasur me qindra hafizë që kishin mësuar Kur'anin përmendësh, gjatë jetës së Muhamedit (a.s.) Mësimi i Kur'anit përmendësh vazhdon edhe sot, madje edhe në mesin e shqiptarëve ka pasur, e ka edhe sot hafizë (njerëz që e dinë tërë Kur'anin përmendësh në gjuhën arabe).

2. Kur'ani vilej dhe ruhej edhe duke e shkruar. Zejd Ibn Thabit ishte shkruer i trefishtë i Kur'anit. Ai shkroi Kur'anin gjatë kohës së Profetit (a.s.), tuboi Kur'anin në një përmbledhje gjatë hilafetit dy vjeçar të Ebu Bekrit r.a., prej viti 11-13 h. (632/634) dhe mori pjesë në shumëfishimin e Mus'hafeve gjatë hilafetit të Uthmanit r.a. në vitin 25h.⁷

5. Shih: Ebi El-Hasen Alij Ibni Ahmed El-Uahidi En-Nisaburi, “*Esbabu En-Nuzul*” botim i ri, f. 8, “Daru El-Fikri”, Bejrut-Liban, 1994 / 1414 h.

6. Kur'ani, El-Bekare, 2:281.

7. Es-Salih, Dr. Subhi, *Mebabith fi Ulumi El-Kur'ani*, f. 83, botimi i pestë, Bejrut, 1968.

Kur'ani është shkruar që nga fillimi i shpalljes, prandaj nuk është e çuditshme e dhëna se me shkrimin e Kur'anit dhe regjistrimin e tij, gjatë periudhës së zbritjes, ishin angazhuar jo më pak se 43 veta në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vetë Pejgamaberi (a.s.) dhe tubimi i tij u bë sa qe gjallë Profeti (a.s.)⁸ Kur'ani është tubuar në një libër që e kanë emërtuar “*Mus’haf*”. E, Mus’hafit është përmbledhje e Kur'anit, shpalljes (revelatës) hyjnore që i ka ardhur Muhamedit (a.s.) nëpërmjet Xhebrailit (a.s.)

Edhe një kritik i egër si z. William Muir, kur vjen fjala për Kur'anin e Shenjtë, thotë:

*“Nuk ka në botë asnjë libër tjetër që ka mbetur kaq i pastër në tekst për dymbëdhjetë shekuj.”*⁹

a. Përmbajtjet themelore të Kur'anit

Kur'ani është burimi themelor dhe kryesor i fesë, predikimit dhe qytetërimit islam. Baza kryesore e Kur'anit është me përmbajtje dhe karakter moral edukativ, human dhe me vlera mbarë njerëzore. Mirëpo, Kur'ani paraqet edhe një kushtetutë me norma në vazhdimësi aktuale dhe universale. Ai përmban, jo

vetëm norma morale e humane, por edhe norma juridike, norma të drejtësisë ligjore, sociale, familjare, ekonomike, etj., që kanë të bëjnë me fushëveprimin dhe rregullimin e çështjeve të ndryshme jetësore të shoqërisë njerëzore në përgjithësi.

Ai përmban principet kryesore fetare, morale dhe juridike islame. Është përmbledhje e rregullave esenciale në bazë të të cilëve duhet të ndërtohet dhe zhvillohet jeta materiale e shpirtërore por, gjithsesi, edhe shoqërore e qytetare e myslimanëve. Ai përmban:

1. Nyjet themelore (kushtet e besimit) që duhet besuar pa hamendje: Besimin në Zotin që është një e s'ka tjetër, besimi në engjëjt që janë krijesa shpirtërore e pa mëkate, besimi në Profetët se janë të dërguarit e Allahut, besimi në librat (kitabët) e shpallur, që ishin dhe mbeten udhëzime për njerëzinë, besimi në Ditën e Gjykimit, kur punët vlerësohen e çmohen sipas vlerave, besimi në paracaktimin, që vjen prej Zotit.

2. Udhëzime njerëzve që të mendojnë për çdo gjë që e krijoi Zoti i gjithësisë, në qiej dhe në tokë, për t'u bindur në fshehtësitë dhe fuqinë krijuese të Zotit.

3. Ligje praktike-juridike, të cilat janë dhënë në mënyrë të prerë në Kur'an, ose janë vetëm bazat themelore, që rregullojnë marrëdhëniet e njeriut me Zotin apo të njerëzve mes tyre.

8. Ez-Zinxhani, Ebu Abdil-lah, “Tarihu El-Kur'an”, f. 42, Bejrut 1969/1388 h.

9. Sir William Muir, KCSI (27 prill 1819 - 11 korrik 1905) ishte një orientalist skocez, dijetar i Islamit, dhe administrator kolonial.

4. Normat morale, qëllimi i të cilave është të fisnikërojnë shpirtin njerëzor, ta pajisin atë me sjellje, virtyte e ideale të larta, në njëren anë, e në anën tjetër ta pastrojnë nga veset e këqija dhe dukuritë e shëmtuara.

5. Vërejtje, përgëzime, premtime e shpërblime për vepra të mira, si dhe frikësime, kërcënime e dënime në këtë botë dhe në atë të amshueshmen për punë të liga.

6. Tregime mbi popujt e tjerë, kallëzime për Profetët, rrëfime mbi ngjarje dhe ndodhi të ndryshme të feve, kulturave dhe civilizimeve të lashta.¹⁰

Kur'ani, i cili, në rend të parë, është libër hyjnor-fetar, por edhe kod moral e juridik, gëzon atë lloj autoriteti në botë, e në veçanti te myslimanët, si asnjë libër tjetër në literaturën botërore.

Kur'ani është një libër me sendërtim universal, për të cilin është folur, shkruar e studiuar shumë, por pak janë të njohura vlerat e mirëfillta artistike të tij, për shumë lexues, e edhe më pak te shqiptarët. Te Kurani duhet drejtuar jo vetëm për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Islamin, por edhe për fusha të ndryshme të dijes njerëzore, veprimtarisë dhe jetës shoqërore në përgjithësi.¹¹

10. Shih, "Kur'ani Kryevepër-Tekste të zgjedhura nga Dr. Feti Mehdiu, Dr. Hasan Kaleshi", "Kur'ani Kryevepër e Letërsisë Arabe", f. 81-82, Prishtinë 1992.

11. Më gjerësisht shih: Qazimi, Dr. Qazim, "Kur'ani dhe temat kur'anore në letërsinë shqipe", Takvimi i 1424 / 25 (Kalendari

b. Temat e Kur'anit

Nuk ka dyshim se tema kryesore në Kur'an është njeriu dhe mirëqenia e tij. Por, një nga temat e Kur'anit, me peshë dhe rëndësi të veçantë, është Udhëzimi i Allahut. Përqendrimi në faktin se Allahu i ka ofruar gjithmonë udhëzim njeriut nëpërmjet shpalljeve që ka dërguar përmes Profetëve, është detyrë e çdo besimtari. Kur'ani është përqendruar edhe në temën rreth konceptit të besimit në Një Zot të vetëm-"Teuhidit". Paraqitja e Kur'anit ishte revolucionare, ngase theu të gjitha barrierat racore, nacional-kombëtare, dhe dha një kontribut unik të bashkimit dhe të vëllazërimit të njerëzve në një komunitet shumetnik, shumëgjuhësh, multiracor, multikulturor, por me një besim të vetëm, besimin në Një Zot "Teuhid". Kur'ani e inkurajon mbarë gjininë njerëzore që të ngrejë veten mbi kufizimet provinciale, fisnore, racore, e kombëtare për të ndërtuar një komunitet, shoqëri të njerëzuar e të qytetëruar.

Temat e tjera të shtuara në Kur'an, sikundër janë temat fetare, diturore, iluministe, etiko-morale, juridike, sociale, moralizuese, kallëzimet historike, si dhe shumë përmbajtje të tjera, të trajtuara në nivel të mrekullueshëm e të jashtëzakonshëm, janë tema të paarritshme përmbajtësisht e artistikisht.

2004), Prishtinë, 2004.

Të kthehemi përsëri te Kur'ani, ngase duhet theksuar se baza kryesore përmbajtjesore e Kur'anit është me karakter shoqëror dhe duhet sinjalizuar për idetë e drejtësisë sociale-shoqërore e morale që dalin drejtpërdrejt nga Kur'ani, i cili, padyshim, synon një shoqëri të qytetëruar.

c. Tema sociale në Kur'an

Islami është një fe që, përveç themeleve kryesore të saja, që janë të bazuara në Kur'an, ndërtohet edhe mbi parimet e logjikës dhe të arsyeshmërisë dhe jo mbi dogmën apo besimin e verbër. Dhe, vetë fakti i mos ndarjes së Islamit në sfera fetare dhe jo fetare apo në pjesë të veçanta, të kësaj jete-“Dynjasë” dhe asaj të amshueshmes-“Ahiretit”, tregon se Islami është më tepër si një stil i jetës me premisa hyjnore i drejtuar tërësisht nga Allahu dhe jo një fe që merret me ndarjet apo copëzimet e jetëve. Kështu që, nga njëra anë, kur bëhet fjalë për parimet e të jetuarit, për anën sociale, ekonomike, politike, etj., të shkon mendja se Islami është një sistem i avancuar i jetës fizike, por kur bëhet fjalë për jetën shpirtërore, për moralin e individit dhe të shoqërisë, mësohet se ai është një kod që rregullon jetën materiale dhe shpirtërore, duke siguruar mirëqenie dyjetësore, në rend të parë, të individit e pastaj edhe të shoqërisë. Islami merret me

të gjitha aspektet e jetës së njeriut. Ai është kundër idesë së ndarjes së jetës shpirtërore nga ajo materiale, kundra ndarjes së jetës së kësaj bote nga ajo e përtejmeja.

Tema sociale në Kur'an merr një shtrirje të gjerë me karakter moralizues, edukativ dhe shumë universal. Iluminizmi fetar, dituria, edukimi, fenomeni moral, si kategori shoqërore, elementet përbërëse të moralit, edukimi moral i njeriut dhe i qytetarëve, ndikimi i fenomenit moral në zhvillimin e shoqërisë, kujdesi ndaj familjes si pjesë bazë e superstrukturës shoqërore, si njëra nga qelizat e para të shoqërisë njerëzore, pozita e femrës në shoqëri, nderi si kategori morale e sociale, fenomeni i pirjes së alkoolit dhe ndalimit të tij në Islam, ndalimi i përdorimit të drogës, ndalimi i lojërave të bixhozit, fenomeni i prostitucionit si dhe ndalimi e luftimi i tij, janë ato që përshkojnë tërësinë e mësimëve të Kur'anit, udhëzimeve dhe porosive të larta edukative-morale të tij në zgjidhjen e këtyre problemeve sociale-shoqërore.

Pikëpamjet sociologjike mbi lirinë personale dhe kolektive, mbi etikën dhe edukatën morale të përfuara e të ndriçuar nga dituritë dhe kultura e qytetërimi islam, paraqesin jo vetëm kontribut të çmueshëm moralizues për zhvillimin e mendimit sociologjik, por edhe përputhen me qëllimet e evolucionit njerëzor për një bashkësi e shoqëri

të qytetëruar, të pastër, të shëndoshë e të lumtur; pa alkool, pa drogë, pa bixhoz, pa prostitucion, e pa shumë të liga të kësaj natyre. Këtë e garanton pa dyshim e me shumë siguri vetëm feja islame, e madje edhe pa harxhime të mëdha.

Duke vlerësuar drejt qenien e njeriut dhe personalitetin e tij, në Islam ekziston vetëdijesimi se njeri të idealizuar e pa asnjë të metë nuk ka. Feja islame është kundër mbivlerësimit të njeriut. Përpyekjet e dikujt, që për shkak të disa vetive, virtyteve, humanizmit, devotshmërisë, a ndonjë atributi tjetër, bëjnë mbivlerësimin e madje deri në hyjnizim e njeriut, siç ndodhë me disa njerëz fetarë e personalitete të veçanta, në Islam nuk qëndrojnë. Kushdo që aludon se ka hirësi (ka shenjtëri), falë mëkate apo ndërmjetëson te Perëndia, ai është mashtrues, gënjeshtar që nuk i bënë nder shoqërisë dhe sipas fesë islame është mëkatari më i madh.

d. Disa nga vlerat artistike të Kur'anit

Të flasësh dhe të vlerësosh vlerat artistike dhe stilin e Kur'anit, është shumë punë e vështirë, sepse këtu nuk bëhet fjalë për një gjini retorike apo letrare, por për Dërgimin hyjnor, i cili është dedikuar t'u transmetohet njerëzve. Duhet ditur, se edhe nga aspekti i shprehjes artistike, Kur'ani është i

mrekullishëm. Shumëllojshmëria e trajtave të shprehjes artistike në Kur'an, ka bërë që një numër i madh i dijetarëve të fushave të ndryshme të studiojnë Kur'anin dhe të mahniten me mrekullitë e tij në fushat e ndryshme të dijes, duke i paraprirë shkencës bashkëkohore në shumë lëmi. Shoqëria islame, por jo vetëm ajo, qysh nga koha e Profetit Muhamed, është deklaruar për bindjen e pafuqisë së imitimit të Kur'anit.¹²

Theksojmë se edhe nga aspekti i shprehjes artistike, Kur'ani është i mrekullueshëm. Tek arabët, fjala artistike ka qenë prezente që nga lashtësia, domethënë edhe para Islamit. Te arabët para-islamë, poezi të shkruara, mitingje poezish dhe gara poetike ka pasur edhe para shpalljes së Kur'anit. Te arabët idhujtarë, para shpalljes së Muhamedit (a.s.) Profet, në tregun e quajtur “*Ukkadl*”, në Meke, në sezonin e haxhit organizoheshin veprimtari poetike, ku deklamoheshin poezi klasike tradicionale të zhanreve të ndryshme dhe vlerësoheshin nga ekspertë e seleksionoheshin nga mirat, shkruheshin me shkronja të arta dhe me respekt vareshin në muret e Qabes.¹³ Në këtë periudhë,

12. Më gjerësisht shih: Qazimi, Dr. Qazim, “Kur'ani dhe temat kur'anore në letërsinë shqipe”, f. 165, Takvimi 1424/25, (kalendari 2004), Prishtinë, 2004.

13. Dajf, Dr. Sheuki Dajf, “*El-Edebu El-Arabijju, Asru El-Xhabil*”, f.50, Daru El-Mearif, Kajro,1960.

kur poezia kishte arritur nivel të rëndësishëm artistik, kur ajo ishte bërë traditë, kur ajo kishte avancuar në përmbajtje dhe në planin artistik, kur ajo çmohej e admirohej nga një numër i madh përkrahësish, befasisht e në mënyrë fare të papritur, do të nisë t'i zbresë Kur'ani Muhamedit (a.s.), si një kryefjalë e shprehjes artistike, si një mrekulli me një stil tepër të lartë, i cili, përveçse nga përmbajtja dhe kuptimi që është i paarritshëm, edhe nga aspekti artistik është i pashembullt dhe, çuditërisht, do t'i mahnitë e do të heshtin, për një kohë, oratorët, ligjëruesit dhe poetët më me zë të kohës.

Njëra nga karakteristikat kryesore të Kur'anit, siç u tha, është pamundësia e imitimit të tij, as në aspektin përmbajtjesor dhe as në aspektin estetik. Kur'ani ka provokuar dhe provokon poetët përgjithësisht, e posaçërisht arabët, ata që kanë pasur fat dhe mundësi ta shijojnë përmbajtjen dhe artin kur'anor në origjinal, se po nuk besuan që Kur'ani është fjalë e Zotit, apo si thonin arabët e asaj kohe, se atë e ka trilluar dhe varguar Muhamedi, ata vetë thirren që të provojnë të shkruajnë një libër të ngjashëm me Kur'anin. Në kaptinë "Et-Tur" lexojmë edhe këtë ajet:

“Le ta sjellin një ligjërime (libër) të ngjashëm si ai, nëse kanë të drejtë (për atë që thonë)”.¹⁴
Kur nuk e bënë këtë, u kërkua prej

14. Kur'ani, Et-Tur, 52:34.

tyre që së paku të shkruajnë një sure (kaptinë) si ato të Kur'anit. Por, poetët e kohës, nuk arritën ta bëjnë asnjë sure të shkurtër të ngjashme me të Kur'anit.

e. Natyra e lartësimit artistik letrar

Është realitet i pamohueshëm se Kur'ani e sfidoi krahasimin e ndonjë pjesë të tij për nga bukuria letrare dhe, pa këtë fuqi sfiduese, s'ka dyshim se Kur'ani nuk do të mund të kishte ushtruar fuqinë e tij të jashtëzakonshme, të mrekullueshme, magjepsëse, prekëse dhe mallëngjyese. Dhe pa këtë fuqi, arabët nuk do ta kishin pranuar atë si hyjnor. Rasti i Profetisë së Muhamedit është unik, sepse ai e mbështeti vërtetësinë e pohimit të tij, në vetë hyjninë e burimit kur'anor, në fillin e bukurisë letrare.

Po ashtu është edhe realiteti tjetër se Kur'ani i theu të gjitha normat e përsosmërisë letrare që arabët kishin njohur. Çdo ajet i Kur'anit, jo vetëm që i përshtatej dhe i përmbushte normat e njohura letrare, por edhe i tejkalonte ato përtej masës. Aktualizimi i Kur'anit e tejkaloi çdo gjë që ishte njohur ndonjëherë. Kjo ishte arsyeja se përse ata e vlerësuan atë dhe e besuan të mbinatyrshëm, apo një sfidë për t'u krahasuar me diçka që nuk mund të krahasohet kurrë. Kur'ani i çarmatosi plotësisht kundërshtarët e vet. Ata e pranuan

originën e tij hyjnore dhe iu nënshtruan urdhëresave të tij.

f. Lartësimi i formës

Myslimanët iu kushtuan studimit të Kur'anit edhe në stilin e ligjërimit-bukurisë artistike dhe u përpoqën që të zbulonin sekretet e bukurisë dhe mrekullisë së tij, aspektet apo shkaqet që e bënë Kur'anin të paimitueshëm, të papërballueshëm dhe të pakrahueshëm. Shikuar nga jashtë, Kur'ani, si tërësi, lë përshtypjen e një proze të rimuar, ndërsa çereku i fundit të tij, më shumë i ngjet poezisë edhe pse nuk është poezi. Ritmi aq elastik dhe i ndryshueshëm i pjesëve të rimuara në Kur'an, nuk u nënshtrohet në asnjë mënyrë ligjeve të prozodisë arabe (Es-sexheu' - السَّجْعُ). Ibni Halduni thoshte se, Kur'ani edhe pse duket vepër e ndryshme prozaike, stili i tij del sa nga suaza e një proze të lirë (Mutllak-مطلق), po aq edhe nga suaza e prozës së rimuar (Es-sexheu-السَّجْعُ). Rima kumbuese e Kur'anit, përveçse tingëllon artistikisht, nuk ka dyshim se ajo spikat edhe përmbajtjen, duke i përcaktuar edhe përmasat kuptimore, emocionale, simbolike dhe estetike.

Duhet ditur se as nga aspekti përmbajtjesor dhe as nga aspekti estetik nuk ka kurrfarë lidhje midis poezisë para-islame dhe Kur'anit, për të cilën kundërshtarët e akuzonin Muhamedin (a.s.)

Dr. Taha Husejn, që ishte i verbër që nga lindja, hafiz i Kur'anit që në fëmijëri, shkrimtar e kritik letrar, i doktoruar në Kajro 1914, e që mori edhe një doktoraturë tjetër në Sorbonne të Francë për letërsi më 1917, thotë: *“Kur'ani nuk është prozë, sikurse nuk është as poezi. Ai është Kur'an dhe nuk mund të emërtohet me emër tjetër përveç kësaj. S'është poezi, sepse nuk është i kufizuar me normat e poezisë, por s'është as prozë, sepse ai është i normuar me rregulla të veçanta ... ato janë rregulla të tilla të cilat i lidhin disa prej tyre me skajin e ajetit e disa me notat e veçanta muzikore.”*¹⁵

Është i pakontestueshem edhe realiteti se stili Kur'anit është i veçantë dhe provokues dhe se rrëfimet kur'anore (القصص), sipas stilit hyjnor, asnjëherë nuk mund të ndahen deri në fund e në tërësi, sipas ndonjë skeme njerëzore. Allahu ka zgjedhur për ligjërimin e Tij formatin më të përshtatshëm në mënyrë që të përcillet mesazhi, porosia e kërkuar.

1. Kur'ani nuk është as poezi, as prozë e rimuar. E para përbëhet nga vargje identike në skemën e tyre metrike (numër, zgjatje dhe pozicion të rrokjes) dhe rimë (bashkëtingëllore

15 . Dr. Taha Husein lindi më 15 nëntor 1889 dhe vdiq më 28 tetor 1973. Në vitin 1914 doktoroi për letërsi dhe tema e tezës ishte: “Kujtesa e Ebu A'la.” Studimet e tij i vazhdoi edhe më tutje ku mori edhe një doktoraturë tjetër (PhD), në Sorbonne të Francës, në vitin 1917. Për disertacionin e doktoraturës, Taha Hussein kësaj radhe shkroi për Ibni Haldunin.

dhe vokalizim të rrokjes së fundit). E dyta është proza, fjalët dhe fjalitë e së cilës theksohen prej një rime, e cila mbahet gjatë gjithë veprës. Kur'ani nuk është asnjëra, ndonëse ai përmban diçka prej karakteristikave të të dyjave. Kur'ani bën përdorimin e lirë të tyre me qëllim që të nxjerrë në pah synimet e tij. Përdorimi i elementeve të poezisë dhe prozës së rimuar nga ana e Kur'anit është gjithmonë më i miri dhe më elokuenti, por ai nuk është kurrë i tillë sa për të bërë të mundshëm ngjashmërinë apo përshtjellimin me to. Kjo është arsyeja se përse duhej shpikur një kategori e re për të klasifikuar Kur'anin përtej poezisë dhe prozës, pikërisht prozë absolutisht e lirë.

2. Ajeti kur'anor përbëhet prej fjalëve dhe fjalive që i përshtaten domethënies në mënyrë perfekte. Diksioni i tij është gjithmonë i saktë dhe perfekt në mënyrë absolute. Çdo ndryshim, sado i vogël, është një ndryshim për më keq. Asnjë fjalë nuk mund të kapërcehet pa prishjen e rrjedhjes dhe domethënies së fjalisë.

3. Fjalët dhe fjalitë kur'anore të një ajeti, apo të një pjese të ajetit, krahasohen apo vihen në kontrast në mënyrë perfekte me ato të frazës apo shprehjes paraprijëse apo pasuese, qoftë në ndërtim, qoftë në domethënie. Rrjedhja e fjalëve të tij shkakton kështu tensionin dhe shpresën më të madhe, qetësinë dhe kënaqësinë më

të madhe të mundshme. Kjo cilësi e kompozicionit kur'anor u quajt *tenazun* apo balancë dhe ajo vepron si te forma, ashtu edhe te përmbajtja e tekstit.

4. Fjalët dhe fjalitë kur'anore shprehin domethëniet më të pasura dhe më të fuqishme në format më të shkurtra. Ai nuk është kurrë fjalëshumë dhe asnjë fjalë nuk është kurrë e tepërt. Megjithatë, shkurtësia nuk është parim absolut për t'u respektuar në çdo rast. Ekzistojnë shembuj në Kur'an në të cilët përsëritja dhe shtrirja janë të domosdoshme. Në këto raste ato kanë justifikimin e tyre të veçantë.

5. Krahasimet dhe metafora, bashkimet dhe veçimet e koncepteve dhe urdhrave, përçojnë apelimin më të madh të mundshëm. Ato përplasen me imagjinatën me një forcë të tillë të fuqishme, sa që ato e lënë atë pa frymë në tronditjen dhe magjepsjen e saj. Për këtë cilësi unike të Kur'anit, estetët letrarë arabë shpikën termin lartësisht kreativ.

6. Kompozimi kur'anor është gjithmonë i përpiktë, si një vepër arti me perfeksionim absolut. Rrjedha dhe struktura e tij është krejtësisht e lirë prej zbrazëtirave apo pikave të dobëta. Ekzistojnë shembuj të shumtë ku një fjalë apo një frazë e tërë mungon, por domethënia është gjithmonë e qartë.

7. Stili kur'anor është po aq i fuqishëm dhe ngulmues, sa edhe i butë e delikat. Lexuesi mund ta

ndiejë atë të bjerë si shkëmb mbi të, apo të bjerë me finesë dhe butësi të pafundme. Kjo është arsyeja se përse ai u quajt bukuria e rënies mbi vetëdije.

8. Strukturimi kur'anor nuk ka strukturë në kuptimin e zakonshëm të termit. Ai kombinon kohën e tashme, të shkuar, të ardhme dhe mënyrën urdhërore në të njëjtin fragment. Ai zhvendoset nga fjalimi raportues i personit të tretë te personi i dytë adresues; nga përshkruesja te normativja, nga pyetësja te thirrmoja dhe nxitësja. Ai është përsëritës, ndonëse në çdo përsëritje përçohet një mesazh i ndryshëm.

9. Teksti kur'anor nuk është i renditur as nga subjekti, sipas aktualitetit, as nga kronologjia, mbasi qëllimi i tij nuk është as analiza sistematike, as raportimi, as historiografia. Ai është përmbi gjithçka, fillim e fund, trup i letërsisë në të cilin çdo frazë, fjali, grup fjalish, apo sure përbën një njësi autonome, të plotë në vetvete, dhe njësitë janë të lidhura së bashku. Përsëritja nuk është kurrë e tepërt meqë mësohet dhe theksohet një mësim i ri që bazohet në një aspekt të ri të një ngjarje tashmë të njohur. Kur'ani e përdor si mbartës për mësimin e ri që ai synon ta ngulitë në mendjen e dëgjuesit.

10. Rrjedha e vazhdueshme e njoftimeve, përshkrimeve, dhënieve të llogarisë dhe leksioneve të Kur'anit synon që të të bindë dhe

të të mbushë mendjen me anën e bukurisë dhe forcës së fjalëve, fjalive, apo grumbullit të shprehjeve të tij. Rrjedha kur'anore prodhon një energji që e dëbon mosbindjen e dëgjuesit dhe kokëfortësinë e tij me anën e goditjes së larmishme dhe e bart më në fund atë dëgjues në destinacionin e saj. Kur'ani është një ilustrim perfekt i lartësimit në formë dhe përmbajtje, që shkakton efekt lartësues.

Si rrjedhim, ne mund të arrijmë në përfundimin se lartësimi nuk është kurrë i tillë vetëm në formë, as vetëm në përmbajtje, as vetëm në efekt. Ai është në të tria njëkohësisht. Forma e lartësuar pa përmbajtjen e lartë, apo përmbajtja e lartësuar pa formën e lartë, shkaktojnë pak apo aspak efekt, sigurisht jo efektin që ka lartësimi.¹⁶

Duhet ta kemi të qartë se Kur'ani me fuqinë, madhësinë, hyjninë, përsosurinë absolute ndaj jetës, përsiatjes, raporteve ndërnjerëzore, martesës, luftës, paqes, ibadeteve (adhurimeve), nuk mund të ketë një burim, një gjenezë me hadithin, sepse në fund të fundit, ku qëndron dallimi ndërmjet Kur'anit dhe hadithit, nëse autori i tyre është i njëjti?! Përse Muhamedi (a.s.), nëse e kishte këtë aftësi, përse të shkruante një Kur'an absolutisht të përsosur dhe t'ia përshkruante autorësinë dikujt tjetër, kurse hadithet t'i mbante për

16. <http://www.alb-drejtësia.com/al/news.php?readmore=802>

vete. Mos vallë Muhamedi, si autor Kur'ani, është mbinjeri, sepse ka shkruar diçka mbinjerëzore dhe Muhamedi si autor hadithesh është njeri i zakonshëm, sepse ka thënë diçka njerëzore.

Kur'ani ka prejardhje hyjnore. Këtë e dëshmon edhe historia Profetike, edhe vetë Profetësia e Muhamedit, edhe e sotmja. Çdo përpjekje për degradimin e Kur'anit me premisa historike, njerëzore, paraprakisht është e dështuar. Edhe historia, edhe gjuha arabe, edhe gramatika arabe, edhe çdo pikëpamje e Kur'anit do ta vërtetojë se Kur'ani është i shpallur nga Krijuesi dhe nuk është çfarëdolloj veprë njerëzore.

g. Lartësimi i përmbajtjes

Lartësimi i mesazhit të Kur'anit shprehet në shumë aspekte:

Kur'ani e pohon mendimin dhe arsyen e shëndoshë si qëndrimin ideal të mendjes njerëzore. Ai mëson çlirimin nga kontradikta, nga mungesa e koherencës, nga paradoksi, nga miti.

Kur'ani nuk i paracakton prioritet as shpalljes, as arsyes, por deklaron barasvlerën e tyre, duke i shpjeguar të gjitha mospërputhjet midis tyre ose si një mungesë në të kuptuarit e shpalljes, ose si një gabim në proceset e arsyes.

Qëndrimi kur'anor është, si rrjedhim, optimist në lidhje me aftësinë e njeriut për dije.

E vërteta, mendon ai, është e njohshme; e pavërteta nuk është kurrë përfundimtare dhe mund të kapërcehet gjithmonë me njohje më të mirë. Islami, aftësinë për të njohur të vërtetën, e pohon për të gjithë njerëzit dhe e afirmon atë si bazë të universalizmi islam.

Ai mohon çdo kategorizim të njerëzve, që bën diskriminim midis tyre në lindje për sa i përket aftësisë së tyre, apo për sa i përket lidhjes së tyre me Zotin, Krijuesin e tyre. Islami e identifikoi veten me dijen. Ai e bëri dijen kushtin e tij si edhe qëllimin e tij. Ai e barazoi kërkimin e dijes me adhurimin dhe derdhi lavdërimet e tij më të pakursyera mbi ata që angazhohen për kultivimin e saj, duke i bërë ata të shenjtë dhe miq të Zotit dhe duke e ngritur bojën e tyre mbi gjakun e martirëve. Ajo nuk është as një shkrepimë e pavullnetshme në ndërgjegjen e një pasuesi që i nënshtrohet një eksperience mistike. Dija islame është perceptim racional – empirik dhe intuitiv – i çdo sferë të realitetit. Ajo është dije kritike e njeriut dhe e historisë, e tokës dhe e qiellit. Dija është e pafundme për shkak se e vërteta është e pafundme.

Kur'ani e fton njerëzimin që ta pranojë mesazhin e tij në mënyrë racionale, në mënyrë kritike dhe në liri. Ai i urdhëron myslimanët që në misionin e tyre të theksojnë vendet e pajtimit dhe t'i forcojnë ato, për:

ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمَةِ
وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِي هِيَ
أَحْسَنُ

“Thirr në rrugën e Zotit me urtësi dhe këshillë të mirë...”¹⁷, dhe

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ ط

“S’ka detyrim në fe.”¹⁸

Kur’ani e deklaron umetin një vëllazëri universale, brenda së cilës mund të veprojnë në të njëjtën kohë një pluralitet sistemesh ligjore dhe kulturore.

Mesazhi kur’anor nuk e ndan realitetin material në të shenjtë e profan, jetën njerëzore në fetare e shekullare. Premisa e mesazhit të Kur’anit, nuk është një libër i mbyllur. Ai është gjithnjë i hapur ndaj realiteteve të reja.

h. Lartësimi i efektit

Arabishtja kur’anore u bë standard dhe normë e gjuhës arabe, sa i përket fjalorit, sintaksës, gramatikës dhe elokuencës së saj. Çdokush e shikonte Kur’anin si kriterin themelor të kompozicionit dhe përsosmërisë letrare. Përpara kohës së kolonializmit, pothuajse të gjitha veprat e shkruara prej myslimanëve reflektonin karakteristikat tradicionale të Kur’anit. Mbi të gjitha, asnjë libër nuk ka qenë ndonjëherë

shkak i ndryshimit të tillë të thellë fetar, intelektual, kulturor, moral, social, ekonomik dhe politik, në jetën e miliona njerëzve, apo të njerëzve aq të ndryshëm etnikisht, siç është Kur’ani.

Si një vepër hyjnore e shenjtë që është, Kur’ani ka një estetikë të mrekullueshme dhe ndikim emocional mbi myslimanët që e lexojnë apo e dëgjojnë prozën e tij poetike. Madje edhe jomyslimanët janë impresionuar thellësisht nga përkryeshmëria e tij letrare dhe perfeksionimi i paimitueshëm i tij.

Kur’ani nuk është vepër e ndonjë poeti apo artisti. Ai është Fjalë e Zotit, andaj edhe është i përkryer e i mrekullueshëm. E tëra kjo që u tha, është e nevojshme të parashtrohet për t’i mundësuar lexuesit të kuptojë arsyet e stilit të fuqisë magjike të Kur’anit, fuqi që, për fat të keq, assesi lexuesi nuk mund ta ndiejë në përkthim, sado i mirë që të jetë ai. Konsiderojmë se me të drejtë orientalisti francez **Demombynes** ka kërkuar nga lexuesit francezë që kur ta lexojnë përkthimin e Kur’anit në frëngjisht, duhen që në të njëjtën kohë ta dëgjojnë edhe origjinalin në arabisht, në mënyrë që ta ndiejnë dhe ta kuptojnë Kur’anin.¹⁹ Kurse dijetarët myslimanë kanë shprehur bindjen se asnjë përkthim, sado që të

19. Kur’ani Kryevepër-Tekste të zgjedhura nga Dr. Feti Mehdiu, Dr. Hasan Kaleshi, “Kur’ani Kryevepër e Letërsisë Arabe”, f. 114-115, Prishtinë, 1992.

17. Kur’ani, En-Nahl, 16:125.

18. Kur’ani, El-Bekare, 2:256.

jetë punuar me kujdes, nuk mund të quhet Kur'an.

Duke pasur parasysh vlerat e shumëfishta dhe temat e Kur'anit, që nga ato fetare e shpirtërore, filozofike e sociale, teorike e praktike e deri tek ato shprehimore artistike, është me interes për kulturën islame në përgjithësi, që të zotët e mendjes dhe të penës, të bëjnë më shumë në ndriçimin e vlerave stilistike të Kur'anit, ngase edhe këtu del në shesh mrekullia e shprehjes artistike të Kur'anit dhe pamundësia e imitimit të vlerës estetike të tij.

Vepra më e madhe e cila është shkruar ndonjëherë në ndikimin e stilit të Kur'anit, të mënyrës së rrëfimit kur'anor dhe eksplicitimit të shembujve, metaforës, alegorisë, etj., është “*El-Methneut*” divani i Xhelalud-din Err-Rrumisë.²⁰ Fjalët e tij dëshmojnë mjaft se është e pamundur të imitohet Kur'ani dhe se stili i rrëfimeve të tij është i paarritshëm.²¹

HADITHI (Suneti)- Baza e dytë fesë dhe qytetërimit islam

Dërgimi i Muhamedit ((a.s.)) Profet ishte dhe mbetet mëshirë

20. Er-Rumi, Muhammed Xhelaluddin, lindi më 1207, në Belexh, Horasan, dhe vdiq më 1274, Konjë, Turqi. Vepra më e njohur e tij është poema “*El-Methneut*” me 47.000 strofa dyvargëshe, mbi të cilën punoi shtatë vjet.

21. Kariq, Dr. Enes, “*Hyrje në shkencat e Tefsirit*”, f. 181. Prizren 1996.

për mbarë njerëzimin, përkrahje e inkurajim i çdo të mire, burim i pashtershëm i dijes dhe udhërrëfyes për umetin deri në Ditën e Gjykimit. Ai tregoi dhe vërtetoi bindshëm se ishte Profet dhe shpëtimtari i gjithë njerëzimit.

Hadithi (Suneti) i Profetit Muhamed (a.s.) është burimi, baza e dytë e fesë, shariatit dhe qytetërimit islam. Me termin “Hadith” kuptojmë: thëniet, veprat, miratimet (pëlqimet) dhe virtytet e Muhamedit (a.s.). Udhëzimet, veprimet dhe mësimet e përgjithshme të Muhamedit (a.s.), të cilat me një emër të përbashkët quhen Sunet. Nganjëherë hadithi vjen me dispozita shtesë, apo komentim, nga ato që janë detyruar me Kur'an. Hadithet e Profeti (a.s.) janë burim pa të cilat nuk do të kuptohej Islami. Kur'ani na bën me dije se Muhamedi (a.s.):

وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ * إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ

“Ai nuk flet nga veta e tij. Ajo që thotë s’është (gjë tjetër) pos shpallje që i frymëzohet”²², prandaj, duhet kuptuar se çdo thënie, veprim, miratim, pëlqim i Profetit (a.s.) të ndonjë veprë të ndokujt, ka burimin nga Allahu, andaj edhe është bazë e dytë, pas Kur'anit, në ndërtimin e fesë, jetës, ligjit dhe qytetërimit islam.

Suneti është përplot gjallëri dhe fuqi. I arsyeshëm për ndikim dhe përmirësim, në çdo kohë dhe vend.

22. Kur'ani, En-Nexhm, 53:3-4.

Urdhëron, inkurajon dhe mbështet për të gjitha virtytet e mira dhe ndalon nga të këqijat, thërret dhe apelon që çdo herë të kthehemi në burimet themelore, në zanafillë dhe të largohemi nga risitë (bid'atet), të cilat nuk kanë mbështetje në Kur'an dhe Sunet, ose nuk janë në përputhje me atë që vepruan sahabët e Profetit (a.s.) Lufton të gjitha traditat e injorancës që bien ndesh me parimet islame, pa marrë parasysh cilës shoqëri i përkasin. Suneti pra, aludon në Islamin e vërtetë autokton dhe burimor, andaj, për këto arsye dhe shumë të tjera, është nevojë dhe domosdoshmëri e këtij komuniteti nxënia, ruajtja dhe kultivimi i haditheve të Profetit (a.s.)

Librat e shkencës së Hadithit ishin dhe mbeten bazë e burimeve islame e posaçërisht (Gjashtë Koleksionet e Vërteta - El-Kutubu es-Sittetu es-Sahihatu). Të gjithë dijetarët islamë janë kompaktë se libri më i vërtetë pas Kur'anit është Sahihu i Buhariut, i cili përmban në vete fjalët e arta të Muhamedit (a.s.), e veçori e tij është se të gjitha hadithet e përmbledhura në të janë të vërteta dhe i plotësojnë kushtet më të larta, të cilat i kanë caktuar kritikët e shkencës së hadithit. Të mësuarit e haditheve përmendësh dhe klasifikimi i tyre e po ashtu edhe librat, të cilat u shkruan për interpretuesit e hadithit janë dëshmi për vërtetësinë dhe origjinalitetin e Sunetit-Haditheve të Muhamedit (a.s.) Vargu i interpretuesve është veçori e këtij komuniteti, i cili me precizitet

dhe fanatizëm mësoi dhe përcolli hadithet e Profetit (a.s.)

Në këto dëshmi dhe realitete shohim rolin e shkencës së Hadithit në ruajtjen e fesë, kulturës dhe qytetërimit islam. Dhe, sa më afër mësimëve të Haditheve dhe Sunetit të Muhamedit (a.s.), aq më tepër vjen në shprehje jeta jonë si myslimanë të vërtetë dhe të ruajtur nga devijimet e ndryshme.²³

Shumë hadithe-thënie të Profetit tonë, pastë paqen e Allahut, pohojnë se mësimet morale të Kur'anit do të mbizotërojnë. Në ditët e fundit, para fundit të botës, njerëzimi do të përjetojë një periudhë në të cilën e keqja, padrejtësia, mashtrimi, hilja, luftërat, mosmarrëveshjet, konflikti dhe degjenerimi moral do të jenë të përhapura në mbarë botën. Pastaj do të vijë Epoka e Artë, në të cilën këto mësimet morale do të fillojnë të përhapen midis njerëzve, si një valë që rritet, dhe përfundimisht do të mbizotërojnë në mbarë botën. Disa prej këtyre thënieve janë dhënë më poshtë:

*“Gjatë kësaj (periudhe), umeti (komuniteti) im do të jetojë një jetë aq të rehatshme dhe të lumtur që kurrë më parë nuk e kishin jetuar. (Toka) Do të japë frutat e saj dhe s’do të mbajë asgjë dhe pasuria në atë kohë do të jetë e bollshme”.*²⁴

23. Marrë nga libri: “Suneti bazë e Sheriatit” – Mexhel-letu “El-Minbel”, nr. 484, viti 1990, (numër special për hadithin dhe terminologjinë e tij).

24. Sunen Ibni Maxheh.

“Toka do të jetë përplot barazë dhe drejtësi sikurse ishte më parë përplot shpëtyrje dhe tirani?”²⁵

Është realitet se pa baza të tilla, mësimet metodike dhe punë praktike të mbështetura në Kur’anin e madhëruar dhe Hadithin- traditën e Profetit (a.s.), myslimanët kurrë nuk do të ecin përpara. Vlerat dhe zgjidhjet e huaja nuk shpëjnë çuarjen përpara dhe janë të papërshtatshme. Muhamedi (a.s.) duhet të jetë model i jetës së myslimanit, dhe tek ai kanë shembullin më të mirë. Dashuria ndaj Allahut shprehet me dashurinë ndaj të Dërguarit të Tij dhe përfilljes së gjithë asaj që urdhëron dhe ndalon. Allahu (xh.sh.) thotë:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“Thuaj: Nëse e doni Allahu, ejani pas meje që Allahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është Ai që fal shumë, mëshiron shumë.”²⁶

Duhet ditur se Muhamedi (a.s.) ka qenë transmetues dhe interpretues i vullnetit të Zotit (xh. sh.) dhe komentues i ligjëritit hyjnor-Kur’anit. Roli i hadithit dhe i traditës së Profetit (a.s.) në ndërtimin e shoqërisë dhe qytetërimit islam është i patejkalueshëm, i domosdoshëm, ngase shumë, nga tradita e tij, mësojnë në praktikë fenë dhe qytetërimin Islam.

25. Sunen Ebi Davud.

26. Kur’ani, Al ‘Imran, 3:31.

Profeti Muhamed (a.s.) e ndërtoi shoqërinë dhe qytetërimin islam bashkëkohor me premisa hyjnore, duke ndryshuar trajtimin dhe botëkuptimin e njerëzve në shoqëri. Ai hyri në një epokë të re të ndriçimit të mendjes dhe solli një ringjallje konceptuale në zhvillim, së pari të qytetërimit islam dhe së dyti bëri që ky qytetërim të ndikojë edhe në zhvillimin e qytetërimit njerëzor. Për ta kuptuar mesazhin hyjnor dhe për ta vlerësuar Kur’anin, duhet studiuar jeta e të dërguarit Muhamed (a.s.) dhe mesazhet e tij. Me bindjen dhe përgjegjësinë më të madhe e them edhe këtë se Muhamedi (a.s.), mbi të gjitha, ishte Profet, por ai gjithashtu ishte dhe mbetet edhe një personalitet historik, jeta e të cilit është shënuar në detajin më të vogël dhe është ruajtur, si e askujt tjetër. Jeta dhe vepra e tij janë të njohura hollësisht për gjithë ata që kanë shprehur interesim për ta njohur dhe rreth saj nuk aspak të mbështjella apo mister.

Të frymëzuar nga mësimet hyjnore dhe duke pasur pranë vetes Muhamedin (a.s.), i cili në veper jetësonte parimet islame, lindi një gjeneratë njerëzish, e cila do të mbetet shëmbëlltyrë e gjallë dhe mësim praktik për jetën e çdo myslimani. Duhet të dimë edhe këtë se çdo shtrembërim i shfaqur te ne është rezultat i mospërfilljes së Kur’anit dhe Sunetit. Myslimanët e sotëm do të udhëzoheshin vetëm me atë që u

udhëzuan të parët e tyre. Çdoherë duhet të kthehemi në zanafillë, bazament: Kur'an dhe Sunet. Kthimi te Kur'ani i madhërishëm, nënshtrimi ndaj parimeve të tij gjatë jetës si dhe kthimi te Suneti i Profetit (a.s.) pas vdekjes së tij është detyrim

i çdo myslimani, e në veçanti i atyre që kanë ndikim dhe përgjegjësi për fenë, kulturën dhe qytetërimin islam. Kur'ani na udhëzon për devotshmëri ndaj Allahut dhe nderim e respekt ndaj të Dërguarit të Tij.

“Zani i Naltë” paraprijës – themeltar i periodikut islam në gjuhën shqipe

Ramadan Shkodra

Abstrakt

Vetë nisma për botimin e një reviste të formatit të “Zani i Naltë”, përveçse kishte një rëndësi të veçantë historike, s’ka dyshim se ishte edhe një hap i guximshëm që tregonte qartë pjekurinë, vizionin, përgatitjen profesionale, e mbi të gjitha përgjegjësinë e elitës fetare islame të kohës, për të krijuar institucione që kryejnë misionin e tyre para Zotit, vendit e popullit.

Misioni, filozofia dhe vizioni i revistës “Zani i Naltë” bëhen të qarta dhe kuptohen që në kryeartikullin e numrit të parë të revistës, në të cilin nismëtarët dhe botuesi shprehin objektivat madhore të revistës ku thuhet se “Zani i Naltë” ka për qëllim: “...M’ia zbulue popullit mysliman shqiptar të vërtetën e besimit në një mënyrë të thjeshtë e të pandërlikume..., si dhe me plotësue vllazninë ndërmjet të gjithë elementeve në Shqipëri”. Kjo me qëllim që, sikurse thuhet aty, “Me forcue themelet e një politikës së shëndoshtë e të thjeshtë kombëtare në Shtetin tonë”.

Sibh për këtë, “Zani i Naltë” për një dekadë e gjysmë qe bërë tribunë e mendimit të elitës islame e shqiptare, e cila me kompetencë trajtonte e kultivonte tema profesionale nga disiplina kombëtare, fetare, sociale e kulturore. Këtu gjejmë urtësinë dhe begatitë e disiplinave kur’anore nga pena të shquara e mendje të ndritura, siç ishte haxhi Vehbi Dibra me bashkëkohësit e tij. Gjejmë po ashtu edhe trajtesa historike e kulturore të shkoqitura me shumë elokuencë nga e kaluara e populli tonë. Pa lënë anash edhe trajtesa që kanë të bëjnë me humanen, kultivimin e tolerancës dhe mirëkuptimin, vlera sublime të popullit tonë.

Jam së tepërmi i nderuar që kam mundësinë t’i them disa fjalë në këtë konferencë shkencore për revistën e parë islame

në gjuhën shqipe, për revistën “Zani i Naltë”, për këtë tribunë të fjalës së shkruar islame në gjuhën shqipe, të cilën një shekull më parë e themeloi

dhe e botoi Komuniteti Mysliman Shqiptar, pra institucioni kryesor dhe më i lartë fetar e i pavarur islam, në kuadër të të cilit ndërvepronin elitat e ulemasë shqiptare në vend.

Elitë kjo e cila në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 1912 u gjet në krye të momenteve historike të vendit dhe e cila unifikoi institucionet islame nëpërmjet zhvillimit të disa kongreseve kombëtare, siç ishte Kongresi i Parë, i mbajtur më 24 shkurt deri më 12 mars 1923, i cili shënoi edhe pikënisjen drejt institucionalizimit të Bashkësisë Islame dhe i cili hodhi edhe themelet për formimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, institucion i cili sot hyn në shekullin e ri, - të dytin, - të tij.

Vitet '20 të shekullit XX, për Shqipërinë në kufijtë e sotshëm administrativ, shënojnë përpjekjet serioze për konsolidimin shtetëror dhe për ngritjen e përparimin intelektual, social e shoqëror të vendit. Në këto vite qe krijuar një klimë me ndjesi e vetëdije të theksuar kombëtare, e cila ishte pasqyruar në shumë drejtime. Prijësit fetarë, teologët e shquar në gjirin e komuniteteve fetare, të cilët kishin marrë pjesë aktive në çështjet kombëtare, iu vunë punës që kjo frymë kombëtare të pasqyrohej edhe në veprimtarinë e vetë komuniteteve fetare. Në këtë rrafsh, përpara tyre shtrohej detyra e organizimit të komuniteteve dhe e pavarësisë

së tyre. Prijësit myslimanë, me forma dhe veprimtari të ndryshme, sensibilizuan opinionin shqiptar dhe autoritetet shtetërore për mbështetje në punën e nisur në rrugën e pavarësisë. Kështu, vitet 1922-1923 ishin relativisht të suksesshëm në procesin e konsolidimit të shtetit dhe në themelimin, forcimin dhe zhvillimin e institucioneve kombëtare, dhe në këtë mënyrë janë vlerësuar edhe nga historianë e studiues të ndryshëm.

Në këtë kohë u themelua edhe Komuniteti Mysliman Shqiptar (KMSH), si vazhdimësi e vendimeve të mëdha që kishte marrë paria shqiptare, vendime të cilat qenë përcaktues për fatin dhe të ardhmen e shqiptarëve, si në aspektin kombëtar, ashtu edhe në atë shtetëror.

Në këtë kontekst vlen të theksohet se në këto ngjarje të rëndësishme për popullin shqiptar, si te Kongresi i Manastirit, te Shpallja e Pavarësisë së vendit, si dhe te pavarësimi i Komunitetit Mysliman Shqiptar, ndër bartësit kryesorë gjejmë hoxhallarët, si haxhi Vehbi Dibrën, Hfz. Ali Korçën, Hfz. Abdullah Zëmlakun, Hfz. Ibrahim Dalliu, Shefqet Mukën, Sali Vuçiternin, Ferit Vokopolën, etj. Së këndejmi, vendimi për themelimin e KMSH-së ishte kërkesë e besimtarëve dhe e shtetësisë së tyre, prandaj marrja e këtij vendimi prej atyre hoxhallarëve të urtë, të ditur e të mençur, të prirë prej Haxhi Vehbi

Dibrës me shokë, ishte përmbushje e një kërkese të tillë dhe një element shtesë i shtetësisë së shqiptarëve. Themelimi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë më 1923 paraqet një ndër ndërmarrjet më të rëndësishme për shqiptarët e besimit islam, me në krye udhëheqësit e tyre fetarë, të cilët, në një kohë kthesash të mëdha historike për vendin tonë, gjetën kurajë dhe i udhëhoqën e i organizuan besimtarët islamë, si dhe i pavarësuan edhe në aspektin shpirtëror. Themelimi i KMSH-së përveçqë nisi me organizimin e jetës fetare islame, ai themeloi dhe ngriti edhe institucionet bazike për nevojat e myslimanëve shqiptarë, sikurse ishin Këshilli i Naltë i Sheriatit, Medreseja e Tiranës, revista “Zani i Naltë”, si dhe u mor me botimin e literaturës së nevojshme, e që i dha formë, trajtë e kuptim jetës fetare të besimtarëve shqiptarë, sepse aty praktikohesh, mësohesh, kultivohej e shpjegohej për fenë e Zotit, për historinë e ndritshme të kombit në gjuhën e besimtarëve, në gjuhën shqipe.

Vetë nisma për botimin e një reviste të formatit të “Zani i Naltë”, përveçse kishte një rëndësi të veçantë historike, s’ka dyshim se ishte edhe një hap i guximshëm që tregonte qartë pjekurinë, vizionin, përgatitjen profesionale, e mbi të gjitha përgjegjësinë e elitës fetare islame të kohës, për të krijuar institucione që kryejnë misionin e tyre para Zotit, vendit e popullit.

Misioni, filozofia dhe vizioni i revistës “Zani i Naltë” bëhen të qarta dhe kuptohen që në kryeartikullin e numrit të parë të revistës, në të cilin nismëtarët dhe botuesi shprehin objektivat madhore të revistës ku thuhet se “Zani i Naltë” ka për qëllim: “...*M’ia zbulue popullit mysliman shqiptar të vërtetën e besimit në një mënyrë të thjeshtë e të pandërlikume..., si dhe me plotësue vllazninë ndërmjet të gjithë elementeve në Shqipni*”. Kjo me qëllim që, sikurse thuhet aty, “*Me forcue themelet e një politikes së shëndoshtë e të thjeshte kombëtare në Shtetin tonë*”.

Shih për këtë, “Zani i Naltë” për një dekadë e gjysmë qe bërë tribunë e mendimit të elitës islame e shqiptare, e cila me kompetencë trajtonte e kultivonte tema profesionale nga disiplina kombëtare, fetare, sociale e kulturore. Këtu gjejmë urtësinë dhe begatitë e disiplinave kur’anore nga pena të shquara e mendje të ndritura, siç ishte haxhi Vehbi Dibra me bashkëkohësit e tij. Gjejmë po ashtu edhe trajtesa historike e kulturore të shkoqitura me shumë elokuencë nga e kaluara e populli tonë. Pa lënë anash edhe trajtesa që kanë të bëjnë me humanen, kultivimin e tolerancës dhe mirëkuptimin, vlera sublimë të popullit tonë.

E konceptuar si revistë fetare islame, ajo këtë mision madhor e kreu me sukses, mirëpo nuk ngeli në kuadër të një reviste thjesht fetare, por shumë shpejt u shndërrua në një tribunë të mendimit fetar, filozofik,

kulturor e atdhetar, dhe kështu rreth vetes mblodhi penat më të njohura të kohës.

Prijësit tanë të shquar këtu e një shekull më parë “Zanin e Naltë” e kishin nisur si një projekt gjithëkombëtar, mirëpo për shaka të rrethanave me të cilat u përball populli ynë dhe trojet tona “Zani i Naltë” misionin e tij e shtroi kryekëput në Shqipërinë administrative.

Ndonëse “Zani i Naltë” është botuar dekada më parë, përmbajtja e shkrimeve të tij kanë vlerën e tyre të njëjlojtë edhe në kohën e sotme, janë shumë aktuale, të rëndësishme dhe të nevojshme, sikurse të jenë thënë sot dhe sikur të jenë shkruar për ditët e sotme, sepse ato janë shkruar nga dijetarë vizionarë e largpamës. Duke vështruar faqet e “Zani i Naltë”, do të njihemi edhe me rolin e ulemasë tonë në rrafshin kombëtar dhe me kontributin e tyre domethënëse dhënë çështjes së komb formimit dhe shtet formimit.

Ky kontribut ka vazhduar gjatë gjithë periudhës së daljes së revistës “Zani i Naltë”, duke ngulitur me shkrime të ndryshme, te lexuesit e saj ndjesinë kombëtare dhe respektin për institucionet e shtetit.

Duke lexuar “Zani i Naltë”, do të shohim se ajo ka ndihmuar që në mes të shqiptarëve të kultivohej ndjenja e dashurisë, harmonisë, tolerancës e mirëkuptimit me anëtarët e besimeve të ndryshme, vlerë për të cilën krenohemi të gjithë.

Pa mëdyshje, një kontribut të madh në ngulitjen dhe kultivimin e kësaj vlere kombëtare patën autorët që shkruan në faqet e “Zani i Naltë”.

Revista “Zani i Naltë” është një thesar i çmueshëm, ku në mënyrën më të mirë është kultivuar binomi fe-atdhe, apo thënë ndryshe, revista ishte një tribunë që kultivoi me përkushtim e devocion fetaren dhe atdhetaren.

Kurse vjershat dhe poezitë e botuara në faqet e “Zani i Naltë”, duhet të jenë patjetër pjesë e repertorit të korit të nxënësve të medreseve tona, sepse vështirë të thuhet se mund t’i këndohet më me shpirt dhe më mirë Kur’anit, Profetit a.s., Atdheut, Flamurit, etj., se ç’u është kënduar në këtë revistë.

Përtej gjithë këtyre, “Zani i Naltë” është i rëndësishëm edhe për një fakt tjetër, sepse me “Zanin e Naltë” filloi periodiku islam në gjuhën shqipe dhe ai u bë edhe pararendës i revistave islame në gjuhën shqipe që do të dilnin pas tij, jo vetëm në Shqipëri, siç ishte “Kultura Islame”, por edhe në trojet jashtë Shqipërisë, e madje edhe në diasporë, siç ishin revistat “Jeta Myslimane” që botohej në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, “Takvimi/Kalendari” dhe “Edukata Islame” në Prishtinë, etj. Për më tepër, revista “Zani i Naltë” shërbeu edhe si paraprijëse e fillimit të veprimtarisë së gjithëmbarshme botuese islame në gjuhën shqipe.

Se sa i rëndësishëm dhe çfarë vlerash përmban dhe paraqet “Zani i Naltë” më së miri e dëshmon realizimi i projektit të tri komuniteteve tona islame (Komuniteti Mysliman Shqiptar, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Rijasetit të Maqedonisë së Veriut) për botimin e kompletit në dhjetë vëllime të Zanit të Naltë me rastin e 90 vjetorit të daljes së tij. Me këtë hap kaq të rëndësishëm, kultura dhe trashëgimia jonë e shkruar fitoi një thesar të çmuar, kurse “Zani i Naltë” iu ofrua masës së gjerë të lexuesve dhe u bë pronë e bibliotekave tona në të gjitha trojet shqiptare. Me ribotimin e kompletit të “Zani i Naltë”, si të thuash, u realizua ëndrra e mbetur në gjysmë e prijësve tanë të shquar, të cilët, këtu e një shekull më parë, këtë revistë e kishin konceptuar si një projekt gjithëkombëtar, por që për arsye të dihen nuk u bë e mundur.

Në anën tjetër, puna e eruditëve të cilët e themeluan, e nisën dhe e botuan revistën “Zani i Naltë” u bë model edhe për gjeneratat e teologëve islamë të Komunitetit Mysliman Shqiptar të viteve të pas 90-tës, të cilët, si shprehje e admirimit, vlerësimit dhe mirënjohjes për këta dijetarë vepërmirë, vendosën që ta ripërtërinin revistën “Zani i Naltë”, jo vetëm duke ia ruajtur emrin, por edhe duke trasuar fuqishëm, qëndrueshëm, drejtë dhe saktë, edhe rrugën që e kishin nisur pararendësit, rrugë kjo që po vazhdon të jep frytet e saj edhe sot e kësaj dite.

Lusim Zotin fuqiptotë që revista “Zani i Naltë” të vazhdojë rrugëtimin e saj edhe në përmbushjen e misionit hyjnor të nisur një shekull më parë, kurse emri dhe nami i “Zani i Naltë” të jehojë përgjithmonë.¹

1. Kumtesë e mbajtur me rastin e 100 vjetorit të revistës “Zani i Naltë”, Tiranë, 16 dhjetor 2023.

Xhamia e Namazgjasë dhe rrugëtimi për ndërtimin e saj

nga Dorian Demetja

Abstrakt

Një nga aspiratat parësore të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ka qenë mirëmbajtja dhe ndërtimi i sa më shumë xhamive, në të gjitha hapësirat e mundshme ku shtrihet komuniteti i besimtarëve myslimanë. Xhamitë janë shtëpitë e Zotit, në të cilat përmendet dhe lartësohet emri i Tij, ku besimtarët kryejnë adhurimet e tyre, ndërtojnë e përforcojnë jetën e tyre fetare dhe pajisen me dijet e fesë e të moralit. Në lidhje me rëndësinë e mirëmbajtjes dhe të ndërtimit të xhamive, Allahu, në Kur'anin Famëlartë, thotë: "Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë." (Kur'an, 9:18) Por historikisht, xhamitë kanë qenë ndërtuar të vogla dhe me kalimin e kohës ka lindur nevoja për një xhami të madhe në Tiranë.

Dibët tradicionalisht se Namazgjaja e Tiranës ka qenë qendra e riteve fetare islame për kryeqytetasit, ku falnin bashkërisht namazet e Bajrameve. Rrënojat e mureve dhe selvitë qindravjeçare flisnin për lashtësinë e saj. Prandaj dhe kërkesat e Komunitetit Mysliman në vazhdimësi kanë qenë që xhamia e madhe të ndërtohej pikërisht në truallin e Namazgjasë.

Hedhja e themeleve për ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë në Tiranë, u krye më 13 maj 2015, në prani të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, Presidentit të Republikës së Turqisë, z. Rexhep Tajip Erdogan, Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Skender Bruçaj, Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Turqisë, z. Mehmet Gormez, dhe personaliteteve të rëndësishëm nga Shqipëria e Turqia. Në ceremoni morën pjesë gjithashtu ish Kryetari i KMSH, z. Selim Muça, drejtorë, myftinj, imamë, si dhe një numër i madh qytetarësh të kryeqytetit e më gjerë. Pas fjalës së përshëndetjes së dy presidentëve dhe lutjeve të bëra nga dy kryetarët e komuniteteve myslimane, është shtypur butoni për hedhjen e betonit, ku ka nisur edhe zyrtarisht puna për ndërtimin e Xhamisë dhe Kompleksit të Namazgjasë.

Një nga aspiratat parësore të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ka qenë mirëmbajtja dhe ndërtimi i sa më shumë xhamive, në të gjitha hapësirat e mundshme ku shtrihet komuniteti i besimtarëve myslimanë. Xhamitë janë shtëpitë e Zotit, në të cilat përmendet dhe lartësohet emri i Tij, ku besimtarët kryejnë adhurimet e tyre, ndërtojnë e përforcojnë jetën e tyre fetare dhe pajisen me dijet e fesë e të moralit. Në lidhje me rëndësinë e mirëmbajtjes dhe të ndërtimit të xhamive, Allahu, në Kur'anin Famëlartë, thotë: **“Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.”**¹ Por historikisht, xhamitë kanë qenë ndërtuar të vogla dhe me kalimin e kohës ka lindur nevoja për një xhami të madhe në Tiranë.

“Kryeqyteti ka nevojë për një Xhami të madhe e moderne”. Me këtë titull hapet artikulli i revistës “Zani i Naltë” në vitin 1938. Aty lexojmë se qysh atëherë, edhe me rritjen e numrit të popullsisë, shprehet nevoja për një xhami të madhe, ku t’i mbledhë të gjithë besimtarët për ceremoni dhe lutje të përbashkëta, sidomos në festa fetare dhe kombëtare. Aty gjithashtu flitet

1. Kur’an, 9:18.

edhe për pamundësinë financiare për ndërtimin e saj nga institucioni, si dhe iniciativën që duhet të marrin bujarët e kryeqytetit në këtë drejtim.

*“Me rasën e shumë cermonijave të ndryshme është konstatue se Xhamija e Vjetër e Sulejman Pashës është tepër e vogël dhe s’mundet me i u përgjojë më nevojës së kohës. Mungesa e një salloni të gjanë në kryeqytet ka dhënë shkak qi shumica e popullit të mbetet pa marrë pjesë në shumë ceremoni e lutje të kryeme ndër festa fetare e kombëtare... Mungesa e një tempulli të favorshëm, mungesa e një lokali të madh e të përshtatun me numrin e madh të popullit qi ka sot kryeqyteti, mungesa e një faltoreje qi t’a përmbledhe e t’a kënaqe të tanë atë publik që dëshiron me marrë pjesë ndër të lutuna, mungesa e një të tillë ndertese sot është konstatue e vërtetue dhe nuk mund të kundërshtobet... Nji punë e tillë me të vërtetë është e vështirë por jo e pa realizueshme. Nji vepër kaqë kolosale mund të kushtoje më tepër se 200 ose 300 mij frank ar. Nji shpenzimit kaqë të madh sot për sot është e pamundur qi t’i bájë ballë Arka e Përgjitheshme e Vakfeve. Prandaj këjo punë mund të kryhet me ndihmat e popullit bâmirës.”*²

Interesimin për ndërtimin e një xhamie të madhe gjatë viteve në vazhdim, e dallojmë edhe në arkivin qendror të shtetit: Nevoja që ka

2. *Kryeqyteti ka nevojë për një Xhami të madhe e moderne*, revista “Zani i Naltë”, nr. 6, Qershuer 1938, viti XIII i botimit; Kolana Zani i Naltë, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë – Bashkësia Islame e Kosovës – Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, vëllimi 9, 2015, f. 178 – 179.

Tirana për një xhami të madhe iu parashtrua Mëkëmbësit, i cili kërkoi hartimin e një preventivi për xhaminë e madhe të Tiranës. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Vakfeve të bëjë marrëveshje me ndonjë arkitekt për hartimin e projektit të xhamisë së madhe në kryeqytet.³ I kërkohet zyrës së urbanistikës informacion se ku e ka caktuar vendin për ndërtimin e xhamisë së madhe të Tiranës. Urbanistika kërkon mendimin e Komunitetit Mysliman, i cili i përgjigjet se vendin që caktuam ne, ju e zutë me projektin për të ndërtuar aty “Bankën e Napolit”. Urbanistët italianë propozojnë si vend të përshtatshëm për ndërtimin e xhamisë dy troje: Posta në Pazarin e Ri, e cila do të shembej, dhe variantin tjetër – trualli i Namazgjasë.⁴

Një nga vendet më karakteristike të shekullit XIX është edhe rregullimi i Namazgjasë nga Ahmet Bej Toptani, i biri i Abdurrahman Toptanit. Namazgjaja përdorej gjatë verës për mbledhjet e qytetarëve dhe faljet e tyre gjatë muajit të Ramazanit dhe Bajramit.⁵

Si përfundim, trualli i Namazgjasë u pa më i përshtatshëm për funksionimin e tij si një faltore

3. AQSH, fondi 482, viti 1940, dosja 4; Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë 2011, f. 332.

4. AQSH, fondi 482, viti 1941, dosja 51, fleta 1; Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, po aty.

5. Roald A. Hysa, *Xhamitë e Tiranës*, Tiranë 2008, f. 72-73.

e hapur me një mihrab⁶ dhe një minber⁷, pastaj dhe me murin rrethues. Në shkresën e Ministrisë së Punëve të Brendshme bëhet e qartë se Komisioni Qendror për Edilicjen dhe Urbanistikën e Shqipërisë, në mbledhjen e datës 03.07.1941, me vendim nr. 1046, ka aprovuar projektin e paraqitur prej kësaj zyre për ndërtimin e një mihrabi dhe një minberi në Namazgjanë e Tiranës.⁸

Më 17.08.1943, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë i dërgon Bashkisë së Tiranës një shkresë të shoqëruar me tri lidhje të planit të Namazgjasë, si për rrethim ashtu edhe për objektet e brendshme, me të cilat kërkon edhe lejen e ndërtimit të tyre.⁹ Tri ditë më pas, Drejtoria Teknike në Bashkinë Tiranë, shprehet në favor që Vakëfit Mysliman t'i akordohet leja për ndërtimin e Namazgjasë sipas

6. Është një vend si i futur, ku qëndron imami gjatë faljes së namazit.

7. Është një vend me shkallë, ku ngjitet imami për të mbajtur predikimet në ditën e premte apo në ditët e Bajrameve.

8. Shkresë e Zyrës Qendrore të Edilicjes dhe Urbanistikës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Punës të Brendshme, drejtuar P. T. Ministrisë P. Botore-Tiranë dhe për njoftim Kryesisë së Bashkisë-Tiranë, prot. nr. 2874, dt. 06.07.1941, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

9. Shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Administratës Financiare e Vakfnore pranë Komunitetit Mysliman, drejtuar P. T. Kryesisë së Bashkisë së Kryeqytetit, Tiranë, nr. 122/11, datë 17.08.1943, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

projektit përkatës.¹⁰ Nuk e dimë me saktësi nëse ky projekt gjen zbatim në atë kohë.

Dihet tradicionalisht se Namazgjaja e Tiranës ka qenë qendra e riteve fetare islame për kryeqytetasit, ku falnin bashkërisht namazet e Bajrameve. Rrënojat e mureve dhe selvitë qindravjeçare flisnin për lashtësinë e saj. Prandaj dhe kërkesat e Komunitetit Mysliman në vazhdimësi kanë qenë që xhamia e madhe të ndërtohej pikërisht në truallin e Namazgjasë. Kështu, në bazë të kërkesës datë 20.04.1993, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë së Tiranës, me dt. 04.10.1993, nr. 13, vendosi dhënien e lejes së ndërtimit për objektin Xhaminë e Namazgjasë, e cila është firmosur nga Kryetari i Bashkisë z. Sali Kelmendi. Subjekti që zbaton punimet është M.A.K. Albania Al-Kharafi Industries & Establishments dhe objekti financohet nga Shoqata Islame e Vakëfit.¹¹

Në gazetën “Drita Islame”, jepen disa informacione rreth xhamisë dhe ceremonisë së fillimit të punimeve: Xhamia që do të ngrihet në këtë shesh, është dhuratë e familjes El-Fouzan nga Kuvajti. Kostoja e veprës

10. Shkresë e Drejtorisë Teknike pranë Bashkisë së Kryeqytetit, Tiranë, drejtuar P. T. Zyrës Qendrore për Ndërtim e Urbanistike, nr. 7/255, datë 20/08/1993, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

11. Shkresë e Bashkisë Tiranë për dhënien e lejes së ndërtimit, nr. 9589 datë 27.10.1993, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

parashikohet rreth 500.000 USD. Vepra është projektuar nga një grup inxhinierësh dhe konstruktorësh nën drejtimin e z. Sami Pashallari, ndërsa konsulent është profesor Besim Daja. Kjo xhami do të jetë një objekt madhështor, me dy minare, me një kapacitet faljeje për 2700 besimtarë njëherësh. Holli kryesor i faljes për burra është prej 27m x 32m = 900m², ndërsa ai i grave prej 250m². Ky objekt do të jetë mjaft kompleks, i përbërë prej tre katesh. Në katin tokësor do të funksionojnë vende për marrje abdesti, për burra dhe gra, dyqane, magazina dhe zyra.¹²

Më datë 24 dhjetor 1993, ditën e premtë, në fushën e Namazgjasë, në Tiranë, u zhvillua ceremonia e përrurimit të fillimit të punimeve për ndërtimin e xhamisë. Në ceremoninë e përrurimit morën pjesë Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Sali Kelmendi, sekretarët e shtetit për fenë, z. Bardhyl Fico e z. Sokol Miraka, përfaqësues të Komunitetit Mysliman, z. Ramazan Rusheku e z. Salih Tivari, Myftiu i Tiranës, z. Shyqyri Bylyku. Ndodheshin edhe përfaqësues të shoqatave islame në vendin tonë, besimtarë tiranas dhe nxënës të medresesë.¹³ Megjithëse guri i themelit u vendos dhe ceremonia u zhvillua, kjo mbeti deri

12. Nasuf T. Dizdari, *Në Tiranë do të ndërtohet një xhami e re*, gazeta “Drita Islame”, nr. 1 (44), viti i III i botimit, Janar 1994.

13. Nasuf T. Dizdari, *Në Tiranë do të ndërtohet një xhami e re*, po aty.

këtu, sepse në shtator të vitit 1994 punimet u pezulluan. Gjatë viteve 1993-1995 bajramet u falen në vendin e Namazgjasë, për t'u falur më pas në sheshin Skënderbej.

Ndërkohë, Komuniteti Mysliman vazhdon kërkimin e donatorëve për ndërtimin e xhamisë dhe një qendre kulturore me takime dhe vizita të vazhdueshme në Komunitetin Mysliman të Turqisë, Ministrinë e Çështjeve Islame- Vakfeve në Kuvajt dhe me autoritete të larta të Mbretërisë së Arabisë Saudite, të cilët shprehin gatishmërinë dhe premtojnë për ndërtimin e tyre.

Qysh me fillimin e vitit 2001, çështja e ndërtimit të xhamisë dhe një qendre kulturore në sheshin e Namazgjasë, vijon me takime në rangje të larta shtetërore shqiptare dhe me kërkesa në vazhdimësi nga Komuniteti Mysliman, drejtuar Urbanistikës së Tiranës për lejen e ndërtimit, duke i shoqëruar edhe me të dhëna të mjaftueshme për objektet që do të ndërtohen aty. Me gjithë premtimet që jepen në këtë drejtim, shikojmë se në nëntor të vitit 2001, Bashkia e Tiranës rrethon me kangjella sheshin e Namazgjasë për ta kthyer më pas në lulishte. Komuniteti Mysliman dërgon një sërë shkresash për zgjidhjen e kësaj çështjeje, por që nuk marrin përgjigje. Në dhjetor të vitit 2007, Komuniteti Mysliman e organizon faljen e Kurban Bajramit përsëri në

Namazgja, në shenjë proteste ndaj pushtetit vendor që nuk po jepte lejen e ndërtimit për Xhaminë e Madhe aty.

Në maj të vitit 2011 ka pasur një nismë nga Bashkia e Tiranës për ta ndërtuar xhaminë e madhe në Tiranë prapa Pallatit të Kulturës, sipas projektit fitues danez i Studios “BIG-Kopenhagen”, por që Komuniteti Mysliman nuk ka rënë dakord. Kryesia e KMSH-së në mbledhjen e posaçme të datës 20.09.2011, analizon edhe një herë të gjitha detajet për ndërtimin e xhamisë së madhe në Tiranë, e shumëpritur kjo prej kohësh. Në këtë mbledhje, Komuniteti Mysliman shprehet i vendosur që xhamia e madhe të ndërtohet në sheshin e Namazgjasë, tokë kjo e trashëguar brez pas brezi si vend për të falur namaz.

Truallit të Namazgjasë i ishte marrë një sipërfaqe e konsiderueshme nga zgjerimi i rrugëve të Unazës dhe asaj “George Bush”, e cila mbeti pa u kompensuar nga Bashkia në atë kohë. Pas një kalvari zvarritjesh dhe burokracish në kompensim të kësaj sipërfaqeje, Këshilli i Ministrave me vendim nr. 273 datë 03.04.2013, i ka dhënë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë një sipërfaqe prej 2570.5 m², duke e çuar sipërfaqen e përgjithshme në rreth 5.300 m².

Përpijekjet dhe orvatjet për ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë u mbyllën përfundimisht në vitin 2013, me vendimin e Këshillit

Kombëtar të Territorit për leje zhvillimore komplekse, firmosur nga Kryetari i tij z. Sali Berisha.¹⁴ Guri i themelit për ndërtimin e Xhamisë së Madhe të Tiranës u rivendos më 20 prill 2013 me ceremoninë e fillimit të punimeve në sheshin Namazgja, ku morën pjesë kryetari i Komunitetit Mysliman H. Selim Muça, kryeministri i Shqipërisë. Z. Sali Berisha, kryebashkiaku z. Lulzim Basha, krerët e komuniteteve fetare, përfaqësues të bashkësive islame nga Kosova dhe Maqedonia, zyrtarë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të trupit diplomatik, myftinj, imamë, besimtarë, qytetarë, etj.¹⁵

Me datë 24.09.2013 në Ankara dhe në Tiranë, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Selim Muça, nënshkruan me Prof. Dr. Mehmet Gormez, Kryetar i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Republikës së Turqisë dhe Kryetar i Këshillit Administrativ të Fondacionit për Fenë i Turqisë, një protokoll kuadër lidhur me ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë dhe kompleksit të saj. Në këtë protokoll kuadër, bëhen të ditura të gjitha detyrimet e secilës palë, përfshirë edhe detyrimet e Ambasadës së Republikës së Turqisë

14. Këshilli Kombëtar i Territorit, “Leje zhvillimore komplekse për ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë dhe godinës polifunkionale”, nr. 02, datë 29.05.2013, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

15. Aktivitete – Vjetar 2013, *Ceremonia e fillimit të punimeve të xhamisë së madhe të Tiranës*, vëllimi III, botim i KMSH, f. 62.

në Tiranë, deri në përfundimin e ndërtimit të saj, dhe të drejtës për t’u përdorur më pas nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Aty citohet edhe kompania KOMAŞ A.Ş., ent i Fondacionit për Fenë i Turqisë, e cila do të ndjekë dhe do të zbatojë punimet.

“Me një urdhëresë të Entit për Çështjet fetare (Diyanet), në Turqi ka nisur një fushatë për mbledhjen e ndihmave në të gjitha xhamitë e vendit për ndërtimin e Xhamisë së Madhe të Tiranës. Sipas shkresës së Diyanetit turk është parë e arsyeshme fillimi më 21 qershor 2013 në të gjitha xhamitë në Turqi i fushatës së ndihmës me qëllim për të kontribuar në ndërtimin e “Xhamisë Qendrore të Tiranës”, duke u shprehur se shqiptarët kanë shumë nevojë për një faltore, sidomos besimtarët e Tiranës, të cilët e ushtrojnë besimin e tyre në hapësira të papërshtatshme. Ndihmat do të mblidhen përmes ekspozitave dhe vendosjes së kutive në ambientet e xhamive pas namazit të ditës së premte. Fushata do të vazhdojë deri më datë 5 korrik 2013. Myftinitë e prefekturave dhe nënprefekturave janë ngarkuar me detyrën për të marrë masat e duhura për të siguruar që fushata e ndihmës të realizohet në formën e duhur.”¹⁶

Me ndërrimin e qeverive, po në vitin 2013, kemi edhe një

16. *Turqia mbledh ndihma për xhaminë e re të Tiranës*, revista “Drita Islame”, nr. 7 (366), viti XXII i botimit, korrik 2013, f. 9-10.

ndryshim në vendimin për lejen zhvillimore komplekse të dhënë më parë, ndryshim i cili miraton vetëm ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë, në bashkëpunim me zhvilluesin “Komunitetin Mysliman Shqiptar”. Vendimi është i firmosur nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, z. Edi Rama.¹⁷ Në selinë e KMSH është zhvilluar më 27 nëntor 2014 ceremonia e dhënies së lejes së ndërtimit, e cila i hap rrugën fillimit të punimeve për ndërtimin e Xhamisë së Madhe në kryeqytet. Ceremonia mbledhi kryeministrin, z. Edi Rama, përfaqësuesit më të lartë të komuniteteve fetare, ministrin e Mirëqenies Sociale, z. Erion Veliaj, ministren e Kulturës, znj. Mirela Kumbaro, kryetarin e Komitetit Shtetëror për Kultet, z. Ilir Hoxholli, myftinj e imamë, besimtarë e qytetarë të kryeqytetit dhe të rretheve, etj.¹⁸

Hedhja e themeleve për ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë në Tiranë, u krye më 13 maj 2015, në prani të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, Presidentit të Republikës së Turqisë, z. Rexhep Tajip Erdogan, Kryetarit të Komunitetit Mysliman

të Shqipërisë, z. Skender Bruçaj, Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Turqisë, z. Mehmet Gormez, dhe personaliteteve të rëndësishëm nga Shqipëria e Turqia. Në ceremoni morën pjesë gjithashtu ish Kryetari i KMSH, z. Selim Muça, drejtorë, myftinj, imamë, si dhe një numër i madh qytetarësh të kryeqytetit e më gjerë. Pas fjalës së përshëndetjes së dy presidentëve dhe lutjeve të bëra nga dy kryetarët e komuniteteve myslimane, është shtypur butoni për hedhjen e betonit, ku ka nisur edhe zyrtarisht puna për ndërtimin e Xhamisë dhe Kompleksit të Namazgjasë.¹⁹

Projekti i Xhamisë së Namazgjasë

Xhamia e Namazgjasë është projektuar nga studio “Hassa Architecture” me qendër në Stamboll të Turqisë. Studio është e arkitektit turk Muharrem Hilmi Shenalp, i cili ka projektuar shumë xhami të ndërtuara në disa vende të botës, si në Berlin dhe Këln të Gjermanisë, në Tokio, e cila në vitin 2002 është shpallur një ndër ndërtesat më të mira të saj, etj.

Përshkrimi i projektit: Xhamia e Namazgjasë ka elementë shqiptarë të një stili klasik ballkanas, ku si frymëzim kryesor ka Xhaminë

17. Këshilli Kombëtar i Territorit, “Një ndryshim në vendimin nr. 02, datë 29.05.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit”, nr. 02, datë 08.10.2013, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

18. Aktivitete - Vjetar 2014, *Xhamia e Namazgjasë, Këshilli i Ministrave jep lejen për fillimin e punimeve*, vëllimi IV, botim i KMSH, f. 192.

19. Aktivitete - Vjetar 2015, *Hidhen themelet e Xhamisë së Namazgjasë*, botim i KMSH, f. 187-188.

Blu në Stamboll, arkitekti i së cilës është Mehmet Sedefqar Aga, lindur në Elbasan. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 6000 m² në vendin e njohur si Namazgjaja e Tiranës, me kupolën e lartë 35 metra dhe katër minaret, lartësia e të cilave shkon në 50 metra. Brenda në xhami mund të falen njëkohësisht rreth 5000 besimtarë.

Xhamia e Namazgjasë është një kompleks multifunksional, ku të gjitha funksionet janë të hapura për publikun. Aty përfshihen qendra kulturore, salla e madhe e konferencave me kapacitet rreth 400 vende, një sallë tjetër më e vogël, biblioteka me një sipërfaqe 200 m², klasa për kurse të ndryshme; gjithashtu, projekti lë hapësirë edhe për realizimin e një muzeu islam, i cili do të jetë i pari në Shqipëri në llojin e

tij. Në projekt përfshihen parkingu me dy kate nëntokë, si dhe një numër i konsiderueshëm dyqanesh e ambientesh shërbimi. Shuma për ndërtimin e saj mendohet të shkojë rreth 40 milionë euro.²⁰

Lusim Allahun e Madhëruar që me realizimin e ëndrrës shumë vjeçare të besimtarëve myslimanë të Tiranës e mbarë besimtarëve shqiptarë, ta bekojë këtë xhami me mirësitë e Tij të pafundme, ta bëjë një vend ku lartësohet dhe nderohet emri i Tij me adhurime e lutje të sinqerta, ta bëjë një vend ku përhapet dija, dashuria dhe respekti për të gjithë.

20. Marrë nga faqja zyrtare e studios projektuese "Hassa Architecture", "Projekti për Xhaminë e Namazgjasë", https://acp.al/profil_projekt.php?id=115

Xhamia e Qyrjanit Institucioni i parë islam në trevën e Krajës

Hamid Alaj

Abstrakt

Xhamia e Qyrjanit, apo siç e quajnë disa Xhamia Plakë, si xhamia më e vjetër dhe institucioni i parë Islam në trevën Krajë-Shestan, është njëra ndër më të mëdhatë, më e rëndësishmja si dhe një vepër me një vlerë të çmuar.

Ajo është një nga shembujt më me vlerë të arkitekturës osmane. Krahas kësaj bëjnë pjesë edhe xhamitë e tjera të ndërtuara gjatë periudhës osmane në këtë trevë. Xhamia ndodhet në hyrje të lagjes së Qyrjanit, prej nga ka marrë edhe emrin e saj, dhe në përbërjen e vet përfshin pjesëtarët (xhematin) e fshatit Martiq, gjegjësisht lagjet e këtij fshati, si ato të lagjes së Qyrjanit, Sjerçit, Kacejve dhe të lagjes së Ramushejve.

Xhamia e Qyrjanit, është xhamia e parë e ndërtuar në trevën e Krajës. Po e të njëjtit vit është e ndërtuar edhe Xhamia në Muriq Nalt në trevën e Shestanit. Nuk ekziston ndonjë gjurmë tjetër e sigurt rreth datës së ndërtimit të kësaj xhamie, por në bazë të disa dokumentave mendohet se u ndërtua diku rreth vitit 1602.

Xhamia nuk është punë e një periudhe të vetme ndërtimi, pasi në hyrje të saj ka pasë të ndërtuar hajatin e saj, kurse me kalimin e kohës, ajo pjesë është mbyllur dhe është shtuar një kthinë tjetër në pjesën e brendshme të saj, ku është ndërtuar mejtepi i xhamisë. Stili i ndërtesës, gjërësia e mureve, lloji i materialit ndërtimor, vendodhja e saj, jep të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar vjetërsinë e saj. Përsa i përket ndërtuesit të xhamisë së Qyrjanit mund të ngrihen vetëm supozime, sepse nuk është ruajtur asnjë mbishkrim për të vërtetuar këtë me saktësi.

Me gjithë punën e madhe që është bërë gjatë meremetimeve të kësaj xhamie, forma origjinale e saj nuk është ndryshuar, kurse pamja e saj estetike ka ndryshuar çdo herë që janë kryer ndërhyrje në objekt.



Xhamia e Qyrjanit

Ndërtimi i xhamisë së Qyrjanit - Xhamisë Plakë

Xhamia e Qyrjanit, apo siç e quajnë disa Xhamia Plakë, si xhamia më e vjetër dhe institucioni i parë Islam në trevën Krajë-Shestan, është njëra ndër më të mëdhatë, më e rëndësishmja si dhe një vepër me një vlerë të çmuar.

Ajo është një nga shembujt më me vlerë të arkitekturës osmane. Krahas kësaj bëjnë pjesë edhe xhamitë e tjera të ndërtuara gjatë periudhës osmane në këtë trevë. Xhamia ndodhet në hyrje të lagjes së Qyrjanit, prej nga ka marrë edhe emrin e saj, dhe në përbërjen e vet

përfshin pjesëtarët (xhematin) e fshatit Martiq, gjegjësisht lagjet e këtij fshati, si ato të lagjes së Qyrjanit, Sjerçit, Kacejve dhe të lagjes së Ramushejve.

Xhamia nuk është punë e një periudhe të vetme ndërtimi, pasi në hyrje të saj ka pasë të ndërtuar hajatin e saj, kurse me kalimin e kohës, ajo pjesë është mbyllur dhe është shtuar një kthinë tjetër në pjesën e brendshme të saj, ku është ndërtuar mejtepi i xhamisë. Stili i ndërtesës, gjërësia e mureve, lloji i materialit ndërtimor, vendodhja e saj, jep të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar vjetërsinë e saj. Përsa i përket ndërtuesit të xhamisë së Qyrjanit mund të ngrihen vetëm supozime, sepse nuk është ruajtur asnjë mbishkrim për të vërtetuar këtë me saktësi.

Ndërtimi i xhamisë patjetër duhej t'u përmbahej disa kriterëve. Kriteri i parë ishte ndërtimi i murit të përparmë të harimit (vendi kryesor i adhurimit-faljes) në drejtim të Mekes. Ndërkaq, zemra e xhamisë ishte vendi kryesor i lutjeve që quhej harim. Madje, emërtimi i këtij muri të përparmë të harimit si mur i Kibles vjen pikërisht prej kësaj.¹ Roli kryesor i këtij muri është, sepse gjatë kohës së lutjes së namazit besimtarët formojnë rreshtat (safet) njërin pas tjetrit paralel me këtë mur të Kibles. Kështu, fytyrat e tyre

1. David Macaulay, Xhamia, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2012, f. 10.

kthehen drejt qytetit të shenjtë të Mekës.

Në mes të murit të Kibles gjendet mihrabi. Gjatë kohës së lutjes së imanit kjo pjesë, nga e cila imami drejton xhematin, pra nga ku drejtohet falja e namazit, simbolizon derën e parajsës (Xhenetit) dhe hyrjen në parajsë (Xhenet).²

Xhamia e Qyrjanit karakterizohet me oborrin rreth saj, ku gjinden shumë varreza, si një ndër varrezat më të hershme, të dekoruara me simbole të ndryshme. Brenda xhamisë një përshtypje të madhe të lë një sallë e madhe, ku falet namazi me xhemat (namazi kolektiv).

Xhamia është e gjatë 15.30 m. (në dy anë) dhe e gjerë 9.57 m. (në dy anë) edhe pse në shikim të parë duket një ndërtesë në formë katrore. Trupi kubik i xhamisë është i ndërtuar në një mënyrë, që është shumë e përhapur në trevën e Krajës. Katër qoshet e kubit janë pak të pjerrëta dhe kështu hapësirat trekëndore të formuara, janë të mbuluara me tjegulla.

Xhamia e Qyrjanit është ndërtesa më e vjetër dhe e vetmja ndërtesë osmane e ruajtur në këtpë lagje dhe njihërit ajo njihet si një ndër më të mirat në tërë trevën e Krajës. Ajo ndodhet buzë një kodre në hyrje të lagjes së Qyrjanit, në pjesën përendimore të saj. Aty ku është ndërtuar xhamia, mu buzë saj, dikur kalonte rruga kryesore

2. Po aty, f. 10.

e cila të çonte në lagjen e Sjerçit dhe njëkohësisht e njëjta rrugë të çonte edhe për në Vaun e Sjerçit ku ishin të përqëndruara shitoret dhe kooperativa e peshkut në trevën e Krajës.

Xhamia e Qyrjanit, është xhamia e parë e ndërtuar në trevën e Krajës. Po e të njëjtit vit është e ndërtuar edhe Xhamia në Muriq Nalt në trevën e Shestanit. Nuk ekziston ndonjë gjurmë tjetër e sigurt rreth datës së ndërtimit të kësaj xhamie, por në bazë të disa dokumentave mendohet se u ndërtua diku rreth vitit 1602.³

Thuhet se islamizimi i popullsisë së Krajës dhe të Shestanit depërtoi nga qytetet përreth kësaj treve, e sidomos nga Shkodra. Menjëherë me depërtimin e Islamit në këtë trevë filloi edhe ndërtimi i objekteve fetare-xhamive. Kështu që në këtë periudhë të depërtimit të fesë Islame në këtë trevë u ndërtua xhamia e parë, e mbiquajtur Xhamia e Qyrjanit. Shembullin e ndërtimit të objektit të parë fetar në trevën e Krajës, por edhe të asaj të trevës së Shestanit e ndjekin edhe fshatrat e tjera të kësaj treve Krajë-Shestan, gjë që bëri që për një kohë të shkurtër kjo trevë të islamizohet në masë,

3. Për më tepër shih librin: Bajro Agović, Džamije u Crnoj Gori, Podgorica, 2001, f. 216. (Fusnoten 68-Arhiv Odbora Islamske zajednice Stari Bar, Spisak džamijskog imetka-džamija u barskom kadiluku - maj-juni 1916).

ku bëri të mundur që popullsia e saj gradualisht të braktisë kishat dhe varrezat e të parëve, të cilat me kalimin e kohës u zhdukën.

Me ndërtimin e xhamisë së Qyrjanit filloi edhe aktiviteti dhe praktikimi haptas i riteve fetare islame në këtë trevë. Me hapjen dhe funksionimin e kësaj xhamie, vinin njerëz nga të gjitha anët e trevës së Krajës mbase edhe më gjerë për të kryer ritet fetare islame. Në atë kohë, kjo xhami kishte grumbullimin më të madh të njerëzve për të kryer ritet fetare islame. “Besimi i vërtetë skalitet thellë në zemër. Atë besim më pas e vërtetojnë veprat.”⁴

Kjo xhami, ishte edhe xhamia më e rëndësishme e kohës, duke pasur parasysh se ishte xhamia e parë e çelur në këtë trevë, duket se ka patur një popullaritet të madh. Padyshim, kjo xhami është projektuar nga arkitekti i kohës, për të qenë tipar dominues arkitekturor i kësaj treve. Nuk dihet dhe nuk kemi gojëdhëna të sakta se nga kush është ndërtuar kjo xhami, nga ndonjë bamirës apo nga ndonjë sundimtar i kohës në këtë trevë, por dihet dhe ka të dhëna se ndërtimi i kësaj xhamie është bërë me depërtimin e turqve dhe me përqafimin e fesë islame të popullsisë së kësaj treve. Në fakt nuk kemi ndonjë dokument në dispozicion apo ndonjë mbishkrim, me anën e të cilit mund të konfirmohet një

4. Jakup Asipi, Për diturinë, Kumanovë, 2012, f. 267.

gjë e tillë, por mund të supozohet se dikush nga sundimtarët turq, (mbase Sulltani - H.A.) ka udhëruar ndërtimin e kësaj xhamie.

Muret e saja ndërtuese janë të ruajtura thujse plotësisht nga origjinali i tyre, “që janë një pasqyrë e së kaluarës së gjatë dhe të pasur”⁵ të kësaj treve, e në veçanti të lagjes ku është ndërtuar kjo xhami. Trashësia e mureve të kësaj xhamie është 70 cm, të ndërtuara nga gurët e marrë në afërsi të xhamisë, përreth kodrës ku edhe është ndërtuar.

Kornizat e dritareve janë të punuara nga gurë mesatar të punuar mirë, të cilëve u është dhënë një sipërfaqe e lëmuar, kryesisht nga ana e jashtme e vendosjes së gurit në vendin e duhur në dritare. Me vendosjen e këtyre gurëve në dritare, dritarja ka marrë pamjen e një punimi të vërtetë të kohës. Punimi i këtyre gurëve nga mjeshtri punues ka qenë shumë i rregullt dhe i saktë. Gurët e dritareve janë të vendosur në atë mënyrë që të formonin kornizën e dritares. Në këtë mënyrë janë të ndërtuara kornizat e të gjitha dritareve të kësaj xhamie, me përjashtim të dy dritareve të rumbullakëta të vendosura në murin e mihrrabit, në të dy anët e tij.

Të gjitha dritaret ishin të një madhësie të njëjtë, me përjashtim të dy dritareve në formë të rumbullakët, të ndërtuara prej materialit të

5. Machiel Kiel, Arkitektura Osmane në Shqipëri 1385-1912, Tiranë, 2012, f. 63.

drurit. Gjatë meretimemeve të herëpashershme, edhe dritaret kanë pësuar ndryshime, disa prej tyre (3 dritare në sallën e faljes-H.A.) janë zmadhuar e shumica prej tyre janë origjinale.

Muret rrethuese të xhamisë janë të gjëra, sipas mënyrës së ndërtimit të kohës. Kjo mund të na çojë në përfundimin se forma e xhamisë nuk ka ndryshuar në themel, që nga ndërtimi i saj.

Në fillim kjo xhami nuk kishte oborr të përcaktuar në mënyrë të veçantë kurse me kalimin e kohës në një mënyrë a një tjetër u përcaktua, pra u rrethua edhe oborri i saj, punë e cila u bë në bazë të ndihmave dhe punës vullnetare të pjesëmarrësve (xhematit) të saj. Minarja e xhamisë nuk ishte e ndërtuar, pra e ngjitur për faqen e murit të xhamisë, por ishte e ndërtuar mbi një kodër, në anën e derës hyrëse të xhamisë, prej ku shihen të gjitha lagjet, me përjashtim të lagjes së Sjerçit, që i përkasin kësaj xhamie, por edhe mëhallët e tjera të trevës së Krajës. Ajo kishte formë të rrumbullakët, me një murë të thatë, prej ku muezini lajmëronte kohët e faljes së namazit dhe rastet e vdekjes. Në vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar, kësaj xhamie iu ndërtua edhe minarja e re në anën përendimore të saj, përkatësisht në anën e majtë të derës hyrëse të xhamisë, minare e cila e hijeshoi edhe më shumë.

Pamja e sotme e xhamisë së Qyrjanit është një version i

rikonstruktuar i ndërtimit të bërë që në kohën e ndërtimit të saj. Kjo xhami së bashku me disa ndërtesa tjera të vjetra në trevën Krajë-Shestan nuk njihen si monumente kulture, megjithëse domosdoshmëria e lyp që të jenë të tilla.

Xhamia e Qyrjanit së bashku me xhamitë e tjera në trevën Krajë-Shestan, që nga viti 1982 janë të organizuara dhe veprojnë si Këshill i Bashkësisë Islame në Krajë me seli në Ostros. Para vitit 1982 të gjitha xhamitë e trevës në fjalë ishin pjesë përbërëse e Bashkësisë Islame të Tivarit, trevë e cila i përket kësaj komune, kuptohet që me aneksimin e saj nga Mali i Zi, ndërsa para kësaj periudhe të gjitha xhamitë e trevës Krajë-Shestan ishin pjesë përbërëse e Myftinisë së Shkodrës.

Xhamia origjinale e Qyrjanit nuk është e ruajtur plotësisht, pasi ajo do të ketë pasur ndryshime të njëpasnjëshme, si në riparim, suvatim apo të shtimit të ndonjë kthine, mbase edhe mbyllja e përparme e hajatit të saj, por në përgjithësi mund të thuhet se pjesa më e madhe e saj është origjinale.

Pra nga sa u tha më sipër, shihet se xhamia sot është një produkt i një restaurimi të plotë në periudha të ndryshme kohore, sidomos gjatë dekadave të fundit të shekullit XX. Kështu, vlera e saj për historinë e arkitekturës osmane të asaj kohe është e papërfillshme, ndërsa për historinë e kësaj treve, për një studim

të veçantë, ajo është e një rëndësie të veçantë. Si një vepër e veçantë arkitekturore e kohës së vet, xhamia e Qyrjanit ka qenë më e rëndësishmja në trevën Krajë-Shestan. Ajo është i vetmi monument osman dhe një nga shembujt më me vlerë të arkitekturës osmane, gjer më sot, i ruajtur në trevën Krajë-Shestan.

Ndonëse humbja e originalitetit të ndërtimit të xhamisë së Qyrjanit ka lënë pasojë negative në ruajtjen e objektit ashtu siç është ndërtuar, objekt i cili dëshmon qartë për kultivimin e traditës, kulturës e jetës shoqërore të banorëve të trevës së Krajës, ajo gjithsesi ka mundur të pasqyrojë gjurmët e thella të zhvillimit shpirtëror dhe thellimit të besimit në fenë islame të popullit të kësaj treve. Ndikimi i saj në praktikimin e fesë islame të popullit të trevës së Krajës ka qenë i konsiderueshëm.

Përshkrimi i brendshëm i Xhamisë së Qyrjanit

Kur bëjmë përshkrimin e brendshëm të xhamisë theksojmë dimensionet dhe pjesët ndarëse të saj, duke e paraqitur në mënyrë kronologjike brendësinë e saj. Hapësira e brendshme e xhamisë përfshin një hapësirë prej 85m².⁶

6. Bajro Agović, Džamije u Crnoj Gori, Podgorica, 2001, f. 216. (Arhiv Odbora Islamske zajednice Stari Bar, Spisak džamijskog imetka-džamija u barskom kadiluku - maj-juni 1916).



Dy shtyllat mbajtëse në sallën kryesore të faljes

Mirëpo, kjo hapësirë prej 85m² nuk është e qartë dhe shumë e kuptueshme se cilës ndarje i përket, sallës së faljes apo tërë hapësirës së brendshme të xhamisë, pasi nuk është e mundur që të jetë hapësira e brendshme e xhamisë (85m²), duke pasur parasysh se hapësira e saj e brendshme është shumë më e madhe. Mirëpo, gjithsesi, pjesën më të madhe të hapësirës së brendshme të xhamisë e zë salla e faljes me 56 m²., pra me një gjatësi prej 8 m. dhe një gjërësi prej 7 m. Sallën e lutjeve e ka të projektuar në formë katrore.

Përballë mihrabit, është i ndërtuar një vend tjetër lutjesh që ngrihet mbi kolona, në formën e një kati të dytë, dhe është vendi ku rrinë gratë.

Xhamia ka dy mbajtëse-shtylla, me lartësi prej 2.5 m., me një distancë prej 2 m. nga njëra-tjetra, kurse shtyllat janë të gjëra 23x23 cm. Ato kanë një funksion të dyfishtë sepse mbajnë tavanin

dhe shënojnë fundin e hajatit të gjerë të grave, i vendosur mbi këto dy shtylla, dhe prej hajatit e deri në tavan ka një lartësi prej 3 metrash.



**Hajati i grave (salla e grave)
kati i dytë**

Hajati i grave, apo siç njihet në popull “vendi ku falen gratë” në mes të hapsirës së saj është pak i dalë mbi sallën kryesore të faljes, që formon një ballkon me dimensione 110x110 cm. dhe është i ndërtuar prej druri.

Në hajatit e grave (sallën e grave) shtyllat (kangjellat) mbrojtëse të hajatit janë prej hekuri (më parë ato kanë qenë të ndërtuara prej druri, me një dekor të posaçëm) dhe gjatësia e tyre, duke përfshirë edhe pjesën e ballkonit është 10 m., edhe këto të dekoruara në formë të veçantë.

Në sallën e grave, në murin ndarës nga korridorit, janë të ndërtuar dy rafte të gjëra 80 cm. dhe të larta 150 cm., me tri ndarje për mbajtjen e sendeve.


Dera hyrëse në sallën e grave është 71 cm. e gjerë, dhe 195 cm e lartë. Kurse, salla e grave është e gjatë 7 m., dhe e gjerë 2.80 m. Ka një dritare në anën e lindjes me dimensione 56 me 100 cm.

Salla kryesore e xhamisë është e ndriçuar mirë nga një sërë dritaresh. Në hyrje të sallës, në krahun e djathtë të saj është një dritare dhe në murin anësor ku gjendet mihrabit, në të dy anët e tij janë dy dritare, kurse mbi mihrab, po në të dyja anët e tij, pak nën tavanin kryesor të xhamisë, janë të vendosura dy dritare të vogla, që të dyja në formë të rumbullakët. Ato nuk janë dritare origjinale, sepse origjinalet ishin me përmasa më të vogla, të njëjta me përmasat e dritareve të tjera të kësaj xhamie, kurse dy të rumbullakëtat mbi mihrab janë dritare origjinale, pra që nga ndërtimi i xhamisë. Themelet e xhamisë nuk janë të dukshme dhe nuk dihet sa janë të thella dhe të gjëra sepse nuk mund të shihen, mirëpo ato janë të mbuluara nga një shtresë e trashë llaçi, duke lënë përshtypjen e një muri të ndërtuar me gurë të rregullt dhe të mëdhej të mbushur me llaç.

Dritaret e xhamisë në formën e tyre origjinale janë të rregulluara sipas ritmit të caktuar. Ajo në hyrje të sallës, në krahun e djathtë të saj, dhe dy të tjerat në të dy krahët e mihrabit, pra në murin e mihrabit, nuk janë origjinale. Ato janë zmadhuar dhe janë bërë me përmasa

më të mëdha se ato të mëparshmet, ku dimensionet e tyre janë 120 me 130 cm., kurse dy dritaret e tjera në formë të rrumbullakët në dy anët e mihrabit, janë origjinale. Dy dritaret në anën e mihrabit dhe dy të rrumbullakëtat në sallën e faljes janë në anën e rrugës së asfaltuar që të çon për në mahallën e Qyrjanit, gjegjësisht për në mëhallën e Sjerçit dhe Vaut të Sjerçit, kurse dritarja tjetër në anën e djathtë të hyrjes në sallën e faljes është e vendosur në anën e ish-rrugës së vjetër (kalldrëm) për në mëhallën e Sjerçit dhe Vaun e Sjerçit. Muri i anës së majtë në sallën e faljes është pa dritare. Në dritare janë vendosur disa shufra hekuri në mënyrë zig-zage, për siguri.

Siç shihet sot xhamia në brendësinë e saj është e ndarë në disa pjesë të cilat janë vendi i faljes apo salla e faljes, hajati i grave ose vendi i grave, dhoma e mejtepit, një dhomë në anën e majtë të hyrjes në xhami, korridori dhe minarja.



Mihrabi dhe minberi i xhamisë


Në sallën e faljes është mihrabi dhe në të djathtë të tij është i vendosur minberi. Këtu bëhet predikimi i ditës së xhuma.

Vendi ku gjendet sot mihrabi i xhamisë është origjinal, mirëpo mund të ketë ndryshime të vogla nga suvatimi dhe renovimi i disa hershëm i mureve të brendshme të xhamisë, kurse mimberit i është ndërruar vendi dhe është bartur në këndin e djathtë të sallës së faljes, prej ku imami mban hytben e rasteve. Mimberi dikur ishte i vendosur në krahun e majtë të mihrabit, mu pranë tij, gjë që e mban në kujtesë edhe autori i këtyre rreshtave, mirëpo me zgjerimin e një dritareje në anën e majtë të mihrabit, minberi është bartur aty ku gjendet sot, në këndin e djathtë të sallës së faljes.

Mihrabi është 100 cm. i gjerë dhe 265 cm i lartë. Para mihrabit është një dysheme e ngritur pak më tepër se dyshemeja e zakonshme e sallës së faljes, ku rrin imami gjatë kryerjes së faljes dhe mbajtjes së ligjëratave islame. Kjo dysheme ka formë katërkëndore dhe është e gjerë 105 cm. me një gjatësi prej 165 cm., duke filluar nga fundi i mihrabit.

Në anën e majtë në drejtim të faljes (në drejtim të murit të Kibles) në brendësi të murit është i ndërtuar (i futur në murë) një lloj sirtari me

dimensione 23x30 cm. që përdoret nga imami i xhamisë për mbajtjen e librave kryesisht atyre fetarë. Po në të njëjtën anë të murit të Kibles, gjendet një ulëse prej betoni në formë shkalle me një gjatësi prej 350 cm. dhe me një lartësi prej 30 cm. mbi dyshe-menë e xhamisë.



Minberi i xhamisë

Mimberi është 80 cm. i gjerë, me lartësi duke filluar nga 15 cm., dhe duke mbaruar me 180 cm. si pika më e lartë e tij, kurse kangjellat janë të larta 70 cm. nga shkallët e mimberit. Pjesa e nëltë e minberit është 120 cm. e gjerë, kurse lartësia e mimberit nga dyshe-meja e sallës së faljes deri në dyshe-menë e sipërme të minberit është 220 cm.


Korridorin e xhamisë së Qyrjanit është 5 m. i gjerë dhe 4.50 m. i gjatë, me një lartësi prej 2.20 m. Në korridorin e xhamisë ka dy shkallë, njëra është te dera hyrëse e xhamisë dhe tjetra për afërsisht 1 m. nga ajo e para.

Korridorin e xhamisë përbëhet nga një dhomë në anën e majtë të derës hyrëse në xhami dhe nga ana

e djathtë janë të vendosura shkallët për në katin e dytë. Shkallët janë dy katëshe të vendosura në anën e djathtë, të mbështetura në mur, ku secili kat përbëhet prej 6 shkallësh, pra gjithsejt janë 12 shkallë për në katin e dytë. Përmasat e shkallëve janë 132 cm. gjatësi me 28 cm. gjerësi dhe 20 cm. lartësi. Korridorin e katin të dytë është i gjërë 3 m. Kur kalon në korridorin e katin të dytë, hasim në ndarje të tjera që i përkasin këtij kati. Në pjesën e përparme, përballë shkallëve, është dera e cila të çon në hajatin e grave, që përbën një ndarëse të katin të dytë dhe ndarja tjetër në këtë kat është dhoma e mejtepit. Po ashtu në korridorin e katin të dytë, me të mbaruar shkallët, në anën e majtë, është dera që të çon për në minaren e xhamisë.

Në anën e majtë, në korridorin e katin të parë të xhamisë, është një dhomë që është ndërtuar më vonë dhe shërben për nevojat e xhamisë, ku janë të sistemuara tavolina, stola prej druri e gjëra të tjera.

Një tipar shumë karakteristik madje edhe antik i xhamisë së Qyrjanit është lartësia 7 m. e tavanit të saj nga dyshe-meja. Ky element tavanit të lartë mund t'i ketë fillimet në periudhat më të hershme. Magjithatë, tavanin e sotëm i përket një restaurimi që i është bërë ambientit të brendshëm të xhamisë, pas viteve '80 të shekullit XX.



Llamba (kandilë) të vjetra në hapësirën e sallës së faljes

Tavani i xhamisë ka qenë i ndërtuar prej druri mesatarisht të gjerë në formë dërrasash, me një dekorim të zakonshëm për kohën, kurse gjatë restaurimit ai u zëvendësua me një tavan më modern, me dërrasa të holla dhe të ngjyrosura me një ngjyrë të shndritshme. Në tavanin e xhamisë, në sallën e faljes, janë të vendosura 11 llamba (7 prej të cilave janë shumë të vjetra) apo siç quheshin në popull kandilë të xhamisë, me anë të të cilave bëhej ndriçimi i saj. Ato janë të përqendruara në një rreth të ndërtuar prej metali me një dekorim të bukur dhe janë të kapura nëpërmjet një teli në tavanin e xhamisë. Janë në një lartësi 3 m. mbi dysheme. Thuhet se ato llamba-kandilë kanë qenë të përcaktuar për secilin fis, për mbajtjen e tyre për ndriçimin e sallës së faljes gjatë faljes së namazit. Janë përcaktuar në këtë mënyrë për arsye se një njeri në atë kohë nuk ka pasur mundësi t'i mbajë të gjithë ato llamba-kandilë me shpenzimet e veta për blerjen e fitilit dhe vaj-gurit.⁷

7. Nga biseda me Fadil Q. Hoxha (67 vjeç), New York, U.S.A. Datë: 15.02.2015.

Pamja e jashtme e xhamisë

Siç kemi cekur edhe më parë, se xhamia është e ndërtuar rrëzë një kodre në hyrje të lagjes së Qyrjanit, me pamjen e saj të lë të mendosh se ajo zë një vend të përshtatshëm për rolin dhe funksionin që ka. Ajo ka një stil të thjeshtë të arkitekturës së vjetër osmane dhe ka një bukuri të veçantë në vendodhjen e saj.

Çatia, apo kulmi i xhamisë siç e quajnë vendasit, është e ndërtuar në formën e zakonshme duke ju përshtatë arkitekturës vendase, e thjeshtë me lëndë drurore. Çdo anë e çatisë ka formën e trekëndëshit. Është e mbuluar me tjegulla në formë gjysëmrrrethore.

Në anën e përparme, në hyrje të xhamisë, mbi derën hyrëse është e ndërtuar një gjysëm hark në mënyrë që dera hyrëse të mbrohet nga shirat.

Mes derës prej hekuri dhe derës hyrëse të xhamisë është një korridor me gjatësi 2 m. dhe gjerësi 1.80 m. Po në të njëjtën anë të murit të përparmë të xhamisë janë të vendosura edhe

pesë dritare me dimensione 65x95 cm.

Në anën lindore të xhamisë, mu buzë saj është e ndërtuar saranxha e cila është pronë e xhamisë, uji i së cilës grumbullohet nga çatia. Uji i saj kryesisht përdoret për nevojat e xhamisë, si për pije dhe për marrjen abdes të xhematit të kësaj xhamie. Kohëve të fundit, pranë kësaj saranxhe është ndërtuar edhe një kthinë e vogël ku është ndërtuar tualeti dhe vendet për marrjen abdes.

Kurse në anën përendimore të xhamisë janë të ndërtuara dy bunarë 7-8 m të thellë. Ato janë ndërtuar me donacione dhe thirren nga banorët e lagjes me emrin “*ublat nel*”. Edhe uji i këtyre ublave është përdorur për nevojat e xhamisë. Ato janë përdorur edhe për nevojat e popullsisë së lagjes së Qyrjanit, zakonisht kur mungonte uji në familjet e kësaj lagjeje.

Minarja e xhamisë

Minarja si pjesë e xhamisë, në fillim të periudhës islame nuk ka ekzistuar. Në disa xhami të njohura minaret kanë qenë të ndërtuara në atë mënyrë që kanë shërbyer edhe si kulla vrojtuese, prej nga janë ruajtur xhemati në xhami deri sa kanë kryer ritet (faljet) fetare islame. Me kalimin e kohës ato lloj minarësh-kulla, nga arsyeja se kanë qenë të ndërtuara në një lartësi mesatare, kanë shërbyer për muezinët e xhamisë gjatë thirjes së ezanit, në mënyrë që zëri të dëgjohej sa më larg.

Minarja gjithmonë ka qenë një punë e mundimshme e arkitektëve për arsye se në minare ato nuk kanë parë vetëm anën funksionale të saj, që muezini të bëjë thirjen në falje, por gjithherë janë munduar që të projektojnë simbolikën e qëndrimit të saj, estetikën e saj, lartësinë e duhur të saj, etj. Andaj, minarja për këtë arsye ka mbetur pjesë e pandashme e xhamisë dhe njëherazi edhe si shenjë e arkitekturës islame.

Ndërtimi i minares përbëhet nga tri pjesë, të cilat janë:

1. Baza.

2. Trupi - Trupi i minares është pjesë e vazhdimit të minares, thjeshtë në mënyrë poligonale-cilindrike. Brenda trupit të saj gjenden shkallët, në formë rrethore, thjesht në mënyrë të kundërt të akrepave të orës.

3. Galeria - Kjo pjesë e minares përfshin ballkonin e minares, që gjendet në pjesën e sipërme të trupit të saj, prej nga muezini thërret ezanin.



Minarja e vjetër mbi një kodër

Minarja nuk është ndërtuar në të njëjtën kohë me xhaminë e Qyrjanit. Ajo ishte në anën hyrëse të xhamisë, përballë saj, mbi një kodër, përafërsisht 50 m. larg xhamisë. Ajo ishte e vendosur mbi atë kodër disa metra lartësi (mbase 4-5 m.) mbi rrugën e vjetër që të çonte për në mëhallën dhe Vaun e Sjerçit. Është e rrethuar me një murë të thatë, me gurë mesatarë ku në qendër të saj është i vendosur një gurë i madh, çka lë të kuptohet se ai gur ishte ekzistues dhe rreth tij është bërë muri i thatë me gurë dhe i është dhënë forma e një minareje të thjeshtë të ngritur mbi atë kodër. Lartësia e minares në fjalë sillet prej 1.5-2 metra, pasi që nuk është e njëjtë në të gjitha anët, kurse gjërësia e saj është 2 metra. Guri në mes të minares është i lartë 70 cm, kurse gjërësia dhe gjatësia e tij vijnë në formë të thyer, dhe mund të jenë disa cm.

Pozita e kësaj minare ishte në një vend shumë të përshtatshëm, pasi sa herë që muezini thirrte ezanin dëgjohej në shumë fshatra të Krajës. Se kur është ndërtuar saktësisht ajo nuk dihet dhe nuk kemi dokumentacion përkatës rreth saj, por në kujtesë të të moshuarve dihet se ajo u ndërtua vonë nga njerëz bamirës, duke menduar se do të ishte më praktike që ezani të thirrej nga një kodër, pasi para saj ezani thirrej prej vendit të quajtur tani “te bagremi”. Kjo minare ka shërbyer si çdo minare tjetër, për thirrjen e ezanit

prej ku muezini lajmëronte kohët e namazit dhe rastet e vdekjeve. Sot kjo minare nuk përdoret nga muezinët e xhamisë, megjithatë ajo duket shumë piktoreske dhe interesante. Ajo tani pothuajse ka mbetur si vend muze i lagjes së Qyrjanit. Me ndërtimin e minares së re të xhamisë së Qyrjanit, minarja në fjalë doli pothuajse plotësisht jashtë përdorimi.



Minarja e re

Minarja e re, u ndërtua në vitet ‘80 (1983/84)⁸ të shekullit të kaluar (XX). Minarja e re nuk është ndërtuar në brendësi të xhamisë siç ndërtohen disa minare moderne të kohës, por ajo u ndërtua mbi një bazë disa këndore të ngritur përafërsisht 1m larg nga muri i jashtëm i xhamisë. Minarja e re është ndërtuar nga fondet bamirëse me origjinë nga Arabia Saudite. Ajo

8. Nga biseda me Gëzim Alaj (Aktualisht Myteveli i Xhamisë së Qyrjanit, Glendale, NY, 14.11.2016).

është e gjatë 18 m. dhe e gjerë 2 m. Nuk ka formën të rrumbullakët por ka formën këndore. Minarja e re gjithashtu ka edhe ballkonin që është në formë të rrumbullakët prej ku muezini thërret ezanin.

Për në minare hyhet nga brenda xhamisë. Brendësia e minares është një hapësirë e zbrazët me një diametër prej 1 m., ku janë të vendosura shkallët e saj prej ku dilet në ballkonin e minares. Ato janë në formë spirale me një shtyllë hekuri në mes. Dera hyrëse e minares që gjendet në korridorin e katit të dytë të xhamisë është 62 cm. e gjerë dhe 195 cm. e lartë.

Një pjesë tjetër e rëndësishme minares është edhe pjesa ku thirret ezani e që quhet “pjesa e sherefes”. Minarja nga shrefja lartësohet përafërsisht edhe 6 m., por shkallët e saja nuk vazhdojnë më tej. Ajo është e zbukuruar mirë, me një gjysmë hënë. Kjo majë e minares quhet “alem”. Alemi është një zbukurim i veçantë i kapur mirë pas pjesës tjetër të majës së minares.



Mejtepi i xhamisë së Qyrjanit

Mejtepi i xhamisë

Me ardhjen e turqve në Shkodër e vende të tjera përreth Krajës, në fillim themelohen institutet fetare e pranë tyre edhe shkollat elementare, në qendrat e mëdha administrative, përreth Krajës, si në Ulqin, Shkodër, etj. Pra, shkollat elementare ishin mejtepet, të cilat kanë qenë të vendosura në xhami. Në ato shkolla (mejtepe) mësohej shkrimi dhe leximi elementar, pak aritmetikë e më së shumti besimi.

Në trevën e Krajës për herë të parë një shkollë (mejtep) e tillë u çel në Xhaminë e fshatit Qyrjan.⁹



Sirtar librash

Mësimi kryesisht bëhej në gjuhë turke, por si gjuhë mësimi (qoftë edhe ndihmëse) u përdor edhe gjuha amtare, gjuha që flisnin nxënësit dhe hoxhallarët vendas dhe kishte karakter fetar. Mësimin kryesisht e zhvillonin hoxhallarët. “Programi niste me mësimin e alfabetit arabisht,

9. Dr. Hajrullah Koliqi, Kraja ndër mote, Prishtinë, 1993, f. 58.

që do të shërbente për leximin e mësimin e Kur'anit, duke e shkruar atë në një fletore të veçantë. Mësimi zhvillohej rregullisht, nxënësit qëndronin të ulur në gjunjë para hoxhës kurse hoxha qëndronte në krye, i ulur në një post ose mbi ndonjë qilim të sjellur nga fshatarët në shenjë dhurate në xhami. Fëmijët rrinin të gjithë së bashku pasi mësimi zhvillohej në mënyrë kolektive...¹⁰ Mejtepi në xhami është në katin e dytë, në anën e djathtë të hyrjes në sallën e grave. Mejtepi përfshin disa banka, karrige dhe një dërrasë të zezë. Tavani është i mbuluar me dërrasa të lëmuara me një llambë elektrike në mes. Dyshemeja është e shtruar me tapetë të dhuruar nga njerëzit bamirës dhe vullnetmirë. Pjesë e saj është edhe një dollap librash, pra përfshin edhe bibliotekën e xhamisë. Sipërfaqja është 15m².

Nuk kemi ndonjë të dhënë nëse para mejtepit të xhamisë së Qyrjanit ka ekzistuar ndonjë mejtep apo ndonjë institucion tjetër islam në trevën e Krajës, ku është mësuar apo predikuar diçka nga feja islame. Mund të ketë pasur mënyra të tjera të mësimin të pjesëve kur'anore por jo në mejtepe të hapura enkas për mësim të fesë islame. Po të mos merren parasysh mënyrat e tjera të të mësuarit të pjesëve kur'anore,

10. Smajl Bala, Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662-1945), V. 1., Shkodër, 2011, f. 29.

atëherë mund të thuhet se mejtepi i hapur pranë xhamisë së Qyrjanit është shembulli i vetëm që dëshmon për një institucion islam të një niveli të lartë arsimit të kohës në trevën e Krajës.

Meremetimi i xhamisë së Qyrjanit



Gjatë ndërrimit të çatisë së xhamisë

Xhamia e Qyrjanit ka parë meremetime të herëpashershme. Ato kanë qenë të niveleve të ndryshme, për të cilat janë marrë vendime të ndryshme nga Këshilli i Xhamisë. Në bazë të dhurimeve të ndryshme, duke grumbulluar ndihma financiare prej njerëzve vullnet mirë është bërë e mundur që të kryhen disa meremetime si brenda edhe jashtë xhamisë.

Xhamia e Qyrjanit si objekti i parë Islam në trevën e Krajës, që nga ndërtimi i saj e deri më sot ka pësuar dëme të ndryshme. Gjatë meremetimit të vitit 2014/15, u rregulluan dhe meremetuan shumë prej dëmeve që kishte shkaktuar

koha dhe vjetërsia e saj. Është suvatuar nga brenda dhe është bërë shtrimi i dyshemesë dhe janë zgjeruar dritaret nga ana e rrugës, pra në anën e mihrabit dhe dritarja në anën e djathtë të hyrjes në sallën e faljes. Pastaj është bërë meremetimi i pjesës së sipërme të sallës së grave-ballkonit, kështu që ajo është shtruar me beton dhe janë betonuar edhe shtyllat mbajtëse të ballkonit të përqendruara në sallën kryesore të faljes. Janë rregulluar shkallët për në katin e dytë dhe të gjitha dyert e xhamisë. Është bërë meremetimi dhe suvatimi i një dhome ndihmëse në të majtë të hyrjes në korridorin e xhamisë, dhomë e cila ka shërbyer si magazinë, ku janë mbajtur gjëra të nevojshme. Është bërë zëvendësimi i tavanit të xhamisë me një të ri, të punuar me një lloj druri të gdhendur mirë.



Gjatë meremetimit të fasadës së jashtme të xhamisë

Është bërë suvatimi i korridorit në të dy katet e saj, si dhe është bërë meremetimi i mejtepit të xhamisë

po ashtu në katin e dytë. Të gjitha këto meremetime nuk janë bërë menjëherë, por ato kanë vazhduar të kryhen për një kohë të gjatë. Kjo ka ndodhur nga arsyeja se vetë xhamia nuk ka pasur fond të mjaftueshëm financiar, andaj pothuajse çdo meremetim është kryer nga financimi i njerëzve bamirës dhe vullnetmirë dhe nga grumbullimi i fondeve financiare.



Porta e re hyrëse në vendparkingun e xhamisë

Edhe nga ana e jashtme e xhamisë është bërë një punë meremetuese e mjaftueshme. Është suvatuar dhe lyer i tërë muri i jashtëm i saj.

Ndërhyrja e fundit është bërë në vitin 2014, pasi u grumbullua një shumë financiare nga mërgimtarët e katër mëhallëve (Qyrjan, Kacej, Sjerç, Ramushej) që i përkasin xhamisë së Qyrjanit dhe nga mërgimtarët e tjerë që dhanë ndihmën e tyre financiare për meremetimin e kësaj xhamie.

Një punë e madhe është bërë edhe në çatinë e xhamisë, në periudha të ndryshme kohore. Disa herë janë zëvendësuar tjegullat dhe ku ka pasur nevoje edhe lënda drusore e çatisë, ndërsa në vitin 2015

iu bë një meremetim i plotë. Po ashtu xhamisë i janë vendosur edhe ullukët kullues të përfshira në të katër anët e saj për të grumbulluar ujin e reshjeve nga çatia, kështu që një sasi e atij uji derdhet në bunarin (saranxhën) e xhamisë kurse sasia tjetër në oborrin e xhamisë.

Kohëve të fundit është bërë një ndërhyrje edhe në korridoret e xhamisë. Janë shtruar me pllaka qeramike të dy korridoret në katin e parë dhe të dytë, janë shtruar po ashtu edhe shkallët që çojnë për në katin e dytë me gurë mermeri, dhe njëkohësisht janë vendosur edhe parmakët (kangjellat) mbrojtës në shkallët e korridoreve.



Ndërtimi i mureve në anën e pasme të xhamisë

Edhe në oborrin e xhamisë është bërë një punë e madhe. Në vitin 2004 është bërë rrethimi i oborrit të xhamisë me shtylla prej

hekuri dhe me rrjetë me financimin e mërgimtarëve të katër mëhallëve (Qyrjan, Kacej, Sjerç, Ramushej) që i përkasin xhamisë së Qyrjanit por që jetojnë në SHBA. Me këtë rast u ndërtua edhe parkingu i xhamisë, i cili u zgjerua dhe u betonua me një sipërfaqe prej 337.50 m², pra me një gjatësi prej 22.50 m. dhe gjerësi prej 15m., ku përafërsisht mund të parkohen deri në 35 makina. Kurse oborri i xhamisë në total ka një sipërfaqe prej 1400 m², me një gjatësi prej 40 m. dhe një gjerësi prej 35 m.

Po ashtu në oborrin e xhamisë është bërë edhe ndërtimi i mureve në anën e rrugës kryesore që të çon për në mëhallën e Qyrjanit, pra në anën e pasme të xhamisë. Aty ka qenë vetëm një mur disa metra (5m.) larg themeleve të xhamisë Ky mur (muri i mëparshëm) ka një gjatësi prej 12 m., dhe lartësia e tij është 1.60m., kurse trashësia e murit është rreth 30 cm. Në këtë mur janë të vendosura llambat elektrike për ndriçimin e murit të xhamisë, nga rruga kryesore që të çon në mëhallën e Qyrjanit.

Me gjithë punën e madhe që është bërë gjatë meremetimeve të kësaj xhamie, forma origjinale e saj nuk është ndryshuar, kurse pamja e saj estetike ka ndryshuar çdo herë që janë kryer ndërhyrje në objekt.

Literatura

- Halit Muharremi, *Fjalori i Teologjisë*, Tiranë, 2006.
- Tahir N. Dizdari, *Fjalori i Orjentalizëmave në Gjuhën Shqipe*, Boton: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë.
- Fjalori i Shqipe së Sotme*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002.
- Ruqaiyyah Waris Maqsood, *Fjalori Bazë i Islamit*, Tiranë, 2008.
- Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, *Xhamia dhe roli i saj në shoqëri*.
- Dr. Muhamed Mufaku, *Xhamitë dhe Mesxhidet e Beogradit*, Prishtinë, 2000.
- “Kur’ani”, (Përktheu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti), New York 1992.
- Hajrudin S. Muja, *Ulqini dhe Tivari ndërmyjet Krishterimit dhe Islamit*, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2009.
- Imam Vehbi Ismaili, “Vepra 7” (Mrekullia e Madhe-Israja dhe Miraxhi), Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2009.
- Shaqir Ismaili, *Bojku në Anë të Malit*, Ulqin, 2011.
- Dr. Shefqet Krasniqi, *Shtatë grupet e lumtura ditën e gjykimit*, Prishtinë, 2012.
- Jakup Asipi, “Për diturinë”, Kumanovë, 2012.
- Machiel Kiel, *Arkitektura Osmane në Shqipëri 1385-1912*, Tiranë, 2012.
- Bajro Agović, *Džamije u Crnoj Gori*, Podgorica, 2001.
- Nga biseda me Fadil Q. Hoxha, New York, U.S.A. Datë: 15.02.2015.
- Dr. Muhammed Ali El Hashimi, “Shoqëria Ideale - Shoqëria ideale muslimane sipas Kur’anit dhe Sunetit”, Prishtinë, 2009.
- Web faqa: “Islamieshtedrite.com.”
- Web faqa: “Shembulli - Portal.”
- Hamid Alaj, *Huazimet turko-osmane në të folmen e Krajës*, New York, 2009.
- Hamid Alaj, *Zhvillimi i shkollave dhe arsimit në trevën e Krajës dhe të Sbestanit*, Ulqin, 2014.
- Smajl Bala, *Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662-1945)*, V. 1., Shkodër, 2011.
- Dr. H. Koliqi, *Kraja ndër mote*, Prishtinë, 1993.
- Mehdi Frashëri, *Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve*, Plejad, 2012.
- OJQ “Harmonia”, *Jeta dhe veprimtaria e Sheh Tabir Tanaqit*, Ulqin, 2014.
- Dr. Hasan Kaleshi, *Dokumentet më të vjetra të vakëfëve në gubën arabe në Jugosllavi*, Prishtinë, 2012.
- David Macaulay, *Xhamia*, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2012, (Përktheu nga turqishtja Xhemile Abdiu).
- Imam Vebi Ismaili, “Vepra 5” (Islamizmi dhe lutjet), Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2009.
- Fadil Sulejmani, *Lindja, martesat dhe mortja në Malësitë e Tetovës*, Prishtinë, 1988.
- Drita Halimi-Statovci, *Nga djepi në përjetësi*, Prishtinë, 2014.
- Mark Krasniqi, *Besa në traditën shqiptare*, Prishtinë, 2011.
- Mark Krasniqi, *Toleranca në traditën shqiptare*, Prishtinë, 2007.
- Abdulaziz en-Neda, *Enciklopedia e sjelljeve dhe rregullave Islame*, (Përktheu nga arabishtja: Sadush Tahiri), Shkup, 2010.
- www.broj19-number19.org › Kolumne (Ostrva na Skadarskom jezeru – Vakufi – Broj 19 – Number 19).
- Kadri Halimi, *Studime etnologjike*, Prishtinë, 1994.
- Nermin Vlora-Falaski, *Pellazgët-Ilirët-Etruskët-Shqiptarët*, Prishtinë, 2014.
- Zekerija Idrizi, *Xhamia në analet e historisë*, Zürich, 2009.

Filozofia islame

Msc. Ana Gjeçi

Abstrakt

Një tjetër traditë filozofike e rëndësishme dhe origjinale e filozofisë mesjetare është filozofia islame. Filozofia islame ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në historinë e kulturës, jo vetëm në ruajtjen e njohurive, por në pasurimin e kontributeve të reja, pasi filozofia perëndimore hyri në një “epokë të errët”. Nga kjo përjasje kuptojmë se filozofia islame është një traditë e filozofisë që u krijua midis filozofisë së lashtë dhe filozofisë skolastike të shekullit të dymbëdhjetë. Filozofia islame mund të përshkruhet si një traditë e filozofisë e lindur nga kultura islame në tërësi, meqë filozofia islame nuk shprehet vetëm në gjuhën arabe dhe në formimin e saj kanë kontribuar edhe të tjerë përveç myslimanëve.

Edhe filozofia islame studion thelbin dhe qëllimin e objekteve, fillimin dhe fundin e tyre, por kalon nga shpallja dhe profetësia. Pra, fillimi është Zoti (Allahu) dhe fundi është Dita e Fundit. Pra, dy qëllimet kryesore të filozofisë islame janë dijet rreth Zotit dhe Ditës së Fundit. Profetësia nuk është një qëllim i kësaj filozofie, por një mjet për të arritur te dy qëllimet e mësipërme.

Filozofia islame, ashtu si metafizika, nuk bie ndesh me dijet ndijore, teknike dhe ligjet e natyrës. Ajo është më e veçantë se metafizika, ndërsa metafizika është më e gjerë se ajo, sepse metafizika thelbin e objekteve dhe fillimin e parë (mebde-i eu-uel) nuk e mbështet te Zoti, te qëllimi i objekteve dhe te Dita e Fundit.

Duhet përmendur se takimi dhe angazhimi i myslimanëve me filozofinë nuk ishte aspak aksidental dhe rastësor, siç pretendohet në Perëndim. Përkundrazi, gjithçka erdhi mjaft natyrisht me përhapjen e Islamit dhe filozofia gjeti “tokën e përshtatshme” ku mund të zhvillohej, prej vetë natyrës së fesë Islame, e cila i jep rëndësi dijes dhe i lë vend përdorimit të arsyes. Gjithashtu Islami ka shërbyer si urë lidhëse e filozofisë së lashtë me atë perëndimore, sigurisht, duke mos u mjaftuar vetëm me përcjelljen, por edhe me zhvillimin e saj.

Duhet theksuar se shkollat e asaj kobe në Perëndim nuk ishin në nivelin e atyre myslimane, prandaj mjaft shërbyes të fesë dhe njerëz të pasionuar pas dijes frekuentonin shkollat islame (medrese) në qytete të ndryshme të Italisë, si në Sicili dhe Napoli. Madje duke imituar sistemin e medreseve të asaj kobe u themeluan edhe universitetet e para në Evropë (në Bolonjë, Oksford, Monpelje, Paris, Padova, Lion). Në këto universitete krabas lëndëve të tjera, mësobje edhe shkenca dhe filozofia islame.

1. Ç'është filozofia islame

Një tjetër traditë filozofike e rëndësishme dhe origjinale e filozofisë mesjetare është filozofia islame. Filozofia islame ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në historinë e kulturës, jo vetëm në ruajtjen e njohurive, por në pasurimin e kontributeve të reja, pasi filozofia perëndimore hyri në një “epokë të errët”. Nga kjo përqaasje kuptojmë se filozofia islame është një traditë e filozofisë që u krijua midis filozofisë së lashtë dhe filozofisë skolastike të shekullit të dymbëdhjetë. Filozofia islame mund të përshkruhet si një traditë e filozofisë e lindur nga kultura islame në tërësi, meqë filozofia islame nuk shprehet vetëm në gjuhën arabe dhe në formimin e saj kanë kontribuar edhe të tjerë përveç myslimanëve.

Filozofia si term është një shkencë e madhe; sot ajo përbëhet nga katër degë: psikologjia, logjika, morali dhe metafizika. Filozofia, kur kaloi te myslimanët, përbëhej nga logjika, fizika, metafizika (*ilabijjat*) dhe morali. Fillimisht, filozofia i përmblihte të gjitha shkencat. Ajo

ishite shkenca që studionte objektet. Me kalimin e kohës, shkencat e tjera filluan të ndahen nga filozofia dhe të bëhen shkenca më vete. Fillimisht u nda matematika, më pas mjekësia. Kur filozofia kaloi te myslimanët përbëhej nga katër shkencat e përmendura më sipër. Metafizika, në terminologjinë e filozofisë islame, quhet “ilahijat”. Ajo nuk merret me studimin e pjesës së jashtme dhe të dukshme të objekteve, me të cilat merren shkencat pozitive, por studion thelbin e objekteve, qëllimin, fillimin dhe fundin e tyre, pyetje të cilave nuk ju përgjigjen dot shkencat pozitive.

Edhe filozofia islame studion thelbin dhe qëllimin e objekteve, fillimin dhe fundin e tyre, por kalon nga shpallja dhe profetësia. Pra, fillimi është Zoti (Allahu) dhe fundi është Dita e Fundit. Pra, dy qëllimet kryesore të filozofisë islame janë dijet rreth Zotit dhe Ditës së Fundit. Profetësia nuk është një qëllim i kësaj filozofie, por një mjet për të arritur te dy qëllimet e mësipërme.

Filozofia islame, ashtu si metafizika, nuk bie ndesh me dijet ndijore, teknike dhe ligjet e natyrës. Ajo është më e veçantë se metafizika,

ndërsa metafizika është më e gjerë se ajo, sepse metafizika thelbin e objekteve dhe fillimin e parë (mebde-i eu-uel) nuk e mbështet te Zoti, te qëllimi i objekteve dhe te Dita e Fundit. Pikërisht kjo është pika ku edhe filozofët myslimanë kanë rënë në kundërshti me njëri-tjetrin. Në fakt asnjëri prej tyre nuk e mohon Zotin ose Ditën e Fundit, thjesht kanë rënë në kundërshti me njëri-tjetrin prej interpretimit dhe konceptimit të atyre më lart.¹

2. Takimi i filozofisë helenistike me botën islame

Pas ardhjes së Islamit, me luftërat dhe zgjerimin e territorit të myslimanëve, nisi takimi i fesë dhe kulturës islame me fe, kultura dhe rryma të reja. Ndër të parat ishte takimi me shkollën filozofike të Aleksandrisë në Egjipt, në kohën e kalifit të dytë Omer b. Hattab, i cili caktoi si guvernator në atë zonë Amr bin As. Në bibliotekën e pasur dhe madhështore të Aleksandrisë gjendeshin libra dhe shkrime të ndryshme, që nga papiruset e deri te veprat më të vona të filozofëve grekë dhe shkrimet rreth tyre të dijetarëve të krishterë. Zhvillimi i kërkimeve rreth filozofisë së Aristotelit në shek. V-VI në Aleksandri dhe përhapja e Islamit në ato zona, u bashkua me filozofinë Neo-Platoniste dhe u krijua një

1. Izmirli, Ismail Hakki, *Islam Felsefesi Tarihi*, Istanbul: Otuken Yayinlari, 2008:25-35.

qasje gjithëpërfshirëse e filozofisë.²

Për herë të parë, në kuptimin modern, myslimanët janë takuar me filozofinë greke përmes sunduesit emevit Halid bin Jezid. Kjo u bë shkak për fillimin e studimeve filozofike dhe njohjen e veprave në këtë fushë. Studimet filozofike që filluan në periudhën emevite vazhduan edhe më vonë. Në kohën e abasidëve, puna e përkthimit dhe e njohjes së filozofisë greke u përshpejtua. Shkolla Dâru'l-Hikme (Akademia e Filozofisë), e themeluar nga Kalifi Me'mun në vitin 832, kryente detyra dhe shërbime të rëndësishme në këtë fushë.³

Në fazën e parë, të krishterët që njihnin greqishten, sirianishten dhe arabishten luajtën një rol të rëndësishëm në kalimin e filozofisë në botën islame. Edhe përkthyesit hebraikë e mbështetën atë gjithashtu.⁴

Duhet përmendur se takimi dhe angazhimi i myslimanëve me filozofinë nuk ishte aspak aksidental dhe rastësor, siç pretendohet në Perëndim. Përkundrazi, gjithçka erdhi mjaft natyrshëm me përhapjen e Islamit dhe filozofia gjeti "tokën

2. Ulken, Hilmi Ziya, *EskiYunan'dan Cagdas Dusunceye Dogru Islam Felsefesi-Kaynaklari ve Etkileri*, 6. Baski, Istanbul: Ulken Yayinlari, 2004:20.

3. Bulac, Ali, *Islam Dusuncesinde Din-Felsefe, Vahiy-Akil Iliskisi*, Istanbul: Iz Yayincilik, 1995:99-100.

4. Fahri, Macit, *Islam Felsefesi Tarihi*, cev. Kasim Turhan, Istanbul: Iklm Yayinlari, 1987:13-14.

e përshtatshme” ku mund të zhvillohej, prej vetë natyrës së fesë Islame, e cila i jep rëndësi dijes dhe i lë vend përdorimit të arsyes. Gjithashtu Islami ka shërbyer si urë lidhëse e filozofisë së lashtë me atë perëndimore, sigurisht, duke mos u mjaftuar vetëm me përcjelljen, por edhe me zhvillimin e saj.

3. Filozofia natyrale

Filozofia natyrale është rryma e parë filozofike që ka lindur në botën islame, duke u frymëzuar nga filozofët grekë. Epoka e kelamistëve të quajtur *Mu'tezile*, të cilët u larguan nga qasjet themelore të Islamit, frymëzoheshin nga atomizmi dhe Empedoklesi. Pas tyre lindi një lëvizje e re e quajtur *filozofia natyrale*, e cila ndahet në tri rryma:

a. Natyralistët (Tabi'ijjun)

Natyralistët janë empiristët e parë në Islam, të cilët kanë përdorur metodën empirike dhe induktive. Ata e mbështesin dijen vetëm mbi aftësitë ndijore (shqisat). Por përveç botës materiale ata e pranonin edhe Perëndinë e shpirtin. Themeluesi i kësaj rryme është filozofi dhe mjeku Razi, në përcaktim njihet si *Alrazes*. Ai i pëlqente filozofët grekë nga Thales te Pitagora dhe filozofinë e tij e mbështeste mbi shkencat natyrore. Sipas tij sistemi (universi, krijesat) mbështetet mbi pesë principe të paraqena:

1. Zoti
2. Zbrazëtia (vendi absolut)

3. Koha (koha absolute)

4. Shpirti (drita)

5. Materia (errësira)

Këtu vëmë re se Raziu dritën dhe errësirën e Zoroastrianizmit e zëvendëson me shpirtin dhe lëndën e marrë nga filozofia greke.⁵

b. Materialistët (Dehrijjun)

Ashtu si natyralistët, edhe materialistët besojnë se dija mbështetet vetëm mbi shqisat. Duke qenë se s'ka një burim tjetër të dijes përveç shqisave, atëherë nuk ka diçka tjetër të vërtetë përveç materies. Materialistët e konsiderojnë kohën (dehr) si të paraqenë dhe jo të krijuar, ndërsa Zotin nuk e pranojnë. Në botën islame nuk kanë pasur një rëndësi të madhe dhe nuk kanë arritur as të krijojnë një shkollë të tyre.

Filozofi materialist më i njohur është Ibn Rauendi. Është kritikuar rëndë prej shumë kelamistëve, si: El-Kindi, Farabi, Esh'ari, etj. Sipas Rauendit, Perëndia nuk ka ndonjë funksion tjetër përveçse të vdesë njerëzit. Shumë profetë pretendojnë se sjellin lajme nga bota e fshehtë (gajb), por nuk e vërtetojnë dot këtë. Përveç kësaj, ata e përshkruajnë Parajsën me kënaqësi ndjesore ordinere.⁶

c. Ezoteristët (Batiniijun)

Ezoteristët janë një ndarje e Shiitëve. Njihet edhe me emrat Ismailije, Imamije, Ta'limije. Sipas

5. Ulken, 26-27.

6. Po aty, 29-30.

tyre, në mësimet e Islamit ka një kuptim të dukshëm dhe një të fshehur. Shkolla ezoterike ka lindur si një bashkim i skepticizmit, tesavufit dhe Mu'teziles. Ezoteristët janë *kabalistët* e Islamit, të cilët nuk mjaftohen me kuptimin e jashtëm të Kur'anit (kabalistët hebre të Teuratit dhe Zeburit), por me anë të shkronjave të Librit të Shenjtë përpiqen të nxjerrin kuptime të fshehta dhe kështu i japin atij kuptimet që duan. Pikëpamjet e tyre filozofike kryesore janë:

1. Universi është i pafillim (kadijm).
2. Profetët dhe mrekullitë i pranojnë pjesërisht.
3. Të gjithë njerëzit duhet t'u përgjigjen ftesës së imamëve dhe besojnë se ata janë të pafajshëm dhe të pastër nga çdo mëkat.
4. Në lidhje me botën e përtejme, ata besojnë se shpirtat e këqij e vuajnë dënimin duke kaluar nga një trup në trupin tjetër (reinkarnacion), ndërsa shpirtat e mirë ngrihen lart në qiell dhe bashkohen me qenien hyjnore.
5. Pamja e jashtme është lëvözgha e së vërtetës, ndërsa brendësia thelbi. Prandaj, ata për të shpjeguar brendësinë e gjërave, përdorin te'uilin dhe jo tefsirin.⁷

4. Shkolla Peripatetike (Mesh-shai)

Peripatetizmi është një sistem i filozofisë islame në të cilin tendenca

7. Po aty, 31-33.

e filozofisë racionaliste që filloi pas ndikimit të filozofisë së natyrës u bë sistematike. Mesh-shaj-je është termi arab për peripatetizmin dhe njihet si rryma filozofike që mbizotëron filozofia aristoteliane në filozofinë islame.⁸

Përkthimi i Aristotelit në arabisht luajti një rol në krijimin e peripatetizmit dhe në formimin e tendencës racionaliste të quajtur filozofia e kelamit në mendimin islam pas periudhave të atomizmit dhe skepticizmit. Ndërsa për filozofitë para-sokratike diskutohej mospërputhja me principet themelore të fesë, filozofia aristoteliane peripatetike kishte përputhje me këto principe. Megjithatë, nuk mund të themi se filozofia peripatetike mbështetej plotësisht në mësimet e Aristotelit, por ajo përfshin edhe mësimet e Platonit të komentuar nga Plotinusi. Pra, mund të themi se shkolla mesh-shai në Islam është një ndërthurje e ideve të Aristotelit dhe Neo-Platonizmit.⁹

Ndër përfaqësuesit më të njohur të kësaj shkolle janë:

a. El-Kindi

Emri i tij është Jakub bin Is'hak el-Kindi. Njihet edhe me emra Ebu'l-Hukema (Babai i Doktorëve) dhe Fejlesufu'l-Arab (Filozofi arab). Ai ishte inxhinier, fizikant dhe doktor. Ka luajtur një rol të rëndësishëm në njohjen e filozofisë greke nga

8. Po aty, 46-47.

9. Bulac, 115-118.

muslimanët, madje e ka komentuar mjaft mirë Aristotelin. I njihje mirë filozofinë greke, iraniane dhe indiane dhe ka shkruar e përkthyer rreth 270 vepra. Filozofinë e tij mund ta përmbledhim me këtë fjalë të tij: “Vërtetësia e dijeve fetare mund të dihet me kriteret e arsyes.”¹⁰

b. Farabi

Ebu Nasr Muhamed bin Muhamed el-Farabi ose i njohur në perëndim si Alfarabius. Mes dijetarëve islamë të mesjetës konsiderohet si *Mësuesi i Dytë (Mualimu'tb-thani/Magister Secundus)* pas Aristotelit, i cili është Mësuesi i Parë. Nëse Kindi ishte një Aristotelian me plot kuptimin, Farabi u përpoq të bashkonte filozofinë idealiste të Platonit dhe atë racionale të Aristotelit. Kjo bëri që filozofia e tij të merrte një formë mistike.¹¹

Farabi, duke u ndikuar nga veprat e Platonit dhe Aristotelit, e quan botën si një qenie induktive, të gjallë dhe organike. Sipas kësaj, qeniet janë krijuar nga “frymëzimi” i Njëshit, pra Zotit, shkallë-shkallë. Farabi zotëron një qasje më deterministe si teoria e zgjatimit (sudur/extension), e cila nuk i njuh vullnet të lirë Perëndisë. Siç Aristoteli Krijuesin e quan “*Vënësi i Parë në lëvizje*” (Muharriku'l-Eu-uel) edhe Farabi Perëndinë e quan si Lëvizësin e Parë të çdo gjëje,

si një Mjeshtër, i cili kurdis gjithçka në univers dhe ai (universi) vazhdon veprimtarinë e tij.

Gjithashtu në lidhje me marrëdhënien shpirt-trup dhe përbërjen e tyre, Farabi thotë se nuk janë nga e njëjta substancë dhe se pas vdekjes trupi shkatërrohet, ndërsa shpirti vazhdon rrugëtimin e tij. Edhe pse jo shumë hapur, në veprat e tij, ai lë të kuptohet se meqenëse trupi shkatërrohet që në këtë botë, në botën tjetër ringjallja do të bëhet vetëm me shpirt.¹²

Farabi shpjegon edhe profetësinë dhe kushtet e saj:

1. Një profet duhet të njohë botën e fshehtë (gajbin) atë të shpirtit, duke qenë se pasqyra e tij shpirtërore nuk ndryshket, pa u edukuar ose arsimuar nga dikush.

2. Të shohë disa rreze drite (engjëjt) dhe të dëgjojë prej tyre fjalën e Zotit.

3. Të tregojë mrekulli të mbinatyrshme.

Sipas tij, ashtu siç shpirti përdor trupin, edhe shpirti i profetit përdor universin. Sipas kësaj profetësia bëhet një veçori e shpirtit. Ajo arrihet me përsosjen e logjikës, imagjinatës dhe vullnetit, prej kësaj profetësia shihet si një post, i cili mund të fitohet. Sipas Farabit, profetët dinë urtësinë praktike dhe morale, ndërsa filozofët dinë urtësinë praktike dhe teorike. Prandaj të dytët janë më lart se të parët. Ai thotë se urdhrat

12. Bulac, 122-126.

10. Uludag, Suleyman, *Islam Dusuncesinin Yapısı*, 6. Baski, Istanbul: Dergah Yayinlari, 2010:202.

11. Po aty, 203.

dhe ndalesat në Kur'an, Parajsa dhe Ferri kanë kuptime simbolike. Këto qasje të tij dhe shumë të tjera, si *dhjetë arsye*, etj., janë bërë shkak për kritika dhe sulme të shumta ndaj tij. Për sa i përket filozofisë së fesë, ai mendon se feja dhe filozofia, arsyeja dhe shpallja hyjnore nuk janë në konflikt me njëra-tjetrën, por përputhen mes tyre.¹³

c. Ibn Sina

Ndër filozofët më të mëdhenj të botës Islame, i cili ka ndikuar gjerësisht filozofët dhe mendimtarët myslimanë dhe perëndimorë, është padyshim Ebu Ali el-Husejn ibn Abdilah ibn El-Hasan ibn Ali ibn Sina. Në perëndim njihet me emrin *Avicenna* dhe është quajtur nga dijetarët islamë Reisu'l-Felasife (Prijësi i filozofëve) dhe Shejhu'l-Felasife (Profesori i filozofëve). Ibn Sina është filozofi më i afërt me Islamit prej filozofëve. Vepra e tij "*El-Hikmetu'l-Meshrikijje*" tregon kalimin e tij nga filozofia peripatetike (meshaijje) në atë iluministe (ishrakijje). Ka shkruar disa vepra në lidhje me filozofinë e fesë.¹⁴

Shkolla filozofike e Aleksandrisë ka ndikuar shumë në krijimin e ideve të tij. Nëse Farabi, i ndikuar nga filozofia helenistike, mban një qëndrim më determinist, Ibn Sina mban një qëndrim më të butë në lidhje me teorinë e frymëzimit (burimit/fejz), duke arritur në një

qasje më të rafinuar të universit dhe fizikës. Sipas kësaj qasje, nga Njëshi del vetëm një. Prandaj qenia është një. Ashtu siç nuk mund të mendohet se nga Njëshi të dalë shumësia, Ekzistenca e Zotit, Njëshit të Parë, që është Uaxhibu'l-Uxhud është një princip i domosdoshëm. Nga ky del një Arsye dhe një Vete (Nefs). Nga kjo kuptojmë se Zoti është Shkaku i Parë dhe Qenia e Detyrueshme (Uaxhibu'l-Uxhud), por nuk është zgjedhës i veprimit (failu muhtar). Këtë teori Ibn Sina e mbështet duke përdorur koncepte rreth krijimit në Kur'an, si: *ibda*, *halk*, *ihdas*, *tekuin*, etj. Sipas kësaj teorie, kjo qenie e domosdoshme prej së cilës buron gjithçka, pasqyron dritën e ekzistencës të cilën e ndajnë tri substanca (xheuher): Arsyeja (Akl), Vetja (Nefs), Trupi (Xhism).¹⁵

Në lidhje me profetësinë, Ibn Sina i beson mrekullitë e profetëve (mu'xhize), por këto përpiqet t'i shpjegojë nga ana psikologjike dhe filozofike. Sipas tij, profetët, të vërtetat hyjnore i kanë shpjeguar në mënyrë figurative dhe simbolike. Librat e shenjtë duhen interpretuar (tefsir) dhe komentuar (te'uil) duke u mbështetur në filozofi.

Ibn Sina, në romanin e tij të famshëm filozofik "*Hajj bin Jekdhan*" (I Gjalli i Biri i të Zgjuarit) i ka shprehur qasjet e tij fetare me anë të simbolikës.¹⁶

13. Uludag, 204.

14. Po aty, 204.

15. Bulac, 131.

16. Uludag, 204.

d. Kriticizmi i Gazzaliut

Ebu Hamid Muhamed el-Gazzali është ndër dijetarët më të mëdhenj të Islamit,¹⁷ i cili mbahet si pika ndarëse, në filozofinë e kelamit, e dy brezave: brezit të parë (mutedkaddimun) dhe brezit të fundit (mutedhirun). Ai është quajtur *Huxh-xbetu'l-Islam* (Argumenti i Islamit) për nga saktësia e tij në mënyrën se si i trajton çështjet e Islamit.¹⁸ Ka ndikuar shumë dijetarë të tjerë myslimanë dhe perëndimorë.

Gazzali, në jetën dhe veprën e tij, i ka dhënë një vend të rëndësishëm kritikës së filozofëve (veçanërisht Ibn Sina dhe Farabiut, por jo vetëm), të cilët sipas tij kanë devijuar nga parimet themelore të Islamit.¹⁹ Ndër veprat në të cilat ka kritikuar filozofët janë: *Tehafut el-Felasife* (Mashtrimi i Filozofëve), *El-Munkidhu min ed-Dalal* (Shpëtimi nga Devijimi), *Mekasidu'l-Felasife* (Qëllimet e Filozofëve). Deri para tij, kritikën ndaj filozofëve e kishin bërë kelamistët, të cilët nuk kishin dije nga filozofia dhe donin ta hiqnin fare atë. Gjithë çfarë ata bënë është thjesht një përbaltje e pabazë dhe e paargumentuar.²⁰

Imam Gazzali, para se të kritikonte filozofët, studioi për dy vite filozofinë dhe pas kësaj shkroi

veprën “*Makasid el-Felasife*”²¹. Më pas paraqiti kritikën e tij të argumentuar dhe të ashpra në dy veprat e tjera, “*Tehafut*” dhe “*Munkidh*”.

Shkurtimisht këto janë kritikën që ai i drejton filozofëve²²:

1. Pretendimi i filozofëve se “*universi është i parakrijuar dhe paraqenë*” është i kalbur, i pabazë dhe çon në mohim. Universi nuk është i parakrijuar, por është krijesë dhe i paskrijuar.

2. Thënia e tyre “*Zoti është Formësuesi i universit, gjithësia është vepër e krijimit të tij*” është një mashtrim i përdorur për të fshehur mendimet dhe besimin e tyre të vërtetë.

3. Filozofët janë të paaftë për të provuar formësuesin dhe krijuesin e universit.

4. Filozofët janë të paaftë të vërtetojnë se ekzistojnë dy perëndi.

5. Është i pabazë mospranimi itributeve të Zotit.

6. Thënia se “*Qenia e Parë (Zoti) është e pandarë nga xhins (lloji) dhe fasl (veçori)*”²³ është e pabazë.

21. Bulac, 157.

22. Gazzali, Imam, “*Filozoflarin Tutarsizligi*”, cev. Bekir Sadak, Istanbul:Ahsen Yayinlari, 2002:19-20.

23. Çdo realitet, qenie dhe kuptim i plotë/i përgjithshëm (kul-lij) ndahet në dhatij (vetvetor) dhe aradij (atribuor). Të plotat vetvetore ndahen në xhins (lloji), neu’ (specie) dhe fasl (veçori). Kur pyesim për një qenie se çfarë është dhe na përgjigjen me “*gjallesë*” na kanë treguar llojin (xhism); kur na përgjigjen me “*njeri*”, na kanë treguar specien (neu); ndërsa *fasl* na tregon veçorinë e një qenieje, e cila ka të njëjtin lloj (xhins) me qeniet e

17. Ulken, 111.

18. Bulac, 163.

19. Fahri, 175.

20. Uludag, 222.

7. Thënia se “*Ekzistenca e parë është një qenie e thjeshtë, pa përmbajtje*” është e pabazë.

8. Filozofët janë të paaftë të shpjegojnë qasjen e tyre se “*Qenia e Parë nuk është trup (xhism)*”.

9. Puna e vetme e filozofëve është të shpjegojnë se duhet mohuar Formësuesi dhe pranuar materializmi.

10. Pretendimet e tyre se “*Qenia e Parë nuk njih dikë tjetër përveç vetes*” janë boshe.

11. Nuk janë të aftë të provojnë se “*Qenia e Parë njih veten e Tij (dhat)*”

12. Edhe pretendimi i tyre se “*Zoti nuk i di të pjesshmet (xhuz’i)*” është në kundërshtim me të vërtetën

13. Pretendimi i tyre se qielli është një krijesë e gjallë që lëviz me vullnetin e tij është i pabazë.

14. Pretendimi i tyre se *qëllim*²⁴ është lëvizësi i qiejve është gjithashtu i pavërtetë.

15. Nuk janë të vërteta pretendimet se shpirtat e qiejve i dinë gjithë të pjesshmet (xhuz’i) që ndodhin në gjithësi.

16. Pretendimi se përveç ligjeve të natyrës asgjë nuk mund të ndodhë (të shfaqet).

tjera, por kjo veçori (fasl), e dallon prej tyre. P.sh. njeriu si lloj (xhins) është *gjallesë*, ashtu si kafshët, por ajo që e dallon prej kafshëve është veçoria (fasl) e arsyes. Kjo ndarje ngjan me shkencën e klasifikimit të gjallesave në Biologji, Taksonominë, e cila bazohet mbi klasifikimin e bërë nga Aristoteli.

24. Kujto *qëllimi* dhe rregulli nga argumenti teleologjik.

17. Nuk janë të aftë të sjellin argumente për pretendimet e tyre se “*shpirti i njeriut nuk është as trup (xhism) dhe as atribut (araz), por është substancë (xheuber), e cila e vazhdon qenien vetë*”.

18. Pretendimet se shpirtat shkatërrohen është në kundërshtim me të vërtetën.

19. Kundërshtimi i tyre ndaj ringjalljes së njeriut me trup dhe se në Parajsë dhe Ferr do të ndjejnë kënaqësi ose dhimbje trupore nuk është i vërtetë dhe nuk ka baza.

Jo vetëm që ai iu ka drejtuar kritika filozofëve, por edhe të tjerë i kanë drejtuar kritika atij, ku më i njohuri është Ibn Rushd në veprën e tij “*Tebafutu’-Tebafuti’-Felasife*” (Mashtrimi i “Mashtrimi i Filozofëve”).

5. Filozofia “Ishraki”

Ndër filozofët më të njohur në perëndim janë Ibn Sina (Avicenna), Farabi (Alpharabius), Ibn Rushd (Averroes), i cili konsiderohet edhe si i fundit i filozofëve myslimanë. Me vdekjen e Ibn Rushdit, në perëndim u mendua se mori fund “rastësia” e filozofisë në Islam. Kjo për faktin se nuk i njihnin filozofët e tjerë dhe se nga veprat e filozofëve myslimanë njihnin ato të autorëve të përmendur më lart.

Pavarësisht këtyre, në Lindje, në Iran lindi një rrymë e re e quajtur *Ishraki*, që do të thotë *e Dritës* ose *Iluministe*, por të mos ngatërrohet me Iluminizmin që njihet gjerësisht.

Është sistemi i mendimit teozofik bazuar në përvojën mistike dhe intuitën, kundër filozofisë racionaliste peripatetike të bazuar në arsyetim. Ishrak në këtë filozofi ka kuptimin e shfaqjes së dijes drejtpërdrejt. Është një rrymë e cila, në vetvete, përfshin filozofinë aristoteliane dhe neo-planiste, atë lindore dhe sufizmin²⁵. Këtu vëmë re përdorimin e *dritës*, e cila përdoret edhe në fenë Zoroastriane, si dyzim i perëndisë, drita dhe errësira, e mira dhe e keqja.²⁶ Duke qenë se kjo rrymë filozofike mori më shumë mbështetje nga sufistët, pati më shumë mundësi të zhvillohej mes tyre.²⁷

Si themelues dhe përfaqësues i kësaj rryme në Lindje konsiderohet Suhreuerdi, një filozof iranian, jo shumë i njohur në Perëndim, deri kur orientalisti Henri Corbin (Henry Corbin) e bëri të njohur mes dijetarëve perëndimorë.²⁸

Filozofët Ishraki mendojnë se siç dielli bën të mundur të shohësh gjëra dhe objekte, ashtu edhe ndriçimi shpirtëror ose intuita i jep shumë dije qenieve njerëzore me

anë të frymëzimit. Filozofia Ishraki është një filozofi e bazuar në zbulim e intuitë dhe jo në arsye e provim. Ata mendojnë se gjithçka vjen nga Allahu valë-valë ashtu siç vjen drita e diellit dhe, në të vërtetë, të gjitha qeniet janë të përbëra nga drita e Dritës. Të gjithë veprimet ndodhin për shkak të dritës. Ata pasqyrojnë dritën e Perëndisë. Intuita është e vetmja mënyrë për t'u ngritur në Dritën e dritave. Vetëm elita e njerëzve që pastruan zemrat dhe shpirtat e tyre mund ta arrijë këtë, sepse dëshirat e trupit e pengojnë atë nga arritja e të vërtetave hyjnore. Drita dhe errësira, të cilat janë armiq dhe të pavarur nga njëra-tjetra, janë të prira për njëra-tjetrën. Errësira (mizoria) ka një dashuri për dritën dhe e humbet errësirën e saj ndërsa drita (nur) afrohet. Shpirti dhe trupi janë të prirë ndaj njëri-tjetrit ndërsa shqisat janë instrumente shpirtërore. Trupi i përdor këto mjete për të perceptuar botën e jashtme. Shpirti jeton kur trupi vdes, ndërsa trupi është i destinuar të zhduket. Trupi është errësira, shpirti është drita.

Si përfaqësues i filozofisë Ishraki në Perëndim konsiderohet filozofi andaluzian Ibn Tufejl edhe pse pikëpamjet e tij nuk përputhen me pikëpamjet e filozofisë Ishraki lindore. Ai ishte frymëzuar nga Ibn Sina, Gazzali dhe filozofi i madh andaluzian Ibn Baxh-xhe. Ndryshe nga filozofia Ishraki lindore, ai përdor arsyen në vend

25. Në arabisht *ishrak* do të thotë edhe lindje dielli dhe nga e njëjta rrënjë vjen edhe fjala *sherk*, që do të thotë Lindje.

26. Corbin, Henry, *Historia e Filozofisë Islame I-II*, Shkup: Logos-A, 1997:221.

27. Uludag, 212.

28. *The Cambridge Companion to Arabic Philosophy*, Walbridge, John, "Subrawardi an Illuminationism", Cambridge University Press, 2005:204.

të intuitës dhe ndriçimit shpirtëror. Ndërsa Suhreuerdi përpqej që me anë të Islamit të përmblihte dhe komentonte disa koncepte filozofike të kulturës dhe feve iraniane, Ibn Tufejl përpqej të zinte një vend të tijin në komentimin e marrëdhënies fe-filozofi.²⁹

6. Filozofia e Ibn Rushdit

Ibn Rushd është padyshim njëri nga filozofët dhe mendimtarët myslimanë më të njohur e më të përfolur. Në Perëndim njihet si Averroes. I rritur në Kordoba, ai pati kontakt me dijen që në vegjëli. Ka studiuar fikh, filozofi, mjekësi, matematikë dhe astronomi, por pasioni i tij më i madh ishte të lexonte libra.³⁰

Ka shkruar vepra të shumta e voluminoze, të përkthyer më vonë në latinisht, të cilat kanë kontribuar në shumë çështje e diskutime, si fetare edhe filozofike dhe kanë ndikuar shumë mendimin filozofik hebraik të mesjetës.³¹ Ndër to mund të përmendim veprën “*Tebafutu'l-Tebafuti'l-Felasifë*”, në të cilën kritikon Gazzaliun për pikëpamjet dhe quajtjen mohues të filozofëve. Ai i ka shfletuar me imtësi veprat e Gazzaliut, madje pretendon se ai bie ndesh me fjalët e pretendimet e tij.³² Ibn Rushd, në kritikën ndaj

Gazzaliut, thotë se feja dhe filozofia janë dy motra të cilat mëkohen nga i njëjti realitet.³³

Kontributi më i madh i Ibn Rushdit konsiderohet rishkrimi dhe përmbledhja e veprave të Aristotelit dhe pastrimi i tyre nga shtesat që ishin bërë gjatë historisë, duke i shoqëruar edhe me komente nga ana e tij.³⁴

Idetë e Ibn Rushdit në kontekstin e mentalitetit dhe metodologjisë së shkencës mund të përmblihen si vijon:

a. Qëllimi i çdo lloj aktiviteti mendor duhet të jetë dëshira për të arritur të vërtetën. Në mënyrë që një person të jetë një dijetar, në kuptimin e vërtetë, nuk mjafton të marrë të vërtetën, por në të njëjtën kohë duhet ta ndajë atë me të tjerët dhe t'i ndriçojë ata.

b. Asnjë pengesë, që mund të hasë në këtë rrugë, nuk duhet ta pengojë në ndjekjen e së vërtetës; ai duhet të përmbushë detyrën e tij / saj me një ndjenjë përgjegjësie shkencore.

c. Akumulimi i metodave, njohurive dhe përvojës që njerëzimi ka sjellë deri më sot në fushën e filozofisë dhe shkencës, në emër të kërkimit të së vërtetës, nuk duhet të injorohet asnjëherë.

d. Në kërkimin e së vërtetës, nuk ka rëndësi besimi, feja apo sekt i atij prej metodës, qasjes dhe mendimit të të cilit mund të përfitojmë.

29. Bulac, 202.

30. Po aty, 226.

31. *Companion*, 182.

32. Corbin, 255-256.

33. Bulac, 160.

34. Corbin, 255.

Ai mendon se *e vërteta* ka tre dimensione: qenien (ontologjik), dijen (epistemologjik) dhe moralin (etik).³⁵

Pikëpamjet metafizike dhe natyrore të Ibn Rushdit mund t'i përmbledhim në këto gjashtë pika:

1. Bota është e paraqenë.
2. Mohimi i mos-ekzistencës.
3. Njëshmëria e mendjeve njerëzore.

4. Shkatërrimi i shpirtit individual bashkë me trupin.

5. Veprimet njerëzore janë jashtë Providencës Hyjnore.

6. Providenca Hyjnore është e paaftë ta bëjë njeriun të përjetshëm.

Prej këtyre pikëpamjeve, Ibn Rushd është kritikuar si nga mendimtarët myslimanë, por edhe nga të krishterët. Madje në shek. XIII veprat e tij u ndaluan, përveç atyre mjekësore.³⁶

7. Sufizmi

Sufizmi ka një vend të rëndësishëm në historinë e mendimit islam. Nuk ka asnjë rrymë a lëvizje që ta ketë ndikuar mendimin islam aq shumë sa sufizmi. Një pjesë e mirë e vlerave shpirtërore të shoqërisë myslimane është përfituar në sajë të kësaj rryme. Ajo ka kontribuar shumë në kulturën islame, veçanërisht në letërsi, prozë, poezi, muzikë, arsimim, moral, edukim, duke i mbledhur bashkë

njerëzit e racave, gjuhëve e vendeve të ndryshme.³⁷

Sufizmi, si dëshmitar i religjionit mistik në islam, është fenomen shpirtëror i rëndësishëm së jashtëzakonshme. Ai, në realitet, është fryt i porosisë shpirtërore të Profetit, përpjekje që me angazhimin personal të ringjallen modalitetet e saj, me anë të kundërimit të brendshëm të përmbajtjes së shpalljes kur'anore. *Miraxhi*, “ngritja ekstatike”, gjatë të cilit Profeti (a.s.) është udhëzuar në fshehtësitë hyjnore, mbetet prototip i përvojës, të cilën të gjithë sufistët me radhë kanë tentuar ta arrijnë.

Sufizmi është kundërshti e evidente, dëshmie pafalshme e Islamit shpirtëror kundër çdo përpjekjeje që Islami të reduktohet në religjion legjislativ dhe literalist. Ka arritur që deri në hollësi ta zhvillojë teknikën e asketizmit shpirtëror, shkallët e të cilit, përparimi dhe arritjet, nxisin një metafizikë të tërë të shënuar me emrin *irfan*. Polariteti mes *sheriatit* dhe *hakikatit* është qenësor pra, për jetën dhe mësimin e tij; ose më mirë të themi kjo është trini: *sheriat* (qëndrimi tekstual i shpalljes), *tarikati* (rruga mistike), *hakikat* (e vërteta shpirtërore si arritje vetjake).³⁸

Sufizmi ka mjaft përfaqësues të njohur, të cilët ndahen në dy grupe: sufistët me qasje panteiste dhe ata të cilët bënë sintezën dhe sistemimin e sufizmit. Nga grupi i parë mund

35. Ulken, 142-149.

36. Po aty, 152-153.

37. Uludag, 154.

38. Corbin, 201-202.

të përmendim Ibn Arabai, Bejazid Bistami, Hall-Ilaxh Mansur, Shibli, el-Mekki, Tusteri, etj. Nga grupi i dytë më të njohurit janë Ibn Arabi dhe Gazzali. Ky i fundit i ka bërë një sistemim sufizmit.³⁹

Filozofi dhe kelamisti i parë që e pa sufizmin si një rrugë morale dhe qasje filozofike është Imam Gazzali. Një pjesë e mirë e veprës së tij “*Ihja ulumi'd-Din*” (Ringjallja e Dijeve të Fesë) trajton tema mistike. Sipas tij, te Zoti mund të arrihet vetëm duke hequr dorë nga dëshirat. Punët e kësaj bote dhe intuita mistike duhet të ndahet. Është kjo e dyta që na çon në shpëtim. Me anë të asketizmit, dashurisë dhe inspektimit hyhet në rrugën drejt bashkimit me Zotin. Në këtë rrugë kalohen disa shkallë dhe ngrihen gradat shpirtërore. Me ngritjen e këtyre gradave edhe egoja (nefs) ngrihet drejt Zotit.⁴⁰

Në veprën e tij “*Ihja ulumi'd-Din*”, Gazzaliu përmend nëntë vepra të cilat të çojnë në shpëtim dhe të ngrenë në grada pranë Providencës Hyjnore:

1. Pendimi
2. Durimi
3. Falënderimi
4. Shpresa
5. Frika
6. Varfëria vullnetare
7. Asketizmi
8. Mbështetja te Zoti
9. Dashuria⁴¹.

39. Fahri, 191-202.

40. Ulken, 214-215.

41. Gazzali, Imam, *Ihya-u Ulumi'd-Din*

8. Kalimi i filozofisë Islame në Perëndim dhe ndikimet e saj

Ndikimi i filozofisë islame në filozofinë perëndimore të krishterë dhe hebraike është më i madh seç mendohet. Ky efekt zgjati nga shekulli X deri në fillimin e filozofisë së shekullit të fundit. Në bazë të ndërveprimeve kulturore, ashtu si filozofia islame është e ndikuar nga filozofia antike, është një fakt historik që filozofia perëndimore është ndikuar gjithashtu nga filozofia islame. Në filozofinë dhe mendimin Perëndimor vihet re ndikimi i saj. Fushën e këtij ndikimi mund ta rendisim si më poshtë:

a. Filloi lëvizjet humaniste në Perëndim.

b. Futi shkencat e hershme dhe metodën shkencore në Perëndim.

c. Ka ndihmuar skolastikën Perëndimore për të ofruar konsiderata filozofike dhe fetare.

d. Ka sjellë dinamizëm dhe vitalitet në misticizmin perëndimor.

e. Ka ndihmuar për të hedhur themelet e Rilindjes italiane.

f. Ka ndikuar në formimin e mendimit modern evropian.

g. Iu ka dhënë drejtim ideve të mëvonshme.⁴²

Përveç kontributeve e rëndësishme të filozofisë islame në

(*Mubtasar*), Haz. Dr. Mehmet Yavuz Seker, Istanbul: Isik Yayinlari, 2013: 271-326.

42. Ulken, Hilmi Ziya, *İslam Düşüncesinin Batıya Etkisi*, Cilt IV, çev. M. Alper Tuğsuz, Istanbul: İslam Düşüncesi Tarihi, 1991:143.

formimin e traditës filozofike në Perëndim, Perëndimi trashëgoi një pjesë të madhe të qytetërimit grek nga filozofët myslimanë. Ndikimi i filozofisë islame në Perëndim u bë kryesisht në sajë të përkthimit të veprave të filozofëve myslimanë në latinisht dhe hebraisht. Përkthyesit kryesorë kryesisht kanë qenë të krishterë ose hebrenj që jetonin në Spanjë ose Itali.

Këto përkthime janë vlerësuar si bibliografi në Perëndim që nga shekulli i X-të. Në sajë të përpjekjeve të shkencëtarëve perëndimorë, të frymëzuar dhe zhvilluar nga këto vepra, shkenca dhe teknologjia është zhvilluar me shpejtësi që nga fillimi i shekullit XVII dhe ka arritur pozicionin e saj aktual.⁴³

Si rezultat i punës së filozofëve myslimanë është shpëtuar nga zhdukja e puna shkencore të qytetërimeve të lashta dhe është siguruar një vazhdimësi midis mendimit grek dhe mendimit perëndimor. Në çështjet që filozofia e lashtë greke ishte e pamjaftueshme ose nuk sillte ndonjë zgjidhje, dijetarët myslimanë siç kanë nxjerrë zgjidhje të reja, me anë të sistemeve, koncepteve, teorive, zbulimeve dhe shpikjeve të reja kanë kontribuar

në pasurimin e shkencës dhe mendimit.⁴⁴

Vetë perëndimorët janë tërhequr dhe kanë pasur dëshirë të studiojnë mendimin dhe filozofinë islame për disa arsye:

- a. Sundimi mysliman në Spanjë.
- b. Kryqëzatat.
- c. Shkollat në Sicili.

d. Pamjaftueshmëria e skolastikës së vjetër Perëndimore dhe sistemeve të shkencës.

e. Popullsia e madhe dhe presionet e brendshme janë arsyet që e detyronin Perëndimin të kishte një marrëdhënie me botën islame.

Duhet theksuar se shkollat e asaj kohe në Perëndim nuk ishin në nivelin e atyre myslimane, prandaj mjaft shërbyes të fesë dhe njerëz të pasionuar pas dijes frekuentonin shkollat islame (medrese) në qytete të ndryshme të Italisë, si në Sicili dhe Napoli. Madje duke imituar sistemin e medreseve të asaj kohe u themeluan edhe universitetet e para në Evropë (në Bolonjë, Oksford, Monpelje, Paris, Padova, Lion). Në këto universitete krahas lëndëve të tjera, mësohej edhe shkenca dhe filozofia islame.⁴⁵

44. Ulken 72-73.

45. Po aty, 72.

43. Bulac, 305-316.

Qëndrimet e autoriteteve të hershme hanefite për imametin

Asim Ejub

Abstrakt

Ky artikull prezanton gjashtë përkthime me shënime të fragmenteve mbi qeverisjen/ autoritetin politik nga veprat e hershme klasike hanefite (para shekullit VII hijbri) në disa fusha, si jurisprudenca islame (fikh), teologjia rationale (kelam), ekzegjeza kur'anore (tefsir).

Pjesa më e madhe e reflektimit shkencor për imametin gjendet në veprat teologjike, pavarësisht se është çështje juridike. Për hanefitët, kjo nënkupton veprat e teologjisë maturidite. Tre pasazhet tona të ardhshme, nga shekulli i 5-të dhe i 6-të hijbri, janë të gjitha të këtij lloji. E para prej tyre vjen nga një prej trakteve më të hershme të besimit maturidi, et-Temhid i Ebu Shakur es-Salid (vd. pas 460/1066), megjithëse es-Salimi mund ta kundërshtojë atë përsërisht. Përveç atyre teksteve që i atribuohen drejtpërdrejt imam Ebu Hanifes, kjo mund të jetë një nga veprat teologjike më "hanefite" që ekzistojnë. Autori është pothuajse plotësisht i mbështetur, për të gjitha pozicionet e tij, te vetë themeluesi i shkollës hanefite, duke mos cituar asnjëherë nga Ebu Mansur el-Maturidiu. Shkolla esh'arite është referuar, por përmendet nën emërtimin e heterodoksisë (ehl el-bid'a), ndërsa Islami sunit kryesisht supozohet të jetë një përpjekje hanefite. Kontributi unik i autorit në diskutimin mbi imametin është të mobilizojë të tre burimet kryesore të ligjit islam, Kur'anin, Sunetin dhe konsensusin (ixhma'), për të vërtetuar detyrueshmërinë e tij, ndërsa autorë të tjerë maturidi në përgjithësi do të mjaftobeshin vetëm me konsensusin, ose me disa transmetime nga suneti.

Ky artikull prezanton fragmenteve mbi qeverisjen/ gjashtë përkthime autoritetin politik nga veprat e me shënime të hershme klasike hanefite (para

shekullit VII hixhri) në disa fusha, si jurisprudenca islame (*fiqh*), teologjia racionale (*kelam*), ekzegjeza kur'anore (*tefsir*).¹

Kjo pjesë do të pasohet – në dashtë Zoti – nga një tjetër [pjesë] kushtuar autoriteteve të mëvonshme në këtë shkollë. Së bashku, këta fragmente janë përfaqësuese të qëndrimit hanefi se imameti (ose khalifati) është një detyrim i përbashkët për Umetin, i cili është i nevojshëm, si me çdo autoritet politik, për të vendosur rendin shoqëror dhe politik, por gjithashtu, në dimensionin e tij unik islam, për të ruajtur *din*-in [fenë] dhe për të avancuar interesat e tij *dunjani*-je [të kësaj bote] dhe *ukhrevi*-je [të botës tjetër]. Këto pjesë artikulojnë arsyetimin e detyrimit dhe zgjerojnë rolet, përfitimet dhe rëndësinë e imametit. Aty ku autoritetet e mëparshme i shprehin këto pika në formën bazë, të njëjtat pika përsëriten në autoritetet e mëvonshme në një formë më sistematike dhe më të kodifikuara - për shembull, me përkufizime të qarta të imametit - duke dhënë në tërësi një qëndrim bindshëm dhe standard për këto çështje në shkollën hanefite.

1. Dua të falënderoj për ndihmën e tyre në vijim në aspekte dhe pjesë të ndryshme të këtij punimi: Shejh Dr. Sohail Hanif, Dr. Ramon Harvey, Maulana Uwais Namazi, Maulana Dr. Haroon Sidat, Shaykh Shams Tameez dhe Shaykh Salman Younas (Shënim i autorit).

Duke u nisur në mënyrë kronologjike, pjesa e parë është nga nxënësi ndoshta më i famshëm i vetë Ebu Hanifes (vd. 150/767), Ebu Jusufi (vd. 182/798). *Kitab el-Kharaxh*, një letër e shkruar nga Ebu Jusufi për kalifin abasid Harun err-Rreshijd (vd. 193/809), e cila ofron udhëzime moralo-ligjore mbi financat publike dhe tatimin e tokës. Kapitulli hyrës shërben si një nxitje për Kalifin, duke e inkurajuar atë drejt drejtësisë dhe duke i kujtuar atij detyrat e tij ndaj njerëzve. Pjesa tjetër e veprës kalon nëpër çështje të ndryshme të taksimit të tokës përmes teknikave ligjore islame, duke e vendosur përfundimisht përgjegjësinë e zgjedhjes së një opinioni në duart e Kalifit/Imamit.

Fragmenti i dytë është nga një autoritet tjetër shumë i hershëm, Ebu Bekr el-Xhessas (vd. 370/981), ku vepra e tij e quajtur *Abkam el-Kur'an*, mbi interpretimet juridike, është vepra e parë ekzegjetike që analizon sistematikisht ajetet e Kur'anit që kanë rëndësi ligjore sipas shkollës hanefite. Pozicioni i imametit në shkollë dhe pranimi tepër i madh i veprës së tij nga interpretuesit e mëvonshëm e bën atë një ekspozim të përsosur të teorisë politike hanefite nga vetë Kur'ani. Fragmenti i zgjedhur është pjesë e një diskutimi më të gjerë mbi domosdoshmërinë e drejtësisë dhe kufizimit moral nga autoriteti politik.

Pjesa më e madhe e reflektimit shkencor për imametin gjendet në veprat teologjike, pavarësisht se është çështje juridike. Për hanefitët, kjo nënkupton veprat e teologjisë maturidite. Tre pasazhet tona të ardhshme, nga shekulli i 5-të dhe i 6-të hixhri, janë të gjitha të këtij lloji. E para prej tyre vjen nga një prej trakteve më të hershme të besimit maturidi, *et-Tembid* i Ebu Shakur es-Salid (vd. pas 460/1066), megjithëse es-Salimi mund ta kundërshtojë atë përshtkrim. Përveç atyre teksteve që i atribuohen drejtpërdrejt imam Ebu Hanifes, kjo mund të jetë një nga veprat teologjike më “hanefite” që ekzistojnë. Autori është pothuajse plotësisht i mbështetur, për të gjitha pozicionet e tij, te vetë themeluesi i shkollës hanefite, duke mos cituar asnjëherë nga Ebu Mansur el-Maturidiu. Shkolla esh’arite është referuar, por përmendet nën emërtimin e heterodoksisë (*ehl el-bid’a*), ndërsa Islami sunit kryesisht supozohet të jetë një përpjekje hanefite. Kontributi unik i autorit në diskutimin mbi imametin është të mobilizojë të tre burimet kryesore të ligjit islam, Kur’anin, Sunetin dhe konsensusin (*ixhma*), për të vërtetuar detyrueshmërinë e tij, ndërsa autorë të tjerë maturidi në përgjithësi do të mjaftoheshin vetëm me konsensusin, ose me disa transmetime nga suneti.

Vepra *Usul ed-Din* e Ebu el-Jusr el-Bezdeuiut (vd. 493/1100) na jep pasazhin tonë të katërt dhe ekstraktin e dytë maturidi. Autori pranon, në hyrjen e tij në këtë vepër unike të teologjisë maturidite, për shkak të fokusit të saj

të fortë në hereziologji, se ka tashmë shkrime të përhapura të dijetarëve të Samerkandit në kohën e tij, por mendon se ato janë të pamjaftueshme. Kjo thënie bie në sy, duke pasur parasysh si es-Salimi dhe Ebu el-Mu’in en-Nesefi jetojnë në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtën zonë gjeografike. Pikëpamja e tij unike për imametin është t’i përgjigjet një grindjeje të veçantë kundër të qenët detyrim për shkak të mjaftueshmërisë së Kur’anit - një kundërshtim që bie në sy për shkak të mungesës së tij nga veprat e tjera.

Ekstrakti ynë i pestë është nga Ebu el-Mu’in en-Nesefi (vd. 508/1115), i referuar nga një studiues bashkëkohor si “Gazzali i shkollës maturidite”.² Punimet e tij janë më të plota dhe më rigorozë në paraqitjen e opinionëve të shkollës, dhe sipas testamentit të biografëve hanefi, ai është i dyti vetëm pas Imametit themelues për sa i përket pozicionit të tij në shkollë. Ekstrakti i zgjedhur është nga vepra e tij më e rëndësishme, *Tebssirat el-Edil-le*, e cila do të shërbente si pikënisje për një sërë përmbledhjesh dhe shpjegimesh nga studiuesit verifikues të shkollës pas tij. Substanca e ekstraktit, madje pjesa më e madhe e formulimit të tij, shfaqet herë pas here në veprat e mëvonshme maturidite. Veçanërisht, vepra e el-Bezdeuiut dhe Ebu el-Mu’in mbështetet shumë nga nxënësi i tyre i zakonshëm, Ebu Hafs ‘Umer en-Nesefi (vd.

2. ‘Awwad Salim, *El-Medresse el-Kelamijje el-Maturidijje* (Kajro: Dar el-Imam al-Razi, 2022), 43.

537/1147), në kredon e tij e famshme neseñije (*el-'Akaid en-Neseñi*).

Pasazhi i gjashtë dhe i fundit vjen nga një vepër ligjore e shekullit të gjashtë. Vepra e njohur *Beda'i' es-Sana'i'* nga 'Ala ed-Din el-Kasani (vd. 587/1191) ku diskuton domosdoshmërinë e imamet në kontekstin e artikulimit të detyrimit të një sistemi gjyqësor dhe ligjor funksional në një politikë islame. Vepra *Beda'i'*, e shkruar brenda asaj që disa e kanë cilësuar si një "kthesë teologjike" në shkollën hanefite, është një koment mbi *Tuhfet el-Fukaha'* e mësuesit të Kasaniut, 'Ala ed-Din es-Samarkandi (vd. 450/1058-59). Sistemi dhe struktura thelbësore e veprës sillen rreth vetë nocionit hanefi të sistemimit dhe racionalizimit të fikhut si një tërësi koherente, me ekstraktin në këtë pjesë që shërben si një shembull i mirë për këtë.

1. Imam Ebu Jusuf³
(vd.182/798), *Kitab el-Kharaxh*

3. Ebu Jusuf është pseudonimi (*kunja*) i Jakub ibn Ibrahim el-Ensari, nxënësi më i shquar i imamet themelues të shkollës hanefite, megjithëse jo pasardhësi i tij i menjëhershëm. Ai kaloi shumë vite nën kujdesin e imam Ebu Hanifes, që nga moshë e re e deri në moshën madhore, duke marrë përfundimisht përgjegjësinë e mësimit të shumë prej studentëve të imamet pas vdekjes së tij. Në mbretërimin e Harun err-Rreshidit, kalifit të pestë abasid, ai u emërua në detyrën e Kryegjykatësit, një post që e mbajti deri në vdekjen e tij. Veprat e tij më të famshme të deritanishme përfshijnë *Kitab el-Kharaxh* dhe *Iktilaf ibn Ebi Lajla ue Ebi Hanifa*.

يَا أَمِيرَ الْمُؤْمِنِينَ، إِنْ لَمْ يَكُنْ مِنَ الْإِسْلَامِ - وَلَهُ الْحَمْدُ -
قَدْ قَلَّدَكَ أَمْرًا عَظِيمًا: ثَوَابُهُ أَكْبَرُ الثَّوَابِ،
وَعِقَابُهُ أَشَدُّ الْعِقَابِ؛ قَلَّدَكَ أَمْرَ هَذِهِ
الْأُمَّةِ، فَأَصْبَحْتَ وَأَمْسَيْتَ وَأَنْتَ تَبْنِي
لِخَلْقٍ كَثِيرٍ، قَدْ اسْتَرْعَلَهُمُ اللَّهُ وَأَثَمَنَكَ
عَلَيْهِمْ وَابْتَلَاكَ بِهِمْ وَوَلَاكَ أَمْرَهُمْ، وَلَيْسَ
يَلْبِثُ الْبَيْتَ الْبَيْتَانِ إِذَا اسْتَسَّ عَلَى غَيْرِ التَّقْوَى أَنْ
يَأْتِيَهُ اللَّهُ مِنَ الْقَوَاعِدِ فَيَهْدِمَهُ عَلَيَّ مَنْ بَنَاهُ
وَإِعَانَ عَلَيْهِمْ؛ فَلَا تَضِيْعَنَّ مَا قَلَّدَكَ اللَّهُ مِنْ
أَمْرِ هَذِهِ الْأُمَّةِ وَالرَّعِيَّةِ، فَإِنَّ الْقُوَّةَ فِي الْعَمَلِ
بِإِذْنِ اللَّهِ.

“O Prijësi i besimtarëve (Emir el-mu'minin), vërtetë Allahu – falënderimi i takon Atij – ju ka dhuruar një përgjegjësi të madhe; shpërblimi i tij është më madhështor dhe dënimi i tij më i rëndë. Ai ju dhuroi përgjegjësinë për të udhëhequr këtë Umet, kështu që tani mëngjeset dhe mbrëmjet tuaja janë duke punuar për një pjesë të madhe të krijimit të Allahut. Allahu të ka vënë ty përgjegjës për punët e tyre dhe të ka dhënë besim mbi to. Ai ju ka testuar përmes tyre dhe ju ka bërë përgjegjës për mirëqenien e tyre. Një ndërtesë nuk do të qëndrojë në këmbë nëse është e ndërtuar mbi diçka tjetër përveç devotshmërisë (takwa). Nuk do të kalojë shumë kohë para se Allahu t'i heqë themelet e saj [të brishta], ta shembë mbi ata që e ndërtuan dhe e mbështetën. Mos e humbisni këtë përgjegjësi për t'u kujdesur për këtë Umet dhe njerëzit që ju janë besuar. Vërtet, forca është në përpjekjen [për të përmbushur përgjegjësinë tënde] me lejen e Allahut.”⁴

4. Ebu Jusuf, *Kitab el-Kharaxh*, ed. Taha

وَإِنَّ اللَّهَ بِمَنِّهِ وَرَحْمَتِهِ جَعَلَ وِلَاةَ الْأَمْرِ خُلَفَاءَ فِي أَرْضِهِ، وَجَعَلَ لَهُمْ نُورًا يُضِيءُ لِلرَّعِيَّةِ مَا أَظْلَمَ عَلَيْهِمْ مِنَ الْأُمُورِ فِيمَا بَيْنَهُمْ وَبَيْنَ مَا أَشْتَبَهُ مِنَ الْحُقُوقِ عَلَيْهِمْ، وَإِضَاءَةَ نُورٍ وَوِلَاةَ الْأَمْرِ أَقَامَةَ الْحُدُودِ وَرَدَّ الْحُقُوقَ إِلَى أَهْلِهَا بِالتَّثْبُتِ وَالْأَمْرِ الْبَيِّنِ وَإِحْيَاءِ السُّنَنِ النَّبِيِّ سَنَها الْقَوْمِ الصَّالِحِينَ وَأَعْظَمُ مَوْقِعًا، فَإِنَّ إِحْيَاءَ السُّنَنِ مِنَ الْخَيْرِ الَّذِي يَحْيَا وَلَا يَمُوتُ. وَجَوْرَ الرَّاعِي هَلَاكٌ لِلرَّعِيَّةِ، وَاسْتِعَانَتُهُ بِغَيْرِ أَهْلِ الثَّقَةِ وَالْخَيْرِ هَلَاكٌ لِلْعَامَةِ. فَاسْتَتِمَّ مَا آتَاكَ اللَّهُ يَا أَمِيرَ الْمُؤْمِنِينَ مِنَ النِّعَمِ بِحُسْنِ مُجَاوَرَتِهَا، وَالتَّمَسَّ الرِّيَاةَ فِيهَا بِالشُّكْرِ عَلَيْهَا؛ فَإِنَّ اللَّهَ تَبَارَكَ وَتَعَالَى يَقُولُ فِي كِتَابِهِ الْعَزِيزِ {لَئِنْ شَكَرْتُمْ لَأَزِيدَنَّكُمْ ۖ وَلَئِنْ كَفَرْتُمْ إِنَّ عَذَابِي لَشَدِيدٌ} [إبراهيم: 7]. وليس شيءٌ أَحَبَّ إِلَى اللَّهِ مِنَ الْإِصْلَاحِ، وَلَا أَبْغَضَ إِلَيْهِ مِنَ الْفَسَادِ، وَالْعَمَلُ بِالْمَعَاصِي كُفْرٌ النِّعَمِ، وَقَلَّ مَنْ كَفَرَ مِنْ قَوْمٍ قَطَّ النِّعْمَةَ ثُمَّ لَمْ يَفْزَعُوا إِلَى التَّوْبَةِ إِلَّا سَلُّوا عُرُوسَهُمْ وَسَلَّ اللَّهُ عَلَيْهِمْ عَذَابَهُمْ.

“Allahu, me mëshirën dhe dhembshurinë e Tij, i ka bërë sunduesit mëkëmbës në tokën e tij. Ai u dha atyre një dritë që ndriçon ato çështje që mbeten të paqarta mes njerëzve si dhe të drejtat/përgjegjësitë për të cilat ata mund të mos jenë në dijeni. Kjo dritë ndriçuese që kanë pushtetarët qëndron në vendosjen e kodit penal, kthimin e të drejtave atyre që e meritojnë me verifikim dhe drejtësi dhe ringjalljen e praktikave fisnike (sunsetit) që filluan myslimanët/popujt e devotshëm (*salihun*). Kjo detyrë përfundimtare

⁵Abdurr-Ra'uf Sa'id (Kajro: Mektebe el-Ez'herijje lit-turath, 2016), 13.

ka një rëndësi të madhe, sepse ringjallja e praktikave fisnike është një mirësi që jeton përjetësisht. Nga ana tjetër, shtypja e sundimtarit është shkatërrim për të sunduarit, ashtu siç është kërkimi i ndihmës [në qeverisje] nga të tjerët përveç fisnikëve dhe të besueshmeve. Kërko t'i përmbushësh ato begati që të ka dhënë Allahu, o Prijësi i Besimtarëve, me përgjigjen më të mirë. Kërkoni më shumë prej tyre duke falënderuar për to, sepse Allahu thotë në librin e tij fisnik: “**Dhe kujto kur Zoti yt shpalli: ‘Nëse jeni mirënjohës, do t’ju jap edhe më shumë. Por nëse jeni mosmirënjohës, padyshim që dënimi Im është i ashpër.’**”⁵ Nuk ka asgjë më të dashur tek Allahu se veprimi i drejtë/reformimi (*islah*) dhe asgjë më e neveritshme tek Allahu se korrupsioni/prishja (*fesad*), veprat e këqija dhe mosmirënjohja ndaj bekimeve. Shumë rrallë një popull ka qenë mosmirënjohës ndaj bekimeve hyjnore dhe ka refuzuar të pendohet për këtë [mosmirënjohje] përveç se Allahu ua ka hequr fuqinë dhe u ka dhënë armiqtë të tyre sundimin mbi ta.⁶”

2. Ahmad ibn ‘Ali el-Xhessas⁷

⁵ Kur’an, Ibrahim, 14:7.

⁶ Ebu Jusuf, *Kitab el-Kharaxh*, 15-16.

⁷ Ebu Bekr Ahmad ibn ‘Ali err-Rrazi el-Xhessas lindi në Rejj dhe më vonë studioi dhe u vendos në Bagdad. Pavarësisht ekspertizës së tij në hadith – ai ishte student i imamit të madh et-Taberani (vd. 360/971) – fusha e tij kryesore ishte në *fikh*, duke trashëguar përfundimisht karrigen

(vd. 370/981), *Abkam el-Kur'an*

وقوله تعالى: {إِنِّي جَاعِلُكَ لِلنَّاسِ إِمَامًا} فَإِنَّ الإِمَامَ مَنْ يُؤْتَمُّ بِهِ فِي أُمُورِ الدِّينِ مِنْ طَرِيقِ التَّوْبَةِ، وَكَذَلِكَ سَائِرُ الْأَنْبِيَاءِ أئِمَّةٌ عَلَيْهِمُ السَّلَامُ لِمَا أَلَزَمَ اللَّهُ تَعَالَى النَّاسَ مِنْ اتِّبَاعِهِمْ وَالإِئْتِمَامِ بِهِمْ فِي أُمُورِ دِينِهِمْ. فَالْخُلَفَاءُ أئِمَّةٌ لِأَنَّهُمْ رَتَبُوا فِي الْمَحَلِّ الَّذِي يَلْزَمُ النَّاسَ اتِّبَاعَهُمْ وَقَبُولَ قَوْلِهِمْ وَأَحْكَامِهِمْ، وَالْقَضَاءُ وَالْفِقْهَاءُ أئِمَّةٌ أَيْضًا. وَلِهَذَا الْمَعْنَى الَّذِي يَصْلِي بِالنَّاسِ يُسَمَّى إِمَامًا، لِأَنَّ مَنْ دَخَلَ فِي صَلَاتِهِ لَزِمَهُ الْإِتْبَاعَ لَهُ وَالإِئْتِمَامَ بِهِ. وَقَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: “إِنَّمَا جُعِلَ الإِمَامُ إِمَامًا لِيُؤْتَمَّ بِهِ فَإِذَا رَكَعَ فَارْكَعُوا، وَإِذَا سَجَدَ فَاسْجُدُوا” وَقَالَ: “لَا تَخْتَلِفُوا عَلَيَّ إِمَامِكُمْ” فَتَبَيَّنَتْ بِذَلِكَ أَنَّ اسْمَ الإِمَامَةِ مُسْتَحَقٌّ لِمَنْ يُلْزَمُ اتِّبَاعَهُ وَالإِقْتِدَاءَ بِهِ فِي أُمُورِ الدِّينِ أَوْ فِي شَيْءٍ مِنْهَا، وَقَدْ يُسَمَّى بِذَلِكَ مَنْ يُؤْتَمُّ بِهِ فِي الْبَاطِلِ، إِلاَّ أَنَّ الإِطْلَاقَ لَا يَتَنَاوَلُهُ، قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: {وَجَعَلْنَاهُمْ أئِمَّةً يَدْعُونَ إِلَى الْبَارِئِ} [القصص: 41] فَسَمَّوْا أئِمَّةً لِأَنَّهُمْ أَنْزَلُوهُمْ بِمَنْزِلَةِ مَنْ يَقْتَدَى بِهِمْ فِي أُمُورِ الدِّينِ وَإِنْ لَمْ يَكُونُوا أئِمَّةً يَجِبُ الإِقْتِدَاءُ بِهِمْ، كَمَا قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: {فَمَا أَغْنَتْ عَنْهُمْ آلِهَتُهُمْ الَّتِي يَدْعُونَ} [هود: 101] وَقَالَ: {وَإِنظُرْ إِلَى إِلْهِكَ الَّذِي ظَلْتَ عَلَيْهِ عَاكِفًا} [طه: 97] يُعْنَى فِي زَعْمِكَ وَاعْتِقَادِكَ. وَقَالَ الْبُنْيِي عَلَيْهِ السَّلَامُ: “أَخَوْفُ مَا أَخَافُ عَلَى أُمَّتِي أئِمَّةٌ مُضِلُّونَ”. وَالإِطْلَاقُ إِنَّمَا يَتَنَاوَلُ مَنْ يَجِبُ الإِئْتِمَامُ بِهِ فِي دِينِ اللَّهِ تَعَالَى وَفِي

e fikhut hanefi në Bagdad nga mësuesi i tij Ebu el-Hasan el-Karkhi (vd. 340/952). Ai shkroi shumë vepra që kanë pozitë të madhe në shkollën hanefite, duke përfshirë komente me reputacion mbi veprat e Imam Muhammed ibn el-Hasan esh-Shejbanit (vd. 189/805) dhe Ebu Xha'fer et-Tahauit (vd. 321/933), dhe një interpretim juridik *Abkam el-Kur'an*.

الحق والهدى. ألا ترى أن قوله تعالى: {إِنِّي جَاعِلُكَ لِلنَّاسِ إِمَامًا} قد أفاد ذلك من غير تقييد، وأنه كما ذكر أئمة الضلال قيده بقوله: {يَدْعُونَ إِلَى الْبَارِئِ} [البقرة: 221]. وإذا ثبت أن اسم الإمامة يتناول ما ذكرناه، فالأنبياء عليهم السلام في أعلى رتبة الإمامة، ثم الخلفاء الراشدون بعد ذلك، ثم العلماء والقضاة العدول ومن أزم الله تعالى الاقتداء بهم، ثم الإمامة في الصلاة ونحوها.

“Sa i përket ajetit, ‘Unë do të të bëj udhëheqës [imam] të njerëzve’⁸, udhëheqësi [imami] është ai që ndiqet në çështjet e fesë (*din*) përmes rrugës së profetësisë (*tarijke en-nubuueh*). Kjo vlen për të gjithë profetët, që Allahu i detyron njerëzit t’i ndjekin dhe t’u binden atyre në çështjet e tyre fetare. Kalifët janë gjithashtu imamë, sepse ata janë të vendosur në një pozicion ku njerëzit janë të detyruar t’i ndjekin ata dhe t’i pranojnë vendimet e tyre. Gjyqtarët dhe juristët janë gjithashtu imamë, dhe pikërisht për këtë (që imam është ai që pasohet) ai që e prin namazin quhet edhe imam sepse ata që i bashkohen namazit janë të detyruar që ta ndjekin atë [në veprimet e tij të namazit]. Profeti tha: “*Imami është bërë i tillë që të ndiqet, kështu që kur ai të përket, ju duhet të përketeni, dhe kur ai të bie në sexhde, ju duhet të bëni sexhde.*”⁹ Ai gjithashtu tha: “*Mos e kundërshtoni imamin tuaj.*”¹⁰ E gjithë kjo vërteton

8. Kur'an, El-Bekare, 2:124.

9. *Sahib el-Bukhari*, 689; *Sahib Muslim*, 414.

10. Ky nuk është një hadith i veçantë. Disa

se emri “imam” zbatohet për këdo, bindja dhe ndjekja e të cilit është e obliguar në çështjet e *din-it*, ose në ndonjë pjesë të tij.

“Imam” mund të përdoret gjithashtu për ata që u binden në vepra të këqija, megjithatë nëse fjala përdoret pa përcaktim, ajo nuk tregon këtë kuptim. Allahu thotë: “Ne i bëmë ata udhëheqës që i ftojnë (të tjerët) në zjarr.”¹¹ Ata (Faraoni dhe rrethi i tij) quhen “imamë” [në këtë ajet] për shkak se njerëzit e tyre i konsiderojnë ata si udhëheqës në çështjet e tyre të fesë, edhe pse ata nuk ishin (në fakt) udhëheqës, bindja e të cilëve ishte e obliguar [nga Allahu]. Një përdorim i ngjashëm gjendet në thënien e Allahut: “Zotat që ata i luteshin në vend të Allahut nuk ishin aspak ndihmës”¹² dhe në thënien e Tij: “Tani shikoni perëndinë tuaj të cilës i jeni përkushtuar”¹³ që do të thotë sipas pretendimit dhe besimit tuaj.¹⁴ Po kështu, Profeti ka thënë “*E vetmja gjë që kam më shumë frikë për*

umetin tim janë imamët e devijuar.”¹⁵ Fjala imam, kur përdoret pa cilësim, nënkupton një person që duhet ndjekur në fenë e Allahut, në të vërtetën dhe në udhëzime. Merreni parasysh fjalët e Allahut: “Unë do të të bëj udhëheqës të njerëzve”, ku fjala imam përdoret pa kualifikim, në krahasim me kur përmenden prijësit e së keqes me cilësimin “të cilët thërrasin në zjarr”. Pasi u vërtetua se çfarë përfshin kuptimi i fjalës imam (udhëheqje), vlen të përmendet se profetët janë në rangun më të lartë të udhëheqjes, të ndjekur nga kalifët e udhëzuar drejt, pastaj dijetarët dhe gjykatësit e ndershëm/të drejtë dhe kushdo tjetër që Allahu e ka detyruar bindjen ndaj tyre e pastaj ata që udhëheqin në namaz dhe të ngjashme me të.¹⁶

3. Ebu Shakur es-Salimi¹⁷ (vd.

15. *Musned Ahmed*, 27485.

16. Ebu Bekr el-Xhessas, *Abkam el-Kur'an*, ed. Muhammed Kamhau, 5 vëll. (Beirut: Dar el-Ihja et-Turath el-'Arabi, 1992), 1:84-85.

17. Ebu Shakur Muhammed b. 'Abd es-Sajjid b. Shu'ajb es-Salimi është një dijetar maturidi që jetoi në Transoksani në shekullin e pestë/të dhjetë. Informacion biografik rreth tij është i pakët. I lindur kah fillimi i shekullit të pestë, ai përmend takimin me juristin e madh hanefi, Shems el-E'imme el-Haluani (vd. 452/1060) dhe studimin e fikhut në Samarkand nën Ebu Bekr Muhammed el-Khatib. Ai jetoi në një periudhë të populluar nga disa nga teologët maturidi më autoritarë, duke përfshirë Ebu el-Jusr el-Bezdeuiun dhe Ebu el-Mu'in en-Nesefiun. Vepra e tij e vetme e njohur është

transmetime të hadithit të cituar më parë përfshijnë një frazë për këtë qëllim, siç janë ato të cituara në shënimin e mëparshëm.

11. Kur'an, El-Kasas, 28:41.

12. Kur'an, Hud, 11:101.

13. Kur'an, Taha, 20:97.

14. Çështja këtu me shembullin e “ilah-it”, duke ndjekur shembullin e “imam-it”, është se nganjëherë një fjalë përdoret në lidhje me raste individuale, jo sepse zbatohet për to në fakt, por sepse disa njerëz (gabimisht) e konsiderojnë atë si të tillë. Në raste të tilla, emri përdoret me një përcaktim që tregon përdorimin e jashtëzakonshëm.

pas 460/1066), *et-Tebhid fi Bejan et-Teubid*

اعلم بأن الخلافة ثابتة، والإمارة قائمة مشروعة واجبة على الناس أن يروا على أنفسهم إمامًا بدليل الكتاب والسنة وإجماع الأمة. أما الكتاب فقولته تعالى رَبَّنَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ؟. وأما السنة فإنه لما توفي رسول الله عليه السلام اجتمعت الصحابة رضي الله عنهم في سقيفة بني ساعدة الخزرجي المهاجرون والأنصار، فقالوا: سمعنا رسول الله عليه السلام يقول: “من مات ولم يرَ على نفسه إمامًا مات ميتة الجاهلية” فلا يجب أن يمضي علينا يومٌ ولا نرى لانفسنا إمامًا. وهذا يدل على أن من لم يرَ الإمام حقًا فإنه يكفر.

“Dije se kalifati është një çështje e vendosur [në din] dhe se udhëheqja politike është një çështje e vendosur dhe e ligjësuar. Është e detyrueshme për njerëzit që të caktojnë për vete një imam. Këtë e vërteton Kur’ani, Suneti dhe Konsensusi i umetit. Për sa i përket Kur’anit, Allahu thotë: **“O ju që besuat, binduni Allahut, binduni të Dërguarit dhe autoriteteve prej jush.”**”¹⁸ Sa i përket Sunetit, kur Pejgamberi ndërroi jetë, u mblodhën sahabët, muhaxhirë dhe ensarë në tendën e Beni Sa’ida el-Khazrexit dhe thanë: “E dëgjuaam të Dërguarin e Allahut

et-Tebhid fi Bejan et-Teubid. Autori i veprës *Isharat el-Meram* e rendit es-Salimin si një nga imamët e shkollës maturidite. Shih Ebu Shakur es-Salimi, *et-Tebhid Fi Bejan et-Teubid*, ed. Umar Turkman. (Bejrut: Dar ibn Hazm, 2017), 17-19.

18. Kur’an, en-Nisa’, 4:59.

duke thënë: “Kushdo që vdes pa imam para tij, vdes [si në periudhën] xhahilije”¹⁹; prandaj nuk është e drejtë që një ditë të kalojë mbi ne pa imam.” Kjo tregon se kushdo që mohon domosdoshmërinë e imamit, bën mosbesim (*jekfur*).²⁰”

4. Ebu el-Jusr el-Bezdeu²¹ (vd.

19. Ky transmetim gjendet me formulime paksa të ndryshme në *Sabih Muslim*, 1851; *Musned Ahmad*, 16876; *Sabih Ibn Hibban*, 4573; dhe të tjerët. Formulimi i transmetimit më të shëndoshë (te Muslimi) është: “Kushdo që vdes pa një betim besnikërie në qafë (në një imam) vdes me vdekje xhahili.” Një “vdekje xhahili”, siç shpjegon Ibn Haxheri, është të vdesësh në një gjendje mosbindjeje (jo mosbesimi) që i ngjan vdekjes së njerëzve të periudhës paraislame në një gjendje të humbur dhe pa një imam që i bindet (*Fet’h el-Bari*, ed. Muhibb ed-Din el-Khatib, 13 vëll., Bejrut: Dar el-Ma’rife, 1379, 13:7).

20. Kufri është i përfshirë në refuzimin e plotë të detyrimit - në krahasim me mosveprimin e tij - siç është rasti me refuzimin e çdo çështjeje të përcaktuar përfundimisht nga feja (*din*). Ebu Shakur es-Salimi, *et-Tebhid Fi Bejan et-Teubid*, ed. Umar Turkman. (Bejrut: Dar ibn Hazm, 2017), 309.

21. Ebu el-Jusr Muhammed ibn Muhammed el-Bezdeu, i lavdëruar gjithashtu si *Sadr el-Islam* (agimi/zemra e Islamit) dhe *el-Kadi* (Gjykatësi), lindi në fillim të shekullit të 5-të në Bukhara, aty ku dhe ndërroi jetë. Vëllai i tij i madh ishte teoricieni i njohur ligjor hanefi, Fakhr el-Islam Ebu el-Hasan el-Bezdeu (vd. 482/1089), dhe gjyshi i tyre, ose stërgjyshi sipas disa burimeve, kishte studiuar drejtpërdrejt me themeluesin e shkollës maturidite, Ebu Mansur el-Maturidi. Nga studentët e tij të shquar

493/1100), *Usul al-Din*

قال عامة أهل القبلة: يجب على الناس أن يختاروا واحدًا للإمامة ويفترض عليهم، إلا أنه فرض كفاية إن قام به البعض سقط عن الباقيين. وقال أبو بكر الأصم من المعتزلة وبعض الخوارج: إنه لا يجب ذلك، بل يجب على الناس أن يعملوا بكتاب الله تعالى، وأولئك قالوا: إن بكتاب الله تعالى كفاية وغنية عن الإمام فلا يجب عليهم تعيين أحد للإمامة. وجه قول عامة أهل القبلة: أن الصحابة بعد وفاة النبي عليه السلام اشتغلوا بتعيين الإمام وقدموه على سائر الفرائض. ولولا أنه فريضة لما قدموه على سائر الفرائض كقتال الكفار والكسب وغير ذلك، ولأنه لا بقاء للعالم إلا بدفع المنازعات وإنصاف المظلوم من الظالم وقتل السُّعَاة في الأرض بالفساد؛ فإن المنازعة تؤدي إلى التفاني وإلى فساد العالم، ولا يقوم ذلك إلا بالإمام، فيجب على الناس تعيين أحد للإمامة، ولكن إذا قام به البعض يسقط عن الباقيين. [وأما] قولهم: كتاب الله تعالى يُغني عن الإمام، فنقول: كل أحد من الناس لا يعمل بكتاب الله تعالى، هكذا أجرى الله تعالى العادة بين عباده، ولهذا ما أخلى الله تعالى زمانًا عن سائس

është autori i famshëm i *Kredos Neseffije*, ‘Umer en-Neseff, i cili e përshkruan atë si, “mësues (shejkh) i bashkëmoshatarëve tanë në Transoksani, i konsideruar si imami i të gjithë imamëve, me delegacione që vijnë për vizitë për të nga e gjithë bota. Lindja dhe Perëndimi janë të mbushura me shkrimet e tij mbi teologjinë dhe jurisprudencën, dhe ai ishte Kryegjykatësi i Samarkandit.” Shkrimet e tij më të famshme janë një vepër në teorinë juridike, *Ma’rifat el-Huxhaxh esh-Sher’ijje*, dhe një traktat teologjik, *Usul ed-Din*, nga e cila është marrë edhe pjesa e mësipërme.

في حقّ المؤمنين والكفار جميعًا.

“Njerëzit e Kibles [myslimanët]

mendojnë se është e nevojshme dhe e detyrueshme që njerëzit të zgjedhin një person [midis tyre] për pozitën e imametit. Megjithatë, ky është një detyrim shoqëror (*fard kifaje*) i mjaftueshmërisë; nëse disa njerëz e përmbushin atë, detyrimi bie nga pjesa tjetër.²² Ebu Bekr el-Esam nga mu’tezilët dhe disa nga hauarixhët menduan [në kundërshtim] se emërimi i një imam nuk është i detyrueshëm. Ata argumentuan se njerëzit janë të detyruar vetëm të mbajnë Librin e Allahut në të cilin mjafton caktimi i një imami. Arsyetimi i njerëzve të Kibles është se sahabët u angazhuan pas vdekjes së Profetit me detyrën e zgjedhjes dhe emërimit të imamit. Ata e kishin prioritet këtë detyrë mbi të gjitha detyrimet e tjera

22. *Fard kifaje* është ajo vepër e detyrueshme, kryerja e së cilës kërkohet patjetër nga një ose disa individë dhe kështu bie përgjegjësia nga komuniteti në përgjithësi, në krahasim me *fard ‘ajnin*, kryerja e të cilit kërkohet nga çdo individ ligjërisht përgjegjës. Veprimet e kategorisë së parë, nëse disa njerëz nga komuniteti përmbushin detyrën, përgjegjësia bie nga të gjithë pasi detyra është kryer. Nëse detyra mbetet e paplotësuar, të gjithë (në gjendje të kontribuojnë në detyrën e dhënë) janë përgjegjës. Shih es-Sarakhsi, *el-Mebsut* (Beirut: Dar el-Ma’rife, 31 vëll.), 30:263; Ibn ‘Abidin, *Redd el-Muhtar* (ed. ‘Adil Ahmed ‘Abdul Meuxhud dhe ‘Ali Muhammed Mu’aued, 14 vëll., Rijad: Dar ‘Alem el-Kutub, 2003, 1: 42, 352); el-Mehleui, *Tes’bil el-Usul ila ‘ilm el-Usul* (Karachi: Mektebet el-Bushra, 2012), 319.

– si luftimi i jobesimtarëve, fitimi i bukës e të ngjashme – diçka që nuk do ta kishin bërë po të mos ishte detyrim. Ata arsyetojnë gjithashtu se organizimi i botës kërkon parandalimin e mosmarrëveshjeve shoqërore, sigurimin e drejtësisë për të shtypurit nga shtypësit, kapjen e atyre që kërkojnë të mbjellin përçarje në tokë dhe të ngjashme, sepse mosmarrëveshja çon në dhunë dhe shkatërrim. Asnjë nga këto nuk mund të arrihet pa imamin. Prandaj, caktimi i imamit është i detyrueshëm, megjithëse nëse disa njerëz e përmbushin atë, përgjegjësia bie nga të tjerët. Për sa i përket qëndrimin të atyre që thonë se Libri i Allahut është i mjaftueshëm dhe e bën imamin të panevojshëm, ne pohojmë se jo të gjithë e përkrahin Librin e Allahut. Kështu Allahu e ka bërë zakonin [e Tij] hyjnor (*‘adetun*) në mesin e robërve të Tij [që disa të veprojnë drejt, ndërsa të tjerët jo]. Për këtë arsye, Allahu nuk ka lënë asnjë epokë pa udhëheqës politik si për besimtarët ashtu edhe për jobesimtarët.²³

5. Ebu el-Mu’in en-Nesefi²⁴ (vd.

23. Ebu Jusr el-Bezdeui, *Usul ed-Din*, ed. Han-Peter Linss dhe Ahmed Hixhazi es-Saka (Kajro: Mektebet el-Azharije li et-Turath, 2003), 191.

24. Ebu Mu’in Mejmun ibn Muhammed ibn Mu’temed en-Nesefi vjen nga një linjë erudite e juristëve hanefi dhe teologëve maturidi. Një nga paraardhësit e tij thuhet se ka studiuar me themeluesin e njëjtë të shkollës maturidijje. Nuk dihet shumë për

508/1115), *Tebisrat el-Edil-le*

إِنَّ الْمُسْلِمِينَ لَا بُدَّ لَهُمْ مِنْ إِمَامٍ
يَقُومُ بِتَنْفِيزِ أَحْكَامِهِمْ؛ وَإِقَامَةِ حُدُودِهِمْ
وَسَدِّ ثُغُورِهِمْ؛ وَتَجْهِيزِ جُيُوشِهِمْ؛ وَآخِذِ
صِدْقَاتِهِمْ؛ وَحِمَايَةِ بَيْضَتِهِمْ؛ وَقِطْعِ
مَادَّةِ شُرُورِ الْمُتَغَلِّبَةِ وَالْمُتَلَصِّصَةِ وَقِطْعِ
الطَّرِيقِ؛ وَإِقَامَةِ الْجُمُعِ وَالْأَعْيَادِ؛ وَقِطْعِ
الْمُنَازَعَاتِ الْوَاقِعَةِ بَيْنَهُمْ؛ وَقَبُولِ الشَّهَادَاتِ
الْقَائِمَةِ عَلَى الْحَقِّ لِكُلِّ لَأَمٍّ يُؤَدِّي التَّمَادِي
فِي الْمُنَازَعَةِ إِلَى التَّقَاتِلِ وَالتَّفَانِي؛ وَتَرْوِجِ
الصِّغَارِ وَالصِّغَائِرِ الَّذِينَ لَا أَوْلِيَاءَ لَهُمْ؛
وَقِسْمَةِ مَا آفَاءَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ الْغَنَائِمِ؛
وَلِهَذَا أُجْمِعُ الصَّحَابَةَ عَلَى نَصْبِ
الإِمَامِ؛ وَكَذَلِكَ طَلَبُوهُ وَلَمْ يَجْرَ بَيْنَهُمْ نِزَاعٌ
فِي وَجُوبِ طَلَبِهِ وَتَعْيِينِهِ بَلْ جَرَى ذَلِكَ
فِي التَّعْيِينِ إِلَى أَنْ انْعَقَدَ الْإِجْمَاعُ عَلَى
نَصْبِ أَبِي بَكْرٍ الصِّدِّيقِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ ثُمَّ
مَعَ مَا بَيْنَنَا مِنْ إِجْمَاعِ الصَّحَابَةِ عَلَى ذَلِكَ
وَالْحَاجَّةِ الْمَاسَّةِ إِلَيْهِ لِمَا بَيْنَنَا مِنَ الْأُمُورِ.

“Është e nevojshme që myslimanët të kenë një imam që zbaton gjykimet e tyre ligjore, ruan dënimet e tyre penale, mbron territoret kufitare, përgatit ushtritë

mësuesit e tij, por studentët e tij përfshijnë njerëz të famshëm si Nexhm ed-Din ‘Umer en-Nesefi (vd. 537/1142), autor i famshëm i *‘Akaidit nesefi*, dhe juristi me reputacion hanefi, Ala’ ed-Din el-Kasani (vd. 587/1191). Ai shihet si figura e dytë më e rëndësishme në zhvillimin e teologjisë maturidite me veprën *Tebisrat el-Edil-le* të tij që është një nga tekstet kryesore në traditën maturidite, aq sa studiuesve të mëvonshëm si Nur ed-Din es-Sabuni (vd. 580/1184) dhe vetë nxënësit të Ebu Mu’init, ‘Umer en-Nesefi, u mjaftoi përmbledhja e veprës së tij më të madhe në tekstet e tyre besimore – të gjitha këto janë thelbësore për studimin e kelamit maturidi deri më sot.

e tyre, mbledh sadakanë e tyre, ruan territoret e tyre, pret të keqen e bandave kriminale, hajdutëve dhe grabitësve të rrugëve, vendos namazin me xhemat të xhumasë dhe bajramit, zgjidh mosmarrëveshjet që lindin mes tyre, vendos procedurat ligjore dhe gjyqësore të gjykimit dhe të drejtave për të mos lejuar që këmbëngulja në mosmarrëveshje të kulmojë në dhunë dhe shkatërrim, lehtëson martesën e atyre pa kujdestarë dhe shpërndan Atë që Allahu u ka dhënë atyre nga plaçkat e luftës. Për këtë arsye, sahabët u pajtuan me [detyrën] e emërimit të një imami dhe e kërkuan këtë në mënyrë aktive. Nuk ka pasur asnjë debat mes tyre për detyrimin e përzgjedhjes dhe emërimit të një drejtuesi. Përkundrazi, mosmarrëveshja ndodhi vetëm në lidhje me kush të ishte imam, derisa më në fund ata u pajtuan për emërimin e Ebu Bekrit...²⁵

25. Provat dërrmuese, për imametin, hanefitë i mbështesin në dëshmi tekstuale. Së pari, praktika unanime e sahabëve menjëherë pas vdekjes së Profetit përmendet gjerësisht. Së dyti, fakti që kaq shumë vendime ligjore në Sheri'at varen nga ekzistenca e një imami, veçanërisht ato që synojnë stabilitetin shoqëror dhe ruajtjen e Islamit shoqëror. Prandaj, ajo që përcakton një detyrim është në vetvete një detyrim dhe bëhet një refren kryesor si provë. Një argument i mëtejshëm i përbashkët si nga sunitët ashtu edhe nga mu'tezilët është nevoja për autoritet politik për hir të mirëqenies së përgjithshme njerëzore, ku kjo e fundit e nxjerr këtë kryesisht nga

وَلَا عِبْرَةَ لَخِلَافِ أَبِي بَكْرٍ الْأَصَمِّ وَهشام بن عمرو من رؤساء القدرية وقولهما إِنَّ ذَلِكَ لَيْسَ بِوَاجِبٍ؛ وتعليل الأصم أَنَّ النَّاسَ لَوْ كَفَوْا عَنِ الْمِظَالِمِ لَأَسْتَعْنَوْا عَنِ الْإِمَامِ؛ لَا عِبْرَةَ لِهَذَا لِأَنَّ قَوْمًا لَوْ اسْتَعْنَوْا عَنْهُ لَكَانَتِ الصَّحَابَةُ - رضوان الله عليهم - مع جلال أقدارهم وشدة اختراصهم عمَّا لَا يَجِلُّ الشَّرِيعَةُ وَلَا يَجْمَلُ فِي الْمَرْوَةِ وامتناعهم عن الظلم والتعدي أولى الناس بالاستغناء عن ذلك، وحيث لم يستغن عنه دَلٌّ أَنَّ ذَلِكَ لَيْسَ بِشَيْءٍ، مع أَنَّ وِرَاءَ قَطِيعِ الْمَنَازِعَاتِ وَإِنصَافِ الْمَظْلُومِ مِنَ الظَّالِمِ أُمُورًا أُخْرَى لَا يَتِمَكَّنُ مِنَ الْقِيَامِ بِهَا إِلَّا الْإِمَامُ عَلَى مَا بَيَّنَّا. والدليل عليه ما رَوَى عَنِ النَّبِيِّ عَلَيْهِ السَّلَامُ أَنَّهُ قَالَ: "مَنْ مَاتَ وَلَيْسَ لَهُ إِمَامٌ عَامَّةٌ فَقَدْ مَاتَ مِيتَةً جَاهِلِيَّةً" فثبت بذلك بطلان مقالتهما وتقرر وجوب نصب الإمام، والله الموفق.

"Nuk ka asnjë konsideratë për kundërshtimin e Ebu Bekr el-Esam dhe Hisham ibn 'Amr, që të dy nga eksponentët kryesorë të kaderive, dhe pretendimin e tyre se nuk është i detyrueshëm (caktimi i një imami). El-Esam arsyeton se përderisa njerëzit janë në gjendje të parandalojnë shtypjen dhe padrejtësinë mes tyre, nuk ka nevojë për një imam. Nuk merret parasysh kjo, sepse nëse do të kishte ndonjë popull që nuk do të kishte nevojë për një imam, do të kishin qenë sahabët, duke pasur parasysh gradën e tyre tepër të lartë, dëshirën e thellë

parimet racionale, dhe e para mbështetet më shumë në shkrimet e shenjta. Shih Ebu eth-Thena el-Alusi, *Nebxh es-Selame ila Mebahithil Imame*, ed. 'Abdullah el-Bukhari., Kajro: Dar ibn 'Affan, 2018), 135-137.

për të shmangur gjithçka që binte në kundërshtim me Sheri'atin dhe nuk i përshtatej moralit kalorësiak (fisnik) [murru'e] dhe refuzimit të tyre për të marrë pjesë në ndonjë shtypje apo shkelje. Të gjitha këto do t'i kishin bërë ata kandidatët më të mundshëm për të mos pasur nevojë për ngritjen e këtij institucioni, por nuk ishte kështu, gjë që tregon se ky kundërshtim nuk ka asnjë peshë. Më tej, ka edhe çështje të tjera përtej vendosjes së drejtësisë dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që përmendëm tashmë, të cilat të gjitha nuk mund të arrihen pa imamin. Një dëshmi [zbuluese] për qëndrimin tonë është hadithi i Profetit: “Kush vdes pa imam, vdes me vdekje nga injoranca [paraislame].”²⁶ Me këtë dëshmi del qartë pavlefshmëria e pretendimit të të dyve dhe vërtetohet detyrimi i caktimit të imamit – dhe Allahu është Ai që mundëson.²⁷

6. ‘Ala’ ed-Din el-Kasani²⁸ (vd.

26. Për këtë hadith shih shënim 19.

27. Ebu el-Mu'in en-Nesefi, *Tebsiret el-Edile*, ed. Claude Salame, 2 vëll. (Damask: El-Ma'had el-'Ilmi el-Ferensi li ed-Dirasat el-'Arabijje, 1993), 2: 823-825.

28. Ebu Bekr ibn Mes'ud ibn Ahmed el-Kasani, i mbiquajtur “Mbreti i Dijetarëve” (*Malik el-'Ulema*), është një jurist i shquar hanefi, i cili shkroi një nga veprat më të besueshme referuese në shkollën hanefite, *Beda'i' s-Sana'i' fi tertib esh-Shera'i'*, së bashku me disa shkrime në shkencën e teologjisë racionale. Pas një mosmarrëveshjeje gjyqësore, ai u dërgua nga sulltani Selxhuk si emisar tek Nur ed-Din ez-Zengi (vd.

587/1191), *Beda'i' es-Sana'i'*

(أما) الأول فنصب القاضي فرض؛ لأنه يُنصب لإقامة أمر مفروض، وهو القضاء، قال الله سبحانه وتعالى {يُذَوِّدُ أَنَا جَعَلْتِكَ خَلِيفَةً فِي الْأَرْضِ فَأَحْكُم بَيْنَ النَّاسِ بِالْحَقِّ} [ص: 26]؛ وقال تبارك وتعالى كُنِينَا الْمَكْرَمَ عَلَيْهِ أَفْضَلُ الصَّلَاةِ وَالسَّلَامِ: {فَأَحْكُم بَيْنَهُمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ} [المائدة: 48]؛ والقضاء هو الحكم بين الناس بالحق، والحكم بما أنزل الله عز وجل، فكان نصب القاضي لإقامة الفرض، فكان فرضاً ضرورياً؛ ولأنَّ نَصِبَ الإمام الأعظم فرض، بلا خلاف بين أهل الحق، ولا عبرة بخلاف بعض القدرية لإجماع الصحابة – رضي الله عنهم – على ذلك، ولمسأس الحاجة إليه؛ لتقيد الأحكام، وإنصاف المظلوم من الظالم، وقطع المنازعات التي هي مادة الفساد، وغير ذلك من المصالح التي لا تقوم إلا بإمام، لما علم في أصول الكلام، ومعلوم أنه لا يمكنه القيام بما نصب له بنفسه، فيحتاج إلى نائب يقوم مقامه في ذلك وهو القاضي؛ ولهذا كان رسول الله – صلى الله عليه وسلم – يبعث إلى الآفاق قضاة، فبعث سيدنا معاذاً – رضي الله عنه – إلى اليمن، وبعث عتاب بن أسيد إلى مكة، فكان نصب القاضي من ضرورات نصب الإمام، فكان فرضاً؛ وقد سماه محمد فريضة محكمة؛ لأنه لا يحتمل النسخ؛ لكونه من الأحكام التي عُرفَ وجوبها بالعقل، والحكم العقلي لا

570/1174) në Haleb, ku u emërua si mësues i jurisprudencës hanefi në medresenë Halauijje. Ai studioi te Ebu el-Mu'in en-Nesefi dhe ‘Ala ed-Din es-Samarkandi dhe u dha mësim nxënësve duke përfshirë Xhemal ed-Din el-Ghaznauin (vd. 593/1196). Ai ndërroi jetë në Haleb dhe u varros pranë gruas së tij në mekamin e profetit Ibrahim.

يَحْتَمِلُ الانتِساخَ، واللّٰهُ تَعَالَىٰ اَعْلَمُ.
 “Sa i përket çështjes së parë, caktimi i gjyqtarit është i detyrueshëm sepse caktimi i tij lehtëson kryerjen e një detyrimi, përkatësisht vendimit gjyqësor [kada].²⁹ Allahu thotë: **“O Davud! Ne të kemi bërë ty autoritet në tokë, prandaj gjyko mes njerëzve me të vërtetën.”**³⁰

Allahu i thotë gjithashtu Profetit tonë: **“Pra, gjyko mes tyre me atë që ka zbritur Allahu.”**³¹ Vendimi gjyqësor [kada] është gjykimi ndërmjet njerëzve me të vërtetën dhe me atë që ka shpallur Allahu. Pra, emërimi i një gjyqtari lehtëson një detyrim dhe për rrjedhojë është detyrim në vetvete. Një mënyrë tjetër për të vërtetuar domosdoshmërinë e caktimit të gjyqtarëve rrjedh nga detyrimi i emërimit të imamit, i cili njëzëri konsiderohet i detyrueshëm pa ndonjë mosmarrëveshje midis dijetarëve të së vërtetës - pa marrë parasysh kundërshtimin e disa prej kaderive - për shkak se konsensusi i sahabëve dhe nevoja e madhe për të [në lidhje me funksionet e ndryshme]: zbatimi i vendimeve [të

29. Ky pasazh është nga një seksion mbi gjyqësorin [Kitab Adab el-Kadi] në të cilin autori e ndan diskutimin në nënçështje të ndryshme. “Çështja e parë” lidhet me detyrimin e emërimit të gjyqtarëve. Është e rëndësishme për qëllimet tona, sepse autori e lidh këtë detyrim me atë të caktimit të imamit.

30. Kur’an, Sad, 38:26.

31. Kur’an, Ma’ide, 5:7.

Sheri’atit], dhënia e drejtësisë për të shtypurit kundër shtypësve të tyre, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, të cilat janë materiali (potencial) i shthurjes dhe një mori interesash të tjera që nuk mund të sigurohen veçse nga një imam – siç shtjellohet në veprat e teologjisë racionale (*kelam*). Është gjithashtu fakt se imami nuk mund t’i kryejë të gjitha këta funksione i vetëm; ai kërkon një zëvendës që të zërë vendin e tij - ky zëvendës është gjykatësi.³² Për këtë arsye, i Dërguari dërgoi gjyqtarë në krahina të ndryshme. Për shembull, sejiduna Mu’adh u dërgua në Jemen dhe ‘Atab ibn Usejd u dërgua në Mekë. Prandaj, caktimi i gjykatësve është nga kërkesat e caktimit të një imami, dhe për këtë arsye është në vetvete i detyrueshëm. Muhamedi [Ibn el-

32. Për sa i përket provës për detyrimin e imametit, konsensusi i sahabëve ka një rëndësi të veçantë në shkollën hanefite, duke pasur parasysh fokusin e saj në praktikën e bazuar te selefët, ndonëse edhe shkollat e tjera e përdorin këtë dëshmi. Një argument interesant që është më unik për hanefitet është mbështetja e madhe brenda akteve simbolike publike të adhurimit në praninë e imamit. Kjo përfshin, ndër të tjera, namazin e xhumasë, namazin e bajramit, namazin e xhenazes dhe mbledhjen e zekatit. Një studim interesant do të kërkonte të mishëronte detyrimin e imamit nga pikëpamja hanefite, duke u mbështetur vetëm në aktet e bazuara në adhurim dhe jo në detyrat administrative të shtetit. Shih Salah Ebu el-Haxhxh, *es-Sjjase err-Rrashide Fi Deulet el-Maxhhide* (Amman: Dar el-Faruk) dhe *Medkhal el-Mufjassal ila el-Fikh el-Hanefi* (Amman: Dar el-Fath, 2017).

Hasan] e quajti atë si një detyrim përfundimtar (*farida mubkeme*) sepse nuk i nënshtrohet shfuqizimit; është detyrim i njohur përmes arsyes dhe vendimet racionale nuk i nënshtrohen shfuqizimit.³³

33. Arsyetimi i El-Kasanit këtu tregon nevojën racionale të ruajtjes së mirëqenies njerëzore, një largim nga prirjet më zbuluese të mendimtarëve të tjerë maturidi/hanefi. Kjo duket të jetë tregues, për sa i përket mendimit juridik, për një “kthesë teologjike” që përpiqet të shkrijë shkollën teologjike maturidite, të sapo konsoliduar, në teorinë juridike hanefite - një fenomen që ndodhi në Transoksaninë e shekullit të 7-të dhe të 8-të. Shih Suhejl Hanif, *Al-Kasani, Encyclopaedia of*

Allahu e di më së miri.”^{34, 35}

Përktheu: Haki Sahitaj

Islam, botimi i 3-të, i ardhshëm.

34. Ala ed-Din El-Kasani, *Beda'i es-Sana'i fi Tertib esh-Shera'i*, ed. 'Adil Ahmed 'Abdul Meuxhud dhe 'Ali Muhammed Mu'aued, 10 vëll., (Beirut: Dar el-Kutub el-'Ilmijje, 2002), 9: 82-85.

35. Burimi: Asim Ayub, “Early Hanefi Authorities on the Imamate,” *Ummatics*, August 13, 2023, <https://ummatcs.org/papers/early-hanefi-authorities-on-the-imamate>.

Liria e ndërgjegjes dhe besimit sipas parimeve juridiko-civile dhe konventave ndërkombëtare

Prof. asoc. dr. Saimir Shatku
Fakulteti i Drejtësisë
Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Të drejtat e njeriut përfaqësojnë të drejta thelbësore, të cilat burojnë prej vetë faktit të ekzistencës së genies njerëzore, duke lindur bashkë me të, dhe si të tilla ato gëzojnë mbrojtje të veçantë nga mekanizmat shtetërorë. Këto të drejta përfaqësojnë qëllimet dhe idealet më të larta njerëzore, të cilat, ndonëse të shprehura në forma të ndryshme, i japin kuptim afirmimit dhe realizimit të aspekteve jetësore të njeriut. Një ndër to është liria e besimit dhe e ndërgjegjes, ku për vetë rëndësinë që ato paraqesin, në këtë kuadër të drejtash, ushtrimi i tyre mbrohet dhe sanksionohet nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare.

Nisur nga praktika e zhvillimeve historike në botë, konstatojmë se kjo liri nuk është zbatuar kudo dhe kurdo njësoj, pasi kanë qenë të shpeshta rastet e kufizimit të saj, në shumë shtete të botës, për arsye të lidhura ngushtësisht me zhvillimet e ndryshme politike, historike, sociale, etj.

E drejta e ndërgjegjes dhe e ushtrimit të lirë të besimit, shpeshherë cenohet nga prania e formave të shumta të diskriminimit për atë kategori personash, të cilët zgjedhin të manifestojnë besimin e tyre në mënyrën që dëshirojnë të shprehin. Në mënyrë që të vihen në jetë, është e nevojshme të ndërthuren shumë faktorë dhe të parashikohen shumë mekanizma për realizimin e tyre. Ndër mekanizmat kryesore që shërbejnë për këtë qëllim janë parashikimi dhe respektimi i parimeve gjerësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, të cilat janë sanksionuar në akte dhe konventa me fuqi ndërshtetërore. Këtu evidentohet përgjegjësia dhe detyrimi i shtetit nëpërmjet mbrojtjes efektive të të drejtave ndaj individëve të tij, e cila, në terminologjinë juridike, njihet si e drejta pasive e shtetit.

1. Hyrje

Individët mund të mbrohen nga veprimet arbitrare të autoriteteve publike të një shteti vetëm atëherë kur të drejtat e tyre janë të sanksionuara dhe të parashikuara shprehimisht me ligj, sidomos në rastin e të drejtave universale, ku ato duhet trajtohen në përputhje me parimet e vendosura në aktet dhe konventat ndërkombëtare. Ashtu siç parashikohet edhe në konventat universale për të drejtat e njeriut, siç janë Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Akti Final i Helsinkit, etj., të drejtat themelore të individëve, për shtetet të cilat i kanë përfshirë dhe pranuar këto akte në legjislacionet e tyre, lind detyrimi pozitiv për mbrojtjen e vënien në zbatim të tyre. Praktika dhe jurisprudenca qartëson faktin se autoriteteve shtetërore mund të mos u kërkohet vetëm të distancohen nga ndërmarrja e hapave cenues, që mund të ndërhyjnë në mendim, ndërgjegje dhe fe, por edhe në rrethana të caktuara për të ndërmarrë masa pozitive që do të ushqejnë e mbrojnë këto të drejta.

2. Liria e besimit dhe ndërgjegjes në të drejtën ndërkombëtare

Besimi dhe feja janë dy koncepte sa të ndryshme, aq edhe të ngjashme me njëra-tjetrën dhe faktorët që

karakterizojnë secilën prej tyre kanë krijuar polemika të shumta në rang ndërkombëtar duke hapur debate dhe duke krijuar çështje delikate për shqyrtim. Përpara se të analizojmë kuadrin ligjor që rregullon të drejtën e ushtrimit të besimit, është e nevojshme të ndalemi në përcaktimin e termimit “besim” dhe lidhjen e tij me fenë. Besimi është koncept më i gjerë sesa feja, pasi besimi përfshin një nga liritë fetare në të, por nuk kufizohet vetëm në të. Në kuptimin e ngushtë, liria e besimit përfshin lirinë e mendimit dhe ndërgjegjes për të gjitha çështjet dhe bindjet personale, duke i manifestuar ato.

Liria fetare përcaktohet si aftësia për të besuar në diçka dhe për ta shfaqur atë besim dhe kjo nuk është vetëm çështje ligjore, por edhe morale. Besimi fetar lidhet vazhdimisht me jetën private të njeriut, sepse prek bindjet personale të tij. Feja është një ndër elementet kryesore për të shprehur identitetin kulturor të individit dhe kjo është arsyeja pse liritë fetare shfaqin problematika në zbatimin e lirive të tij. Kjo e drejtë sanksionohet rishtazi në nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në disa sisteme juridike kushtetuese.

Feja dhe besimi janë elemente thelbësore të politikës dhe të zhvillimit të shoqërisë, ndaj dhe shpeshherë ato keqpërdoren për kërkesa politike dhe pretendime të pushtetit, duke sjellë pasoja të

jashtëzakonshme për njerëzimin. Në konfliktet e ditëve të sotme në shtetet me kultura të ndryshme, janë vënë re persekutime mbi baza fetare, duke cenuar në këtë mënyrë besimtarët dhe jo besimtarët. Nuk janë të pakta rastet e sulmeve terroriste me bazë ideologjike të keqpërdorur fetare. Vlen të përmenden këtu sulmet e 11 shtatorit, konfliktet mes Indisë dhe Pakistanit, si dhe veprimet e organizatave fetare ekstremiste si ISIS. Fatkeqësisht, ekzistojnë edhe shumë raste të tjera që theksojnë lidhjen e fesë me ekstremizmin. Por, duhet pranuar se jo të gjithë terroristët ose ekstremistët janë fetarë, ashtu siç nuk janë të gjithë besimtarët terroristë.

Kërcënimet ndaj lirisë së mendimit, ndërgjegjes, besimit e fesë së individëve dhe grupeve të njerëzve ndikojnë drejtpërdrejt në sigurimin dhe zhvillimin e integritetit të tyre personal. Kur diskriminimi dhe persekutimi mbi baza fetare është sistematik dhe i institucionalizuar, ai mund të rezultojë me tensione mes bashkësive e madje edhe në kriza ndërkombëtare. Shkaktarë të pasigurisë mund të jenë të gjithë individët, grupet, por edhe shtetet. Kjo kanosje e plotfuqishme dhe e gjithë-pranishme ndaj sigurisë personale, e bazuar në besim ose fe, kërkon masa mbrojtëse të posaçme. Arsimimi dhe edukimi për të drejtat e njeriut paraqet bazë për krijimin e respektit ndaj mendimeve dhe besimeve fetare të të tjerëve.

3. Besimi dhe ndërgjegjja në aktet dhe konventat ndërkombëtare

Rëndësia e mbrojtjes së lirisë fetare dhe ushtrimit të formave të shumta të besimit, ndikon në arritjen e qëndrueshmërisë dhe paqes midis shoqërive të ndryshme të botës dhe përfaqëson një nga argumentet më të fuqishme për ta mbrojtur atë në nivel ndërkombëtar. Për këto arsye, e drejta ndërkombëtare ka sanksionuar një tërësi parimesh dhe ka zhvilluar një kuadër të plotë normash ligjore që mbrojnë lirinë e ushtrimit të besimit. Ndër aktet dhe instrumentet kryesore ndërkombëtare mund të përmendim:

1. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 1950;

2. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948¹;

3. Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Politike dhe Qytetare, 1966²;

4. Deklarata e KB “Mbi Heqjen e të Gjitha Formave të Intolerancës dhe të Pabarazisë mbi bazën e Fesë apo Besimit, 1981;

5. Akti Përfundimtar i Helsinkit, 1975.

Le të shohim shkurtimisht se çfarë parashikojnë disa prej tyre.

1. Konkretisht neni 18.

2. Konkretisht neni 18.

► Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Të trajtojmë dispozitat dhe parimet e **Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut**, të cilat janë të detyrueshme për zbatim në shtetin tonë. Nisur nga vetë rëndësia hierarkike që i ka dhënë Kushtetuta kësaj konvente mbi ligjet e vendit³ vërejmë se:

Neni 9 i KEDNJ - Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 14 i KEDNJ - Ndalimi i diskriminimit

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha,

3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, neni 122.

feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

► Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Lista e lirive të ushtrimit të besimit është e parashikuar në nenin 18 të **Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike**, duke përcaktuar formulime të të drejtave të njohura ndërkombëtarisht. Ndër to përmendim:

“Lirinë për të manifestuar individualisht ose besimin, si dhe për të themeluar dhe mbajtur vende për këtë qëllim; Lirinë për të prodhuar, blerë dhe përdorur deri në një masë të caktuar, artikuj dhe materiale të nevojshme që kanë të bëjnë me ritet ose zakonet e një feje dhe besimi; Lirinë për të trajnuar, emëruar, zgjedhur, ose caktuar sipas trashëgimisë udhëheqësit e caktuar, sipas kërkesave dhe standardeve të çfarëdo feje ose besimi; Lirinë e individëve për të zbatuar ditët e pushimit dhe për të festuar ditët e shenjta dhe ceremonitë, në pajtim me parimet e fesë dhe besimit të tij; Liritë fetare në punë, duke përfshirë të drejtën për t'u lutur, veshur dhe për të ngrënë sipas parimeve të fetare dhe besimit të caktuar; Lirinë për të deklaruar lirshëm besimin; Të drejtën për të ndryshuar dhe refuzuar një fe; Të drejtën për arsimim fetar për “interesa” të fëmijës”, etj.”

Një fe ose besim mund dhe zakonisht manifestohet në bashkësi me tjerët, që do të thotë

se manifestohet në vende publike. Kjo nënkupton respektimin e lirisë së grumbullimit dhe bashkimit, gjithashtu edhe të bashkësive të besimtarëve. Organet e caktuara, të cilat bazohen dhe organizohen sipas parimeve fetare, gjithashtu gëzojnë mbrojtje të plotë ligjore. Këto organe mund të jenë shtëpitë e kultit ose institucionet arsimore që merren me çështje fetare, ose edhe OJQ-të. Të drejtat e tyre përfshijnë:

- Lirinë për të themeluar dhe mbajtur institucione të caktuara bamirëse ose humanitare;
- Lirinë për të shkruar, shtypur dhe përhapur botime të rëndësishme të këtyre fushave;
- Lirinë për të ofruar mësim për fenë në vende të përshtatshme për këtë qëllim.

Liria për të manifestuar besimin fetar përfshin mbrojtjen e fjalëve, mësimëve, praktikave, kulteve dhe zbatimit të atij besimi. Manifestimi i fesë ose besimit nënkupton gjithashtu mundësinë e shmangies së veprimeve të kundërta me rregullat e besimit konkret. Veprime të tilla mund të jenë refuzimi i dhënies së betimeve, shërbimet ushtarake, pjesëmarrja në ceremoni fetare, pranimet ose trajtimet e detyrueshme mjekësore.

Por, ashtu si çdo e drejtë nuk është absolute, ashtu edhe e drejta e besimit ka kufizimet e saj, të cilat duhet të jenë proporcionale dhe të bazuara në ligj. Kufizimet mund të vihen vetëm kur kjo është e

domosdoshme për sigurinë dhe rendin publik, shëndetin, moralin ose të drejtat dhe liritë thelbësore të njeriut.

► **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut**, në nenin 18⁴ të saj përcakton se:

“Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndërrimit të besimit apo të bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht besimin apo bindjen e vet me anë të dhënies së mësimëve, kryerjes së kultit dhe riteve fetare.”.

► **Akti Final i Helsinkit 1975**

Akti Final i Helsinkit 1975⁵

parashikon se: *“Shtetet pjesëmarrëse do të respektojnë (...) lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit, për të gjithë, pa dallim race, gjinie, gjube apo feje.”.*

Brenda këtij kuadri, shtetet pjesëmarrëse do të njohin dhe respektojnë lirinë e individit për të pranuar dhe ushtruar, vetëm apo në bashkësi me të tjerë, fenë apo besimin, duke vepruar në përputhje me vullnetin e ndërgjegjes së vet.

4. Kuadri ligjor kombëtar në mbrojtje të lirisë së besimit

Disa prej akteve kombëtare të legjislationit tonë të brendshëm, të

4. Liria e Mendimit, e ndërgjegjes dhe e besimit.

5. Deklarata mbi Parimet që Rregullojnë Marrëdhëniet midis Shteteve Pjesëmarrëse, parimi VII, par. 1 dhe 3.

cilat rregullojnë dhe sanksionojnë parimet bazë në të cilat mbështetet dhe realizohet e drejta e besimit, duke u mbrojtur posaçërisht nga këto të drejta, janë:

► Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta është akti themelor i shtetit tonë demokratik, e cila, në dispozitave saj, parashikon dhe mbrojtë të drejtat themelore të njeriut, duke i shpallur ato si të patjetërsueshme dhe të padhunueshme.

Neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon:

“Shqipëria nuk ka fe zyrtare. Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. Shteti njihet barazinë e bashkësive fetare... Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjellë pavarësinë e njëritjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.”.

Ky nen sanksionon neutralitetin e shtetit shqiptar në raport me komunitetet fetare si dhe në raport

me çështjet e besimit e të ndërgjegjes në përgjithësi. Kushtetuta nuk njihet fe zyrtare dhe as privilegjon asnjërin prej feve. Kushtetuta krijon mundësi për barazi midis komuniteteve fetare. Gjithashtu shteti i njihet çdo individ lirinë e kultit si liri e personit për të marrë pjesë në një bashkësi fetare dhe në praktikën e saj.

Neni 18 citon se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuba, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlyje e arsyeshme dhe objektive.”.*

Neni 24 i Kushtetutës shpreh: *“Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.”.*

Përveç të drejtës së besimit, rezultojnë edhe e drejta e personale për të marrë pjesë në jetën dhe praktikën e bashkësive fetare. Jo të gjitha shtetet kanë të sanksionuar në ligjin themelor të shteti të drejtën e fesë apo të drejtën e

zgjedhjes së fesë. Ushtrimi i lirë i fesë është i ngjashëm me liritë e tjera që janë renditur në katalogun për të drejtat dhe liritë themelore si: liria e fjalës, liria e tubimit. Liria e besimit dhe ushtrimi i lirë i saj është bërë pjesë e legjislacionit shqiptar edhe nëpërmjet ratifikimit të konventave ndërkombëtare nga ana e shtetit shqiptar. Konventat dhe aktet që mbrojnë të drejtat themelore të individit sanksionojnë edhe lirinë e besimit si një e drejtë themelore e individit.

Kushtetuta rregullon marrëveshjet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare, ku në bazë të nenit 10, pika 5 e Kushtetutës, marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Kështu si burime ligjore që rregullojnë marrëdhëniet përkatëse janë nënshkruar dhe ratifikuar aktualisht katër marrëveshje⁶: Këto marrëveshje

6. Është ratifikuar marrëveshja ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Selisë së Shenjtë të Vatikanit, e cila ishte miratuar njëherë në 2003. Ligji nr. 10 056, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkësisë Islame të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”. Ligji nr. 10 057, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”. Ligji nr.

ngjasojnë me aktet ndërkombëtare që bëhen pjesë e sistemit të brendshëm, pasi marrëveshjet ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Komuniteteve ratifikohet me ligj në Kuvend. Pas ratifikimit, shteti nuk mund të ndërhyjë në çështjet e komuniteteve fetare veçse nëpërmjet marrëveshjeve të sipërpërmendura. Objekt i këtyre marrëveshjeve është rregullimi i çështjeve të marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit midis shtetit shqiptar dhe komunitetit përkatës, në bazë të parimeve kushtetuese që garantojnë lirinë e shfaqjes dhe ushtrimit të besimit fetar, si dhe të dëshirës së përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar marrëdhëniet e ndërsjella. Qëllimi i tyre është:

- të garantojnë realizimin e të drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë;

- të njohë e të garantojë respektimin e të drejtave të komunitetit fetar, të institucioneve dhe strukturave të tyre, si dhe të personave juridikë të themeluar prej tyre, për të zhvilluar lirisht misionin e tyre fetar, edukativ e bamirës;

- të njohë dhe të garantojë paprekshmërinë e institucioneve të kultit, për aq sa veprimtaria e

10 058, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjeve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.

tyre nuk vjen në kundërshtim me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, si dhe me Kushtetutën e ligjet në fuqi dhe me kanonet dhe traditën e shenjtë të komunitetit fetar;

- të garantojë lirinë e individit për të zgjedhur ose ndryshuar fenë, për ta shfaqur atë individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare, ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së rriteve fetare.

5. Praktika gjyqësore ndërkombëtare në ushtrimin e së drejtës së besimit

Që nga krijimi i saj Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka luajtur rol në zgjidhjen e konflikteve dhe vënien në vend të të drejtave thelbësore të njeriut të shkelura nga shtetet përkatëse. Nëpërmjet praktikës së saj, ajo ka shërbyer si mjeti i fundit ligjor dhe më efektiv në zgjidhjen e drejtë të çështjeve të paraqitura nga individë të cenuar nga shkelja e së drejtës ndërkombëtare. Jurisprudenca e kësaj gjykate është e plotë dhe rastet e trajtuara prej saj kanë qenë të shumta sidomos në fushën e cenimit të të drejtave të lidhura me ushtrimin e lirë e të plotë të besimit. Në mënyrë që të njohim mënyrën e trajtimit të saj nga ana e praktikës gjyqësore të kësaj gjykate, është e nevojshme të paraqesim disa nga rastet praktike nga jurisprudenca e saj.

Lidhur me të drejtën e ushtrimit të besimit, GJEDNJ, ka theksuar

se kufizimet mbi shfaqjen e lirisë së besimit janë të lejueshme vetëm në rastet:

1 - të përcaktuara në ligj;

2- përmbushin një nga rastet e kufizimeve të ligjshme si - p.sh., siguria shtetërore, mbrojtja e rendit publik, shëndetit apo moralit, apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, dhe ajo çka ka rezultuar të jetë më e rëndësishmja në rastet që rregullojnë këtë çështje;

3- kufizime të tilla janë “të përpjesëtueshme” në kuptimin që janë “të nevojshme në një shoqëri demokratike” me interesa të tjera në listën e kufizuar të synimeve të ligjshme.

Në çështjen “*Senay Karaduman kundër Turqisë*” të vitit 1993, Komisioni Evropian la në fuqi vendimin e gjykatave turke për ndalimin e mbajtjes së shamive islame në mjediset e universitetit: “Komisioni është i mendimit se duke zgjedhur të ndjekë studimet e larta në një universitet laik, studenti apo studentja i nënshtrohet rregullave të universitetit, të cilat mund t’ia kufizojnë lirinë studentëve për të shfaqur fenë në lidhje me vendin dhe mënyrën e synuar, me qëllimin për të siguruar bashkekzistencën harmonike midis studentëve dhe besimeve të ndryshme. Veçanërisht në vendet ku shumica e madhe e popullsisë është e një besimi të caktuar, manifestime pa kufizim të respektit dhe simboleve të asaj feje,

për sa i përket vendit dhe mënyrës së shprehjes, mund të përbëjnë trysni ndaj studentëve të tjerë, që nuk e praktikojnë atë fe, apo ndaj atyre që ndjekin një besim tjetër”.⁷

Në këtë çështje⁸ problemi i të drejtave të grave për barazi ishte një çështje substanciale për këtë vendim. GjEDNj-ja nuk e ndryshoi ndalimin nga Turqia të mbajtjes së shamive islame në mjediset e Universitetit. Gjykata vendosi unanimisht se kishte ndërhyrje në të drejtën e myslimanëve të shfaqnin fenë e tyre, por kjo ndërhyrje që parashikohej me ligj dhe e mbështetur në parimin e laicizmit dhe barazisë së grave dhe burrave, ishte e ligjshme.

Në çështjen “*Leyla Sahin kundër Turqisë*”, Gjykata për herë të parë shpalli se parimi i barazisë gjinore ishte “një nga parimet kyç që përshkonin Konventën”⁹. Gjykata nuk e diskutoi shprehimisht kuptimin e barazisë gjinore dhe se si veprimet e kërkueses kërcënonin të drejtat e grave, apo se si parimi mund të përlligjte ndalimin e një gruaje në moshë madhore të ndiqte atë që dukej se ishte një praktikë e përqaftuar lirisht dhe me rëndësi personale.¹⁰ Gjithashtu ajo nuk hetoi

pasojat që do të kishte ky ndalim për kërkuesen¹¹ dhe për mijëra gra të tjera në Turqi, të cilat nuk do të mundeshin të kishin qasje në arsimim. Në këtë mënyrë, dukej sikur Gjykata e përjashtoi Leylan dhe gra të tjera që mbanin “shaminë e fesë islame” nga kategoria e grave, të drejtat dhe barazia e të cilave duheshin mbrojtur.

GjEDNj-ja është përballur së fundmi me çështje që lidhen me lirinë e besimit fetar për shtetet që dëshirojnë të minimizojnë efektin e ndikimit të besimit fetar në shoqëritë e tyre. Këtu vendoset një peshë e veçantë për qëllimin e deklaruar të shtetit të parandalimit të çrregullimeve dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Shembull: Çështja “*Këze dhe të tjerët kundër Turqisë*”¹² kishte të bënte me një kod veshjeje që ndalonte mbajtjen e shamive të kokës nga vajzat në shkollë, ku u pretendua se kjo përbënte diskriminim në bazë të besimit fetar, sepse mbajtja e

ishte shumë e bindur për të mbajtur shami, sa që e shpuri çështjen në GjEDNj dhe shkoi në Vjenë për të studiuar. Për më tepër, ajo deklaroi shprehimisht se nuk synonte të ushtronte ndonjë ndikim te gratë e tjera për të mbajtur shami.

11. Ndalimi jo vetëm e pengoi atë që të studionte në Turqi, por mund ta ketë penguar edhe të jetojë në Turqi, meqenëse ajo nuk do të kish mundësi të ushtronte mjekësinë aty. Kjo gjë pati një ndikim negativ jo vetëm në jetën e saj, por edhe në shoqërinë turke.

12. Köse and others v. Turkey

7. Senay Karaduman kundër Turkey, Vendim, Nr. 16278/90, 3 maj 1993.

8. Leyla Sahin kundër Turkey, kërkesa Nr. 44774/98, Vendimi i 29 qershorit 2004.

9. Në paragrafin 107 të Vendimit.

10. Kërkuesja pretendonte se atë nuk e kishin detyruar të mbante shami, por se ajo e konsideronte këtë si detyrë fetare. Ajo

shamive të kokës ishte një praktikë fetare myslimane. GJEDNJ pranoi se rregullat që lidhen me veshjen nuk lidheshin me çështje të përkatësisë në një besim fetar të caktuar, por ishin hartuar të ruanin neutralitetin dhe shekullarizimin në shkolla, gjë e cila do të parandalonte çrregullimet si dhe të mbronte të drejtat e të tjerëve nga ndërhyrjet në besimet e tyre fetare. Për rrjedhojë pretendimi u konsiderua të ishte i pabazuar dhe i papranueshëm. Një qasje e ngjashme u ndoq edhe në një çështje e cila lidhej me kodin e veshjeve për mësuesit.¹³

6. Konkluzione

Shteti dhe ndërmarrja e politikave të tij luajnë një rol të jashtëzakonshëm në evitimin e konflikteve dhe në baraspeshimin e ekzistencës së komuniteteve fetare në një vend. Sipas së drejtës ndërkombëtare, shtetet në politikën e tyre e kanë detyrim për të ndaluar dhunën dhe diskriminimin në çështjet e besimit fetar. Ne mund të parandalojmë diskriminimin me bazë fetare, duke filluar me

respektimin e të drejtave të të tjerëve. Toleranca fetare, përfshin respektimin e besimtarëve të feve të tjera, pa i paragjykuar ato. Kjo gjithashtu nënkupton refuzimin për të diskriminuar të tjerët në punësim, strehim dhe qasje ndaj shërbimeve publike, për shkak të besimit tjetër.

Pra, të gjithë ne si shtetas dhe individë të lirë, kemi të drejtën dhe detyrën të kontribuojmë në ruajtjen e tolerancës dhe eliminimin e diskriminimit në të gjitha çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut, sidomos mbi të drejtat e besimit fetar.

Rasti i shtetit shqiptar, është rasti më tipik i tolerancës fetare të shtetit dhe kjo sigurisht që ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin e shoqërisë. Pavarësisht se besimi është një e drejtë ligjore e garantuar nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare, në vendin tonë, ekzistojnë edhe raste në të cilat vërehen shkelje të kësaj të drejte. Kjo lidhet kryesisht me ndalimin e së drejtës së mbajtjes së shamisë në institucionet arsimore, por që normalisht kjo çështje paraqet vështirësi për shkak të ndeshjes së dy të drejtave themelore.

13. GJEDNJ, Dahlab kundër Zvicrës (vendim) (Nr. 42393/98), 15 Shkurt 2001 (ECtHR, Dahlab v. Switzerland (dec.) (No. 42393/98), 15 February 2001).

Bibliografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, 2017;
 2. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), 1950;
 3. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948;
 4. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 1966;
 5. Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, 1969;
 6. Akti Final i Helsinkit, 1975;
 7. Deklarata e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Jotolerancës dhe Diskriminimit të bazuar në Fe ose Besim, 1981;
 8. Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Personave të Minoriteteve Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, 1992;
 9. U. Luarasi, “Historia e shtetit shqiptar”, Tiranë, 2010;
 10. Anastasi, A., “E Drejta Kushtetuese”, Tiranë, 2010;
 11. Ligji nr. 10 056, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Islam Shqiptar për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”;
 12. Ligji nr. 10 057, datë 22. 01.2009 “Për ratifikimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”;
 13. Ligji nr. 10 058, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshitës Botërore Bektashiane për rregullimin e Marrëdhënieve të ndërsjella”
- Departamenti i Shtetit të Sh. B. A. Mbi lirinë fetare – Shqipëria. Faqe zyrtare e DASH;
- <https://www.coe.int/web/portal/home>

Hafiz Mustafa Doraci (1894-1974)

“Hafizi i vogël”

Abstrakt

Një nga figurat e shquara të teologëve tiranas është edhe Hafiz Mustafa Doraci, i cili me aktivitetin e tij si mësues e teolog, ka lënë emër në historinë e arsimit në Medresenë e Tiranës dhe si imam xhamie.

Vitet që kaloi në Stamboll ishin nga më të rëndësishmet për formimin e tij kulturor, të përgjithshëm e fetar, shoqëruar dhe me dashurinë për atdheun. Mustafai vazhdoi studimet e larta për teologji, si dhe mësimin e Kur'anit përmendësh për Hafiz, së bashku me Hafiz Musa Bashën nga Elbasani, i cili do të tregonte më vonë, kur erdhi në krye të Komunitetit Mysliman Shqiptar, se Hafiz Mustafa Doraci ka qenë nxënës i shkëlqyer. Të dy diplomohen për teologji dhe morën titullin e lartë “Hafiz”. Hafiz Musa Basha kthehet në atdhe, ndërsa Hafiz Mustafai ushtroi detyrën e Hafizit në xhami të ndryshme me emër në Turqi si: Xhaminë e Sulltan Fatibut, të Sulltan Selimit, të Mahmut Pashës e Haxhi Pashës.

Në detyrën e imanit fitoi zemrat e besimtarëve, me sjelljen e diturinë dhe përkushtimin ndaj kësaj detyre, veçanërisht në këndimin e Kur'anit përmendësh, me ndjenjë të thellë, bukur e saktë, prekte thellë shpirtit dhe degjuesve. Ditët e premtë dhe muajt e Ramazanit besimtarët mbushnin plot xhaminë për të ndjekur imamin e tyre, “Hafizin e vogël”, siç filluan ta quajnë (sepse kishte trup të vogël).

Një nga figurat e shquara të teologëve tiranas është edhe Hafiz Mustafa Doraci, i cili me aktivitetin e tij si mësues e teolog, ka lënë emër

në historinë e arsimit në Medresenë e Tiranës dhe si imam xhamie.

Hafiz Mustafa Doraci lindi në Tiranë në vitin 1894 dhe vinte nga një familje me tradita patriotike e fetare.



Mustafa Doraci

Ai e kaloi fëmijërinë e tij pranë familjes në Tiranë, por aksidentalisht, në moshën 7 vjeçare, pësoi një dëmtim në shtyllën kurrizore dhe i ati e dërgoi në Stamboll për ta kuruar, pranë të vëllait më të madh, Beqirit, që ndodhej aty për studime. Pas shërbimeve mjekësore të kujdesshme, shërohet plotësisht dhe i ati e lë pranë të vëllait, për të kryer studimet që nga cikli fillor deri në të lartin. Malli për familjen dhe atdheun nuk iu shua kurrë. Në moshën e rinisë, jeta e tij bëhet më e gjallë.

Vitet që kaloi në Stamboll ishin nga më të rëndësishmet për formimin e tij kulturor, të përgjithshëm e fetar, shoqëruar dhe me dashurinë për atdheun. Mustafai vazhdonte studimet e larta për teologji, si dhe mësimin e Kur'anit përmendësh

për Hafiz, së bashku me Hafiz Musa Bashën nga Elbasani, i cili do të tregonte më vonë, kur erdhi në krye të Komunitetit Mysliman Shqiptar, se Hafiz Mustafa Doraci ka qenë nxënës i shkëlqyer. Të dy diplomohen për teologji dhe morën titullin e lartë "Hafiz". Hafiz Musa Basha kthehet në atdhe, ndërsa Hafiz Mustafai ushtroi detyrën e Hafizit në xhami të ndryshme me emër në Turqi si: Xhaminë e Sulltan Fatihut, të Sulltan Selimit, të Mahmut Pashës e Haxhi Pashës.

Kongresi i Parë Mysliman i mbajtur në vitin 1923, realizoi krijimin e mëvetësisë së Komunitetit Mysliman Shqiptar, që përfaqëson një ngjarje të shënuar jo vetëm për jetën fetare e shoqërore, por edhe për jetën politike kombëtare.¹

Hafiz Mustafa Doraci njihet me ngjarjet e reja të ndodhura në vendlindjen e tij dhe kthehet në atdhe pranë familjes me vullnetin dhe pasionin që kishte për t'i shërbyer Fesë islame në vendin e tij. Menjëherë paraqet dokumentet e shkollimit në Komunitetin Mysliman Shqiptar dhe më datë 10.01.1925 emërohet imam në xhaminë e Met Fires (sot shkolla Sami Frashëri).

Në detyrën e imamatit fitoi zemrat e besimtarëve, me sjelljen e diturinë dhe përkushtimin ndaj kësaj detyre, veçanërisht në këndimin e Kur'anit përmendësh, me ndjenjë të thellë,

1. Shpuza, Gazmend, gazeta "Drita Islame", nr. 4 (135), shkurt-mars 1998: 2.

bukur e saktë, prekte thellë shpirtrat e dëgjuesve. Ditët e premtë dhe muajt e Ramazanit besimtarët mbushnin plot xhaminë për të ndjekur imamin e tyre, “Hafizin e vogël”, siç filluan ta quajnë (sepse kishte trup të vogël).



Hafiz Mustafa Doraci gjatë një ore mësimi në Medresenë e Tiranës

Siç thonë vajzat e tij, që nga viti 1927 ai është emëruar mësues i Kur’anit në Medresenë e Tiranës, e kështu Hafiz Mustafait iu plotësua dëshira që të ishte njëkohësisht edhe mësues që të formonte një grup nxënësish, të cilët do të mësonin Kur’anin përmendësh e të bëheshin hafiza.

Formulimi i qartë i kërkesave dhe organizimi i mirë i orës së mësimit solli rezultate në mësimin e Kur’anit.

Mësuesi Hafiz Doraci gëzonte autoritet e respekt te nxënësit në atë mënyrë që, sapo hynte në klasë nxënësit ishin të përgatitur nga ana psikologjike për mësim. Me diturinë, me kulturën dhe me zotërimin e gjithë Kur’anit përmendësh, ai të magjepste me memorien e saktë

të çdo ajeti (fragmenti) kur’anor të çdo kapitulli. Ai punonte në mënyrë sistematike për ta mbajtur të freskët memorizimin e tij, Kur’anin Famëlartë.

Krijimi i një atmosfere të shëndoshë bashkëpunimi mësues-nxënës, angazhimi i tyre në këtë proces dhe niveli cilësor i arritjes së nxënësve në Kur’an tregonin autoritetin pedagogjik të Hafizit. Ai dallohej për figurën e pastër morale, shembull në punë, familje e jetë, që nuk e ndan fjalën nga veprat.

Shteti komunist, gradualisht, i shkurtoi fondet për financimin e Medresesë derisa në vitin 1964 e mbylli si institucion fetar. Hafizi e përjetoi me dhimbje të madhe këtë ngjarje pasi kishte një periudhë mbi 35 vjeçare si mësues i kësaj shkolle. Ai mbeti në detyrën e dytë si imam në xhaminë e Met Fires, por edhe për këto institucione kishin filluar goditjet në opinionin e gjerë, me ofendimet nga më të ulëtat të kuadrove fetare dhe besimtarëve myslimanë që frekuentonin xhamitë. Në vitin 1967 filloi lufta radikale kundër fesë, që çoi deri në shkatërrimin e institucioneve dhe objekteve të kultit.

Hafiz Doraci mbeti i mbyllur në shtëpi, i brengosur thellë në shpirt, sepse e zhveshën nga petku fetar, me të cilin kishte lidhur jetën. Të gjithë jetën ai ia kushtoi Fesë islame.

Siç tregojnë vajzat e tij, ato nuk ia ndanin sytë babait të tyre, i cili sa

vinte po rëndohej dhe herë pas here ndjente dhimbje therëse në zemër. Zemra e tij lëngonte çdo ditë, por ai nuk ankohej asnjëherë. Trupi i tij mbeti pa jetë më 1974 dhe shkëputi

lidhjet nga kjo botë provizore lëndore.²

2. Për më tepër, Xhemal Balla, “Hafiz Mustafa Doraci”, Tiranë, 2011: 17-42.

Lufta e jetës dhe misioni i njeriut

Haki Sharofi

Abstrakt

“Misioni i Njeriut” është me dalë fitues në “Luftën e Jetës” tue realizue kërkemat legale qi formojnë lumtërin e tij.

Krijesat e gjalla të Krijuesit përmbledhen në dy grupe të mëdhej: Njeri e Shtazë. Veç këtyne kemi edhe do krijesa të padukuna nën emnin Engjell...

Engjejt janë të pajuem me fuqi arsyetuese; s’kanë epshe, ambicje dhe egoizëm, e pra, s’hanë, nuk pijnë, nuk flejne, s’lejnë, s’pjellin, gjykojnë gjithmon drejt.

Shtazët, përkundrazi s’kanë fuqi arsyetuese, e pra, s’kanë cilësi shpirtnore e morale, ata kanë vetëm epshe e lakmi barku. Kanë disi një dashuri për pjelljen e vet por kjo u fiket shum shpejt.

Njeriu është veshë me të dy këta cilësi të kundërta, cilësi shtazore e cilësi shpirtnore qi përpiqen të venë poshtë njëana tjetrën. Njeriu dubet të jetë shum i fortë qi t’i pajtojë e t’i harmonizojë këto dy cilësi. Prandaj njeriu del më i naltë se kreatyrat tjera.

Njeriu është shtazë; pra, ka epshe, ambicje e dëshira, prandaj ka nevoj me ngrënë, me pi, me shijue e me u kënaqë. M’anë tjetër ka arsytet me të cilën gjykon edhe e shef se natyra i u përgjigjet dëshirave të tija për një kohë shum të shkurtë, e jo përgjithmonë. Han e pin, por mbas tri a katër orësh kërkon prapë me hangër e me pi. I ndizet lakmija për kënaqat seksuale, kënaqet; por mbas një kohë kërkon prapë.

Mirpo, si thamë, njeriu ka edhe një pajë tjetër, pajën shpirtnore me të cilën i përngjan Engjellit, e kur shef se kënaqet materjale fiket shpejtë, j’a liron frenat mendes, e cila gjykon dhe arsyeton edhe e shtyn njerin me kërkue vend në sferat e amshueme; por, për këto sfera s’ka mjet. M’pëhet e dishpërohet, por shpejton në ndihmë shpresa, i ep kurajo dhe j’a forcon Vullnetin. Del Feja m’atë anë edhe i thote se “Idealet e amshueme” do t’i realizoje njeriu nëpërmjet të veprave të mira qi të kryejë në këtë botë, qi kështu çdo gjë t’a fitojë me djersen e ballët e jo gati. Njeriu nuk e dishiron gjën e bame gati, por kërkon t’a fitojë vetë.

Nisjativa për dhantin e “Dhantin e Ramazanit 1351” ka për qëllim me lëshue në dorë të lexuesve një mjet të dobishëm për t’u argëtue në natat e gjata e të ambla të Ramazanit. Por tue mendue se shum vetë në Ramazan sillen në një mënyrë jo aqë të pajtueshme me shenjtërin e këtij muaji e, bile shkelin edhe mâ teper disa urdhna të Zotit, e shofim të nevojshme me dhânë pak dritë mbi sjelljet qi duhet të ketë njeriu, në qoftë se deshiron me u lumtrua mbrenda kufinit qi ka caktue i Nalti Kur-an.

Muslimani i vertetë beson dhe s’ka as pak dyshim se Perëndija (Xh. Xh.) ka fuqi me krijue çdo mjet të lumtrisë së njeriut. Edhe, si shifet na i ka dhanë të gjith këta mjete. Por, veç mjeteve të panumërta e të pasosuna qi na ka falë i Madhi Zot, ka vendosë edhe ligjë të posaçme qi rregullojnë konditat me të cilat do të përdoren këta mjete.

Këta ligjë të hyjnueshme janë të patunduna e nuk përkulen mbas vullnetit t’onë. Prandaj ne duhet t’u shtrohemi aty.

Veprimi qi bajmë ne, kur rrudhim ambicjet t’ona edhe shtrengojmë vullnetin me i u shtrua ligjeve të natyrë qi ka vendosë vetë Fuqija Hyjnore, quhet “Lufta e Jetës”.

“Misjoni i Njeriut” është me dalë fitues në “Luften e Jetës” tue realizue kërkesat legale qi formojnë lumtërin e tij.

Krijesat e gjalla të Krijuesit përmbliohen në dy grupe të mëdhej: Njeri e Shtazë. Veç këtyne kemi edhe do krijesa të padukuna nën emnin Engjëll...

Engjejt janë të pajuem me fuqi arsyetuese; s’kanë epshe, ambicje dhe egoizëm, e prâ, s’hanë, nuk pijnë, nuk flejne, s’lëjnë, s’pjellin, gjykojnë gjithmon drejt.

Shtazët, përkundrazi s’kanë fuqi arsyetuese, e pra, s’kanë cilësi shpirtnore e morale, ata kanë vetëm epshe e lakmi barku. Kanë disi një dashuri për pjelljen e vet por kjo u fiket shumë shpejt.

Njeriu është veshë me të dy këta cilësi të kundërta, cilësi shtazore e cilësi shpirtnore qi përpiqen të venë poshtë njëna tjetrën. Njeriu duhet të jetë shumë i fortë qi t’i pajtojë e t’i harmonizojë këto dy cilësi. Prandaj njeriu del mâ i naltë se kreatyrat tjera.

Njeriu është shtazë; pra, ka epshe, ambicje e dëshira, prandaj ka nevoj me ngrânë, me pí, me shijue e me u kënaqë. M’anë tjetër ka arsyen me të cilën gjykon edhe e shef se natyra i u përgjigjet dëshirave të tija për një kohë shumë të shkurtë, e jo përgjithmonë. Han e pin, por mbas tri a katër orësh kërkon prapë me hangër e me pi. I ndizet lakmija për kënaqat seksuale, kënaqet; por mbas një kohë kërkon prapë.

Mirpo, si thamë, njeriu ka edhe një pajë tjetër, pajën shpirtnore me të cilën i përngjân Engjëllit, e kur shef se kënaqet materjale fiken shpejtë,

j'a liron frenat mendes, e cila gjykon dhe arsyeton edhe e shtyn njerin me kërkue vend në sferat e amshueme; por, për këto sfera s'ka mjet. Mpihet e dishpërohet, por shpejton në ndihmë shpresa, i ep kurajo dhe j'a forcon Vullnetin. Del Feja m'atë anë edhe i thote se "Idealet e amshueme" do t'i realizoje njeriu nëpërmjet të veprave të mira qi të kryejë në ketë botë, qi kështu çdo gjâ t'a fitojë me djersen e ballit e jo gati. Njeriu nuk e dishiron gjân e bame gati, por kërkon t'a fitojë vetë.

Kështu e bânë Prindërit e parë të njerzís, Ademi me Havan. Perëndija në krye të herës i u fali këtyne lumtërin e Xhennetin, por këta nuk dijshtin me e çmue sa e naltë ishte "Dhantia Hyjnore". Ishte nevoja t'a vdirshin një herë këte lumtëri e pastaj të perpiqeshin me e fitue me djersë të vet e me e meritue të mirën. U desht të bâhen mëkatar qi t'a fitojnë mëshirën e Zotit. Pra rreshqiten e me të shpejtë u përjashtuen nga Parajsa, zbritën lakuriq në faqe të tokës.

Tash njeriu duhet të këthehet prap në Parajs. Ky është misjoni i njeriut. Këte, njeriu do t'a fitojë me "Luftën e Jetës" qi përmendëm sipër. Le të flasim pra për "Luftën e Jetës" pse kështu urdhënon Kur-ani.

"Mos e harro pjesen qi të përket nga Dunjaja".

Jeta e njeriut në këte botë munt të jetë e ambël ase e idhët e lumtun ase e mjerueshme. Gjith veprimet t'ona qi i drejtohen kësaj jete kanë për

t'u shpërblye në kete jetë veprimet qi bân njeriu për hir të krijuesit do të shperblehen në jetën e pasosun. Veprat e nderlikueme me të dy jetët çmohen dhe shperblehen në të dy jetët.

Duhet ditur se shperblimi i veprimevet t'ona ka dy anë: ana qi na lumtëron dhe ana qi na mjeron. Prandaj duhet me besue se ç'do fazë të lumnueshme ase të mjerueshme të jetës s'onë e kemi pregatitë ne vetë me dorë t'onë. Mbassi çashtja qendron kështu, duhet të parashikojmë dhe të parashofim jetën t'onë t'ardhëshme. Le t'a pregatisim pra në mënyrë qi të na sigurojë një lumtëri e jo të na sjellë mjerim.

Cili është i lumtun në botë?

Përgjegja e kësaj është shumë e shkurtë: "i lumtun është ai qi plotson qëllimin, për të cilin është destinuar".

Piksëparit pra, na duhet t'a studjojmë vëhten dhe t'a kuptojmë "për çka jemi premë e përse jemi thirrë në ketë botë".

Mbassi t'a kemi caktue ketë pikë duhet t'i këthehemi përsëri vetvetes dhe t'a veshtrojmë palë "a e kemi pregatitë për qëllimin e caktuem a po jo?"

Si shifet, njeriu nuk u krijue kot më kot, por, për një qëllim të shenjtë e të lartë: Si mbas besimit të gjithë dijetarëve "ky qëllim paraveshtron dobin publike". Si mbas këtij parimi, gjithsecili detyrohet me bâ një punë qi të interesojë shoqërin njerzore, e

cila pastaj ja shpërblen këtë vepër në proporsion me kujdesin që është derdhë më të.

“Mâ i miri njeri është ai që i siguron mâ tepër dobi njerzisë.” Urdhënon Hazreti Muhammed (A. S.)

Si cili duhet t’ua dijë destinacionin e vet; këtë gjë s’mund t’ua çmojë tjetri. Pedagogët deri diku mund të japin mendim mbi këtë çështje, por shumë herë edhe këta gabohen. Prandaj edhe ne këtu po e lamë këtë problemë e po dalim n’anën tjetër:

“Si duhet me u përgatitë për qellimin e caktuem?”

I vetmi objekt që kemi në dorë e që duhet t’ua përgatisimi, është “trupi i jonë”, ku qenrojnë tri farë fuqish: Fuqit fizike, fuqit mendore edhe fuqit morale. Të trija këta farë fuqish kërkojnë forcime e zhvillime të paralela. Po të tprohet njana lagjë bijen poshtë dy tjerat.

Le të shohim herën e parë në ç’mënyrë kujdesemi për fuqit fizike.

Higjijena, shkenca e shëndetit sod ka bënë mjaft përparime dhe na e ka caktue mënyrën e preme se si duhet t’ua ruajmë shëndetin. Ajo na lajmëron si duhet e ç’duhet me ngranën e me pi, kur, ku e sa duhet me flejtë; kur e si duhet me punue; kur e si duhet me pushue.

Këto porosi të higjijenes, a pajtojnë me dispozitën e Islamizmës? Le t’i krahasojmë:

1. Islamizma urdhënon me u pastrue.
2. Urdhënon guslin e abdesin.

3. Urdhënon me u falë në një mënyrë që mbështjell gjithë levizjet trupore.

4. Urdhënon me agjënue një muaj në vjet, me hangër me masë e mos me e tprue.

5. Ndalon alkoolin, mishin e thiot, gjakun, coftinën, kurvënin, pederastin etj...

Këto dispozita të Islamizmës të përmbledhuna në pesë pikat e sipërme ç’kundërshtim kanë me higjijënë?

Mbassi këta dispozita kanë të bajnë drejt për drejt me jetën t’onë fizike, a s’është për t’ua çuditë për se nuk i respektojmë?

Këjo mungesë a nuk provon se ne s’jemi të zotët me triumfue në “luftën e jetës” mbassi s’jemi të zotët me ndalue rrezikun e shëndetit t’onë?

Tani le të shohim, në ç’mënyrë kujdesohemi me forcue fuqit mendore:

Sa është numri i shkollave që përhapin dituri në popull e sa është numri i veprave letrare që ushqejnë mendën e popullit?

Si do t’i kuptojë mejtimit e larta të njerzvet të medhej, populli i jonë i edukuem me një arsim kaqë të ngushtë?

Si do të mundemi me udhtue paralel me popujt e përparuem kurse na mungon arsimit?

“A janë baraz ata që dijnë me ata si s’dijnë”, urdhënon Kur-ani.

Po për fuqit morale ç'rrugë ndjekim?

Morali mbështetet në virtyt, prej të cilit burojnë detyrat t'ona qi janë të shumta e shumëfarësh.

Kemi thanë më sipër se “me u lumtëruet” don me thanë “me plotsue qëllimin, për të cilin jemi destinue”.

Tansija njerzore për të jetue në paq e në qetsi ka nevojë për një punim të përbashkët të krejt pjestarëve të saj. Askush s'mund të rrin dorë jashtë nga ky bashkëpunim. Ç'do njeri duhet të merret me një punë, me të cilën i sjell një dobi Shoqëris njerzore e nepër të siguron jetën e tij. Në qoftë se puna e jonë i sjell një dam shoqëris njerzore ase një pjesë të saj, atëherë duhet të hekim dorë prej saj se na damton, na dënon e na mjeron.

Ç'do punë qi të kapim, e vogël a e madhe qoftë, ka dy përfundime të dobishme: a) e mira qi i bâhet tjetrit dhe b) e mira qi i bâjmë vehtes.

Për shëmbull këpuctari i nep tjetrit këpucët e ky j'a paguën shpenzimet dhe ja shperblen mundin. Me këtë mënyrë blesi siguron kambët e tij e shitsi jetesën. Po të falsifikojë këpuctari do t'a humbë blesin e kështu do t'a damtojë vehten. Kështu është edhe tregtari e çdo zejtar tjetër. Aj qi spekulon, abuzon detyrën e vete edhe mjerohet.

Nëpunsi, të cilit i është besue një detyrë e madhe nuk duhet t'a mendojë rrogën e tij, por shërbimin qi pritët nga zyra e tij.

Duhet të marrim për sipër atë detyrë për të cilën jemi destinue e jemi pregatitë ose për ndryshe ndërlikohen punët dhe në vent të dobis shkaktojmë damin e Shoqëris, e cila herë herë kërkon edhe sakrificat të mëdha, sakrificat mundi, sakrificat kapitali, sakrificat jete e shpirti.

Për të bâ gjith këta sakrificat, qi shkojnë e prekin deri ke shpirti, nuk është punë e lehtë por tepër e vështirë. Për këtë punë duhet [me pasë] një karakter e një virtyt shumë të naltë e të fortë, me të cilët të vemë poshtë egoizmin dhe ambicjet t'ona. Me luftue me egoizmin e me ambicjet! A s'është një luftë shumë e madhe këjo?

Pastaj me ja gjetë vendin e rasën, se ku e kur duhen bâ këta sakrificat është një punë tjetër me rëndësi. Kot më kot nuk bâhen disa sakrificat të mëdha. Këta bâhen kur sjellin një dobi të madhe e të vazhdueshme.

Pra jeta e njeriut është një luftë qi s'pran kurrë. Do të luftojë me mjerimet e veta, do të luftojë me mjerimet e Shoqëris, do të luftojë me konkurentët qi ja pengojnë misjonin e tij të kulluar, do të luftojë me natyrë qi ja prish lumtërin, do të luftojë me pleqërinë, do të luftojë me vdekjen prej së cilës nuk ka shpëtim!

Ç'është kjo jetë e mbulueme me mistere? As gjâ...! Gjithmon luftë me rreziqet qi na kërcënojnë jetën, lufta e jetës, por as jeta s'është në dorët t'onë, edhe ajo vjen një ditë e fiket si kandili. Atëherë ç'është lumtëria e kësaj jete?

Shum e permbledhun: Nji shëndet i plotë, nji rregullim familje, nji qetsi shtetnore, nji punë e vazhdueshme, nji ngushullim shpirtnuer me qenë kondend me të mirën qi kemi e me u falë Zotit për ketë të mirë, me përgatitë diçka për jetën e amshueme.

Jeta e Amshueme është ideali mâ i naltë e kjo fitohet kur rregullohen veprimet si mbas ndërgegjës morale e urdhënave të amshuem të Kur-anit.

Këtu poshtë po sjellim disa nga këta urdhna për të mbyllë themën t'onë:

“Sa të kemi takat shtrojuni dhe bindjuni Zotit, për të mirën e lumtërin e vehtes s’Uaj nepni diçka nga pasurija e juajë; ata qi nuk kursehen për ket qellim, nj’ata kanë shpetue.” 64-16

“Ata qi i napin vorfëris natën, ditën, tinëz, sheshaz, ata do t’a marrin çmimin e tyne prej vet Zotit. Ata s’kanë me parë kurr frigë e mjerim.” 2-274

“Po dhatë lëmoshen sheshit është gjâ e mirë; po po t’a epni tinëz, është mâ e dobishme për ju; Perëndia ka dijeni të plotë për çka qi të punoni.” 2-271

“Po t’i nepni uha Perëndis, d.m.th. po të shpenzoni pasurin t’Uajë në virtut të Urdhrit Hyjnuer – Perëndija ju a shpërblen dy fish edhe ju fal ndjesë.” 64-17

“Njerëzve të Xhennetit ua shkepëm nga zemra mënin e lakmin; nën banesat e tyne rrjedhin lumejt,

ata thonë: ‘Lavdërojmë All-llahun qi na e fali ketë vend plot me të mira e me lumtëri. Si kur mos të na e kishte diftue Zoti ketë rrugë, ne s’kishim për t’a gjetë vetiut; Pejgamberët e Zotit me të vërtetë qenë në të drejt; Do t’u thohet këtyne të lumturve në Xhennet: Ky është Xhenneti, me të cilin ju shpërblehen veprat t’uaja.’” 7-43

“Uroni ata qi ju besuen se do t’u nepet Xhennete, ndër të cilat rrjedhin lumj; kur të shijojnë pemët e atyhit, kanë me thanë, këta qenkan tēpki si ata qi kemi pasë hangër në dynja; sepse do t’i u përgjajnë atyne; Këta do të kenë edhe shoqe të ndershme e aty kanë me qenë gjithmonë...” 2-24

“All-llahu është Aj qi ndërtoi qiellnat pa mbështetje si e shifni; mbasëndej zû Arshin; rregulloi Diellin e Hanën, të cilët i shtrohen këtij rregulli deri në kohën e paracaktueme; Perëndija rregullon ç’do gjâ; çfaq shenjat e veta, deri sa të ju mbushet mendja qi t’a besoni se keni për t’u takue me Të.” 13-2

“All-llahu është Aj, veç të cilit s’ka tjetër Zot; është i Amshuem; zotnon edhe përmban gjithsin; as nuk dremit, as nuk flen; ç’do gjâ në qiell e në tokë është e Tija; Cili është aj qi mundet me bâ shefaat pa pasë lejen e Zotit, Aj din ç’do gjâ e diturin e Tij s’e kap dot askush, veç ndonji qi ka fitue hirin e Zotit mund të dije çka i ka përmetue Vullneti Hyjnuer. Diturija e Zotit është shtri dhe ka mbulue krej qiellnat e Dheun, mbrojtja e të cilave

nuk formon barë të rëndë për Të; i Naltë e i Madhnueshëm asht vetëm Madhnija e Tij.” 2-255

“Gjith ç’ka në qiellna e në dhë lavderojnë dhe lartësojnë të Madhin All-llah, i cili është i plot pushtetshem dhe i çdoditur; zotnon dhe sundon qiellnat; ep e merr jetë; ç’do gjâ është në kompetencën e Tij; është i mbrapmi, është i çfaquni; është i mbrendëshmi; është i pari ‘Aj din çdo gjâ; Aj krijoi qiellnat e dheun për gjashtë ditë e mbasëndej rregulloi Arshin, prej kah sundon çdo gjâ. Aj din çdo gjâ qi hyn në tokë, çdo gjâ qi zbret prej qiellit e çdo gjâ qi ngrihet në qiell. Ku do qi të jeni Aj është bashkë me ju; brumi i gjithësis qiellore e toksore është krejt i Tij; të krejt ju keni për t’u këthye tek Ay. Aj pru ditën mbas natës e natë mbas ditës; Aj i din krejt idët e mshefta qi ka çdo njeri...” 57-16

“Lavderimet e miradijet janë të posaçme vetëm për All-llahun, qi është Zoti i gjith botave; Aj është Bâmirës e Mëshiuarës; Zotnuesi i Ditës së Fesë. Vetëm Ty – O Perendi – Të falemil Vetëm ty të lutemi me na ndihmue. Falna rrugën e drejtë, ate rrugë qi u a falë të mirëve e jo rrugën e atyne qi i more mëni, as rrugën e të prapëve. Amin.” 1-1...7

“Thuaj, Aj All-llahu është nji; Asht All-llahu tek i cili gjejnë strehë të gjit; nuk ka pjellë edhe nuk ka lé; edhe nuk ka ndonji shembull.” 112-1...4

“Aj qi ka nën urdhen të vet pronin e gjithësis është shumë i

Naltë, edhe Aj është i zoti për çdo gjâ. Aj krijoi gjallnin edhe vdekjen qi të Jua provojë se cili prej jush do të veprojmë mâ mirë; Aj është madhështor e Përdëllimtar. Aj krijoi shtatë qiellnat palë palë e në krijimin e Tij s’mund të gjeni ndonji të mëtë, ktheni syt kah qielli naltë a mund të shifni ndonji mungesë të vogël? Përsëritnije ketë veshtrim; prapë se prapë syt t’uajë ju rrotullohen pa gjetë kund nji të metë e nji mungesë.” 67-1...4

“Aj All-llahu ka në dorë çelësat e të mësheftës (gajb); atë vetem Aj e din; Aj din të ramit e gjithëvet nga drût; Kokrrat në errsinën e dheut, të njoma a të thata qofshin, janë të përfshime në Kur-anë.” 6-59

“Të shtatë qiellnat edhe toka si edhe gjith çka në to lavdërojnë e naltësojnë Madhnin e Hyjnueshme edhe nuk ka gjâ qi mos t’a naltësojë Perëndin. Por ju nuk e kuptoni si e kryejnë ata këte lavdërim e naltësim.” 17-44

“Gjith ç’jan në qiellna e në tokë janë të Zotit; për çdo qi kemi në vehte, çfaqkeni ase e mshefkeni All-llahu do të ju kërkojë llogari.” 2-284

“Po të keni për qëllim të mirën edhe hirin e Zotit e paqin e njerzis, mos e bâni bën pengim; Perëndija ndigjon edhe di çdo gjâ.” 2-224

“All-llahu nuk ju qorton pse bâni bé të rrejshme por ju qorton për çka zemrat t’uaja kundërshtojnë fjalën; Perëndija është përdëllimtar dhe i butë.” 225-2

“Beto hme për natën qi mbulon botën me errsinë, edhe betohem për ditën qi bijë dritë dhe çduk errsinën e natës; betohem edhe për Atë qi krijoi mashkullin e femnën, se veprimi i juajë ka qëllime të ndryshëm. Ndër ju, ata qi njofin dhe napin të drejten e tjetrit, ata qi largohen nga çdo e ligë edhe ata qi ndjekin e vërtetojnë punë mâ të mirë, kanë me u lehtësue në mbarimin mâ të mirë. E ata qi janë neqesa, ata qi nuk shofin nevojë për Zotin, edhe ata qi mohojnë të vertetën e i thonë rrenë gjâs mâ të mirë, kanë me u lehtësue në një mbarim shumë të vështirë.” 92-1...10

“Bâj bé për ata kuaj të luftarëve qi msyjnë me krahnuer të hapët, për ata qi nxjerrin xixakur përpjekin kambët nëpër gurët e fushë së luftës, për ata qi mësyjnë armikun në mëngiez, për ata qi ngrenë fluturimin perpjetë, për ata luftarë qi çajnë rrjeshtat e armikut edhe futën mbrenda, për krjet këta bâj bé – se njeriu âsht bukëshkalë edhe nuk njef të mirën e Zotit; ketë gjâ e dishmon edhe aj vetë; njeriu âsht i dhanun tepër mbas interesit të dynjasë; A nuk e din se ç’bâhet, po të duken gjith ç’ka mbrenda nëpër vorre e po të çfaqen krejt të msheftat e zemrave? Pa dyshim All-llahu di ç’do gjâ dhe e ndeshkon.” 100-1...11

“Kur do të lëkundet toka nga termeti e kur do t’i njerrë përjashta të rëndat e veta, edhe kur do të thotë njeriu ‘Ç’âsht këjo punë?’, atë ditë dheu do të flasë e do lajmërojë çdo gjâ, me qenë se yt Zot ja inspiron

këto lajme. Atë ditë njerzija vijnë të shpërdamë për me pá veprat e veta; kush të ketë punue një grimë mirsi, atë ka për t’a pá; e kush të ketë punue një grimë ligësi, ate ka për t’a pa.” 99-1...8

“Kur të shkallmohet qielli; kur të derdhen e të shregullohen yjt; kur të marrin valë detete e të bashkohen midis tyne; edhe kur të perzihen vorret e të qesin jashtë atë qi kanë mbrenda; nj’atëherë çdo njeri do të kuptojë fije për fjie ç’të ketë punue në krye e në fund.” 82-1...5

“Kur të mbështillet e të rrokulliset Dielli; kur të errtohen yjt e të bijen në tokë si shi; kur të shkepen e të grimcohen malet; kur të mbeten shterpá shtázët, kur të vëlojnë e të përzihen detnat; kur të këthehen shpirtinat nëpër trupa; kur të pyetet mëkati i atyne q’u varrosen për së gjalli; kur të shpallosen fletët e librit; kur të rripen qiellnat si rripet lëkura; kur të këndellet Xhehennemi e kur të afërohet Xhenneti, njatëherë ka për t’a marre vesht gjithsecili të mirën e të keqen qi ka punue.” 81-1...14

“Asht shumë i naltë Aj qi j’a çoj rrobit të vet Kur-anin qi dán të drejtën prej së shtremtës, për të përfriksue gjith kombet; proni i qiellnave dhe i tokës janë të Tijat; Aj nuk ka bir (djal); s’ka shok në begati; ç’do gjâ e krijoi sa lypset dhe e caktoi sa duhet.” 25- 1 e 2

“Beto hem në yjt qi perëndojnë, se shoku i juaji Muhammeti kurrë

nuk ka dalë prej rruge e kurrë nuk ka bâ gabim, nuk ka folë kurrë prej mendes së vet; kuptimet fetare qi ka bâ janë zbulime Hyjnore; këta zbulime Hyjnore j'a mbsoi i Fort-fuqishmi." 53-1...5

"A e shifni zjarmin qi ndizni; drunin e tij a ju e goditët, a po Ne? Ne kete zjar e bâm një shenjë të mrekullueshme qi të çuditëni; kush veshtron me kujdes e çmon fuqin e Zotit edhe gjith njerzit shofin dobi prej zjarit; mbassi puna është kështu, atëherë lavdero dhe naltësò emnin e madh të All-llahut. Nuk betohem për pozitë e yjvet, - ky betim është shumë i madh! – se me të vërtetë ky është Kur-ani i bekue; është libri i garantuem në 'Pllakën e sigurtë, Levhi mahfudh'. Atë mund t'a prekin vetëm duert e pastra; Ky libër është ulë nga Zoti i Gjithësis." 56-71...80

"Mjer ata qi masin mëtë, mjer ata qi peshojnë mangut; të cilët kur blejnë masin e peshojnë drejt e kur shesin masin e peshojnë me mungesë. A nuk e dijnë se do të ringjallen për një ditë shumë të madhe në të cilën krejt njerzit do të qendrojnë para Zotit të gjithësis." 83-1...6

"Zoti mëshirëmadh j'a mësoj Kur-anin Muhamedit; E krijoi njerin edhe j'a mësoi mënyrën e çfaqjes së mendimit; Dielli e Hana në rrugët e tyne udhetojnë mbas rregullit të paracaktuem; Ylli e druni i bâjnë sexhde Zotit. All-llahu naltësoi qiellin edhe i vûpeshën; qi edhe ju mos t'a teproni peshën; peshoni me

drejtësi të madhe e mos e mundoni të drejtën e njerzvet." 55-1...9

"Dita qi therr e zharrit zemrat, ç'është këjo ditë e ti si e more vesh? Ajo është ditë shumë e veshtirë! Asht dita, veshtirsija e tmeri i së cilës do t'a bâjë njerzin të perzihen si fluturat; malet do të shpërdahen e do të fluturojnë si fijet e pambukut, atë ditë ata qi kanë të mirat mâ të randa do të jenë në jeten e lumtun e të kënaqun; e at qi do t'i kenë të mirat mâ të lehta se të ligat vendin kanë me e pasë në pellgun e thellë të Xhehennemit. A e dini ç'është ky vend? Asht zjarri mâ përvëlues." 101-1...11

"Táhá – O Muhammed! – Nuk t'a kemi dërgue Kur-anin për me të mundue, por ta kemi dërgue qi të predikoni e të këshiloni ata qi kanë zemrën e urtë e të butë; Kur-ani është dërgue prej Atij qi krijoi Dheun edhe qiellnat e naltë; All-llahu Plot mëshirë mbulon Selin e Sundimit të Hyjnueshëm. Janë të Tijat se ç'kanë në qiellna, në tokë, midis tyne edhe nën tokë. Në dash me folë ashiqare, fol; por Aj All-llahu e din edhe tinzin edhe të msheftën edhe çka të shkojë nëpër mend. All-llahu asht Aj, veç të cilit s'ka mâ Zot tjetër; Emnat e Bukura janë të Tijat." 20-1...8

"Bâj bé në kohën e sillës, bâj bé edhe në natën qi mbulon nën errsinën e vet ç'do gjâ; baj be në kta se yt Zot nuk ka heqë dorë prej teje, as nuk të ka harrue. Dije sigurisht se e Ardhëshmeja do të jetë mâ e

dobishme për ty se e Shkuemja. Yt Zot ka me të dhanë e me të kënaqë – deri sa të bâhesh ràzi – yt Zot a nuk të gjeti të vorfun e a nuk të dha strehë? A s'të gjeti në gabim ea së të drejtoi? A së të gjeti të vobegët e a së të pasuroi? Ruju fort e mos mundo të vorfnin, mos e perzê pa gjâ lypsin, edhe lavdëro e falenderò t'and Zot për të mirat qi të ka dhanë.” 93-1...11

“Këndò në emën të t'yt Zot qi ka krijuë – çdo gjâ – All-llahu e krijoi njerin nga një copë gjak të nxámë; Këndò, yt Zot, asht mâ zemërbardhi i zemërbardhëve; i cili j'a mësoi me pendë, j'a mësoi njeriut atë qi s'dinte...” 96-1...5

“Betohem në kohën e Iqendís, se me të vërtetë njeriu – qi mendon vetëm dunjân – ndodhet në dâm e në mjerim; përjashtohen ata qi besuen e punuën të mira edhe këshilluen shoqishoqit – të drejtën e durimin.” 103 -1...3

“Mos ju qasni Zináës, pse ajo ásht punë e ndytë edhe sjellja ma e ligë.” 17-32

“Mos ec mbi tokë tue lëshue hapin me madhështi se t'i kurrë s'ké për t'a ça tokën, as s'mund të matesh me malet.” 17-37

“Durò bashkë me ata qi i luten Zotit mëngjez e mramje dhe kërkajnë hirin e Zotit, e mos i tërhiq syt nga këta e mos u ep kah ata qi lakmjnë luksin e jetës së dunjasë; mos j'u bind atij qi j'a kemi nxi zemren dhe s'kujton Zotin, por i shtrohet yryshit të vet; puna e njeriut të këtillë shkon kot na – si kot.” 18-28

“Thuaju, ejani t'u diftoj çka ju ka bâ haram Zoti i juajë: Mos i shoqnoni Atij kurgjâ; bâni-u mirë prindëve; mos i mbytni fëmit t'uajë nga friga e ushqimit; se Na ju ushqejmë ju edhe ata; mos ju qasni ligsive, të dukuna ase tinëz qofshin; Mos vritni ate frymë qi ju a ka ndalue Perëndija, veç në ju lejoftë e drejta; të këtilla gjâna ju këshilloj; abolla qi të bini në mend.” 6-151

“O ju qi keni besue All-llahu! Pija, panto, statujat qi adhurohen edhe shigjetat qi hidhen n'emën të tyne janë nxitje të liga të veprës së Shejtanit; rujuni nga këta punë të këqija, në daçi me shpëtue.

Shejtani, me pijen e bixhoyin, nuk don tjetër, veç se të ju përzije e të ju ngatrojë shoq me shoq, të ju shtjerë grindje, armiqsi e meni ndër ju, edhe ka për qëllim me ju bâ qi mos t'a kujtoni Zotin e mos t'a adhuroni. A nuk e shifni t'arsyeshme pra, qi të hiqni dorë nga këta vese?” 5-90...91

“O ju qi keni besue All-llahun! Bâhuni dishmitarë të drejtë e jo të rrejshëm, saherë qi të thirreni me dishmue në emen të Zotit, qoftë këjo dishmi edhe kundra vehtes t'uajë, ase kundra prindvet t'uajë, ase kundra far' e fisit t'uaj, edhe në qofshin pasanik ase të vobegët; Perëndija kujdesohet për këta dy palë mâ fort se ju. Pra mos ju shtroni passionit e moe shtrembnoni dishmin: e në qoftë se e këtheni ase i shtëmangeni, Perëndija i di plotsisht punët qi bâni.” 4-135

“Mjerim i madh për ata qi hartojnë libra me duert e veta e pastaj, qi të fitojnë ndopak të holla, thonë se janë të zbritun prej Zotit; mjerim i madh për çka kanë shkruar duert e tyre e mjerim i madh për çka fitojnë.” 2-79

“O Muhammed! Janë kah të pyesin për jetimët; thuaju është punë e dobishme me u sjellë mirë me t’u e me ju bâ mirë; në qoftë se je qëllon qi të merrni përsipër kujdestarin e tyre, veni mendën se mos bân ndonji gabim; pse ata i keni vëllazën; All-llahu i din shpërdoruesit e të drejtët...” 2-220

“All-llahu i yt të ka dhanë urdhën të premë qi mos t’i faleni tjetër kujt veç Atij edhe të ju bâni mirë prindve; në qoftë se njani ase të dy në pleqëri vijjnë në një shkallë qi të kenë nevojë për ndihmën t’ande kurrë mos u mërzit e ruju se ju thuesh ‘Of!’ e mos ju kërtill, por folu me fjalë të ambël. Pastaj tue pasë dhimë për to ul krahët teposhtë edhe qendro para tyre e lutu tue thanë ‘O Zot i em kij mëshirë për to, si kur paten edhe ata meshirë për mue qi më kanë rritë qysh në vogjëli.” 17-24

“Nuk është bindje të këthyemit e fytyrës kah Lindja a kah Perëndimi,

por numrohet bindje vepra e atij njeriu qi beson All-llahun edhe ditën e fundit, edhe engjëllit, librat e pejgamberët, edhe u nep pasunin e ambël far’ e fisit, jetimëve, të vobegtve, atyne qi kanë mbetë rrugës, lypësve edhe skllavëve të luftës; pastaj kryen të falmen, lan zeqatin, nuk i luen fjalës e nuk e then besën; edhe duron ngushticat, shtrëngimet e fatkeqsit. Këto njerëz janë besnikë të vërtetë edhe këto kanë frigë Zotin.” 2-117

“Këndò ç’tu kumtue prej librit edhe vazhdo të falmen; se pa dyshim e falmeja të largon nga ligësinat e nga të këqijat. Me doemos të kujtuemit e Zotit është një detyrë mâ e shenjtë e ma e madhe. All-llahu din çdo gjâ qi hartoni.” 29-45

“Mjer kush perbuz gjithkënd dhe i ven shpifje.” 101-1

“Kush e kullon ndërgegjen shpëton e kush e përlyen mjerohet.” 91-9...10

“Porositi muslimankat qi mos të kenë sy në të keqe, le të mbrojnë nderin edhe le të mos çfaqin stolit e veta.” 24-31¹

1. Marrë nga revista “Zani i Naltë”, nr. 4-5, viti 8, janar-shkurt 1933, f. 531-547.

Abstracts in English nr. 37

Editorial

1. A century of “Zani i Naltë”

Msc. Andrin Rasha

“Zani i Naltë”, tribune of Albanian Muslim thought, opinion and beyond, which was addressed to lovers of reading, researchers and explorers in the native language, turns 100 years since the first day of publication. It is the first official magazine of the Albanian Muslim Community, founded by the Muslim elite of the time after the First Albanian Muslim Congress, immediately after the constitution and establishment of the institution of the Muslim Community.

Its articles deal with important topics that reflect reality and the main social and educational issues. “Zani i Naltë” analyzed and discussed the most important issues of the time, such as social and family relations, the emancipation of Muslim women, the education of children and young people, the attitude towards good and evil, the selection and adoption of the benefits of civilization of the time, opposing and abandoning social vices, strengthening religious and national brotherhood, all of this in accordance with Islamic and national norms, ethics and culture.

It should be borne in mind that this magazine, despite the fact that it appears at first glance as a magazine with religious themes, topics from various fields, including those of a secular character, were written and published in it, with the sole aim that the message they conveyed was to serve the Islamic Albanian population in particular, but also the rise and elevation of the entire Albanian nation in general.

We can say it out loud that “Zani i Naltë” was a guaranteed source for the Islamic religious education of the Albanian nation, without neglecting its nourishment with feelings of patriotism, cultural and educational upliftment.

Islamic sciences

2. The fundamental sources of the Islamic religion and civilization

Prof. dr. Qazim Qazimi

The Qur'an is a divine word, a discourse of Allah, a heavenly book, wonderful, inimitable, inaccessible neither in content nor in artistic aspect, so it is "Mu'jizatun" that was revealed to Muhammad (a.s.) through Jibreel (a.s.), conveyed faithfully by him, written down since it came down, collected in a collection called "Mus'haf", preserved, cultivated and memorized, and its reading is worship for Muslims.

As the sacred divine work that it is, the Qur'an has a wonderful aesthetic and emotional impact on Muslims who read or listen to its poetic prose. Even non-Muslims are deeply impressed by his literary impeccability and his inimitable perfection.

The Qur'an is not the work of any poet or artist. It is the Word of God; therefore, it is perfect and wonderful. All this said, it is necessary to set forth to enable the reader to understand the reasons for the style of the magical power of the Qur'an, a power which, unfortunately, the reader cannot sense in the translation, however good it may be.

Given the multiple values and themes of the Qur'an, from religious and spiritual, philosophical and social, theoretical and practical to expressive artistic ones, it is of interest to Islamic culture in general that the masters of the mind and pen, do more in illuminating the stylistic values of the Qur'an, because even here the miracle of the artistic expression of the Qur'an and the impossibility of imitating its aesthetic value, come to light.

Studies

3. "Zani i Naltë" the forerunner - founder of the Islamic periodical in the Albanian language Ramadan Shkodra

The very initiative to publish a magazine in the format of "Zani i Nalte", apart from having a special historical importance, there is no doubt that it was also a bold step that clearly showed maturity, vision, professional preparation, and above all responsibility of the Islamic religious elite of the time, to create institutions that carry out their mission before God, the country and the people.

The mission, philosophy and vision of the magazine "Zani i Naltë" become clear and understood in the main article of the first issue of the magazine, in which the initiators and the publisher express the major objectives of the magazine, where it is stated that "Zani i Naltë" aims to: "...Reveal to the Albanian Muslim people the truth of the faith in a simple

and uncomplicated way..., as well as complete the brotherhood between all the elements in Albania". This is in order to, as it is said there, "Strengthen the foundations of a sound and simple national policy in our State".

See for this, "Zani i Naltë" for a decade and a half, which has been a forum for the opinion of the Islamic and Albanian elite, which competently handled and cultivated professional topics from the national, religious, social and cultural disciplines. Here we find the wisdom and blessings of the Qur'anic disciplines from distinguished pens and enlightened minds, such as the pilgrim Vehbi Dibra and his contemporaries. We also find historical and cultural features that are very eloquent from the past of our people, without neglecting the practices related to humaneness, the cultivation of tolerance and understanding, the sublime values of our people.

4. Namazgja Mosque and the journey for its construction by Dorian Demetja

One of the primary aspirations of the Muslim Community of Albania has been the maintenance and construction of as many mosques as possible, in all possible spaces where the community of Muslim believers lies. Mosques are God's houses, in which His name is mentioned and glorified, where believers perform their worship, build and strengthen their religious life and are equipped with religious and moral knowledge. Regarding the importance of maintaining and building mosques, Allah, in the Holy Qur'an, says: "The mosques of Allah are only to be maintained by those who believe in Allah and the Last Day and establish prayer and give zakah and do not fear except Allah, for it is expected that those will be of the [rightly] guided." (Qur'an, 9:18) However, historically, mosques have been built small and over time the need for a large mosque in Tirana arose.

It is known traditionally that Tirana's Namazgja was the center of Islamic religious rites for the capital's inhabitants, where Aid prayers were offered together. The ruins of the walls and hundred-year-old cypress trees spoke of its antiquity. Therefore, the continuous demands of the Muslim Community have been that the great mosque be built exactly on the grounds of Namazgja.

The laying of the foundations for the construction of the Namazgja Mosque in Tirana was carried out on May 13, 2015, in the presence of the President of the Republic of Albania, Mr. Bujar Nishani, the President of the Republic of Turkey, Mr. Rexhep Tajip Erdogan, President of the Muslim Community of Albania, Mr. Skënder Bruçaj, President of the Muslim Community of Turkey, Mr. Mehmet Gormez, and important personalities from Albania and Turkey. The ceremony was also attended by the former Chairman of Muslim Community of Albania, Mr. Selim Muça, directors, muftis, imams, as well as a large number of citizens of the capital and beyond. After the greetings of the two presidents and the prayers made by the two heads of the Muslim communities, the

button was pressed for the pouring of concrete, where the work on the construction of the Mosque and the Namazgja Complex officially began.

History

5. Qyrjani Mosque - the first Islamic institution in the region of Kraja Hamid Alaj

The Qyrjani Mosque, or as some call it the Old Mosque, as the oldest mosque and the first Islamic institution in the Krajë-Shestan region, is one of the largest, the most important, and a work of precious value.

It is one of the most valuable examples of Ottoman architecture. In addition to this, there are also other mosques built during the Ottoman period in this area. The mosque is located at the entrance to the neighborhood of Qyrjan, from where it got its name, and in its composition includes the members (congregation) of the village of Martiq, namely the neighborhoods of this village, such as the neighborhoods of Qyrjan, Sjerçi, Kacej and the neighborhood of Ramushej.

Qyrjani Mosque is the first mosque built in the region of Kraja. The Mosque of Muriq Nalt in Shestan's territory was built in the same year. There is no other sure track about the construction date of this mosque, but based on some documents it is thought that it was built somewhere around 1602.

The mosque is not the work of a single period of construction, as its entrance had its vestibule built, and over time, that part was closed and another alcove was added to its interior, where it was built mejtepi (primary school) of the mosque. The style of the building, the width of the walls, the type of construction material, its location, give enough data to determine its age. Regarding the builder of the Qyrjan mosque, only assumptions can be made, because no inscription has been preserved to prove this precisely.

Despite all the great work that has been done during the renovation of this mosque, its original shape has not been changed, while its aesthetic appearance has changed every time interventions have been made in the object.

Philosophy

6. Islamic philosophy Msc. Ana Gjeçi

Another important and original philosophical tradition of medieval philosophy is Islamic philosophy. Islamic philosophy has made a significant contribution to the history of culture, not only in the preservation of knowledge, but also in the enrichment of new contributions, as

Western philosophy entered a “dark age”. From this approach, we understand that Islamic philosophy is a tradition of philosophy that was created between ancient philosophy and the scholastic philosophy of the twelfth century. Islamic philosophy can be described as a tradition of philosophy born from Islamic culture as a whole, since Islamic philosophy is not only expressed in the Arabic language, and others besides Muslims have contributed to its formation.

Islamic philosophy also studies the essence and purpose of objects, their beginning and end, but it goes beyond revelation and prophecy. Therefore, the beginning is God (Allah) and the end is the Last Day. Thus, the two main goals of Islamic philosophy are knowledge about God and the Last Day. Prophet-hood is not a goal of this philosophy, but a means to reach the above two goals.

Islamic philosophy, like metaphysics, does not conflict with sensory, technical knowledge and the laws of nature. It is more special than metaphysics, while metaphysics is broader than it is, because metaphysics does not base the essence of objects and the first beginning (mebde-i eu-uel) on God, on the purpose of objects and on the Last Day.

It should be mentioned that the encounter and engagement of Muslims with philosophy was by no means accidental, as claimed in the West. On the contrary, everything came quite naturally with the spread of Islam and philosophy found the “suitable land” where it could develop, from the very nature of the Islamic religion, which gives importance to knowledge and leaves room for the use of reason. In addition, Islam has served as a bridge connecting ancient philosophy with the Western one, of course, not being content only with conveying, but also with its development.

It should be noted that the schools of that time in the West were not at the level of the Muslim ones, therefore many ministers of religion and people passionate about knowledge attended Islamic schools (madrasas) in various Italian cities, such as in Sicily and Naples. Even imitating the madrasa system of that time, the first universities in Europe were founded (in Bologna, Oxford, Montpellier, Paris, Padua and Lyon). In these universities, in addition to other subjects, were taught also Islamic science and philosophy.

Translation

7. Early Hanafi authorities on the Imamate Asim Ayub

This article presents six annotated translations of excerpts on governance/political authority from early (pre-7th century Hijri) classical Hanafi works across a few genres, Islamic law (fiqh), rational theology (kalam), and Quranic exegesis (tafsir).

The majority of scholarly reflection on the imamate is found in theological works, in spite of it being a legal issue. For the Hanafis, this means in works of Maturidi theology. Our next three passages, from the 5th and 6th century Hijri, are all of this type. The first

of these comes from one of the earliest Maturidi creedal tracts, Abu Shakur al-Salimi's (d. after 460/1066) al-Tamhid, though al-Salimi may contend with that description. Apart from those texts directly attributed to Imam Abu Hanifa, this may be one of the most "Hanafi" theological works in existence. The author is nearly fully reliant, for all his positions, on the founder of the Hanafi school himself, never quoting from Abu Mansur al-Maturidi. The Ash'ari school is referenced but is mentioned under the label of heterodoxy (ahl al-bid'a), with Sunni Islam mostly assumed to be a Hanafi endeavour. The author's unique contribution to the discussion on imamate is to mobilise all three major sources of Islamic law – Quran, Sunna and consensus (ijma'), to prove its obligation, whereas other Maturidi authors would generally suffice with consensus alone, or with some prophetic narrations.

Jurisprudence

8. "Freedom of conscience and belief according to civil international principles and conventions"

Prof. Asc. Dr. Saimir Shatku, Faculty of Law, University of Tirana

Human rights represent essential rights, which originate from the fact of the existence of the human being by being born with him and as such, they enjoy special protection from state mechanisms. These rights represent the highest human goals and ideals, which, although expressed in different forms, give meaning to the affirmation and realization of human aspects of life. One of them is the freedom of belief and conscience, where for the very importance they represent in this framework of rights, their exercise is protected and sanctioned by the most important international acts.

Regarding the practice of historical developments in the world, we find that this freedom has not been applied everywhere and every time in the same way, as there have been frequent cases of its restriction in many countries of the world for reasons closely related to various political, historical, social developments, etc.

The right to conscience and the free exercise of belief is often violated by the presence of numerous forms of discrimination for that category of persons who choose to manifest their belief in the way they wish to express it. For their realization, it is necessary to combine many factors and foresee many mechanisms in order to implement them.

Among the main mechanisms that serve this purpose are the anticipation and observance of widely accepted principles of international law, which are sanctioned in acts and conventions with interstate force. Here the responsibility and obligation of the state through the effective protection of the rights of its individuals is evidenced

Personality

9. Hafiz Mustafa Doraci (1894-1974) “Little Hafiz”

One of the outstanding figures of Tirana theologians is Hafiz Mustafa Doraci, who with his activity as a teacher and theologian has left a name in the history of education in the Madrasah of Tirana and as a mosque imam.

The years he spent in Istanbul were among the most important for his cultural, general and religious formation, accompanied by his love for the homeland. Mustafa continued his higher studies in theology, as well as memorizing the Qur'an by heart to become a Hafiz, together with Hafiz Musa Basha from Elbasan, who would show later, when he came to the head of the Albanian Muslim Community, that Hafiz Mustafa Doraci was an excellent student. Both graduated in theology and received the high title “Hafiz”. Hafiz Musa Basha returned to his homeland, while Hafiz Mustafa performed the duties of Hafiz in various famous mosques in Turkey such as: Sultan Fatih, Sultan Selim, Mahmut Pasha and Haxhi Pasha mosques.

In the role of imam, he won the hearts of the faithful, with his behavior, knowledge and dedication to this task, especially in reciting the Qur'an by heart, with deep feeling, beautifully and precisely, deeply touching the souls of the listeners. On Fridays and the months of Ramadan, the faithful filled the mosque to follow their imam, “Little Hafiz”, as they began to call him (because he had a small body).

Retrospective

10- The struggle of life and the mission of man

Haki Sharofi

“Man’s mission” is to emerge victorious in the “War of Life” by fulfilling the legal requirements that shape his happiness.

The living creatures of the Creator are summed up in two great groups: Man and Animal. Besides these, we also have some invisible creatures under the name Angel...

Angels are endowed with reasoning powers; they do not have lust, ambition and selfishness, therefore, they do not eat, they do not drink, they do not sleep, they are not born, they do not give birth, they always judge rightly.

Animals, on the contrary, do not have the power of reasoning, they do not have spiritual and moral qualities, and they only have lust and greed. They have some kind of love for their offspring, but this fades away very quickly.

Man is clothed with both these opposite qualities, animal quality and spiritual quality,

which try to put each other down. Man must be very strong to reconcile and harmonize these two qualities. That is why man is superior to other creatures.

Man is an animal; therefore, he has lust, ambition and desire, therefore he needs to eat, drink, taste and enjoy himself. On the other hand, there is the reason by which he judges and sees that nature responds to his wishes for a very short time, and not forever. He eats and drinks, but after three or four hours, he wants to eat and drink again. His lust for sexual pleasure is ignited, he is satisfied; but after a while, he asks again.

However, as we said, man is also equipped with another quality, the spiritual one with which he resembles the Angel, and when he sees that material pleasures are quickly extinguished, he frees the reins of his mind, which judges and reasons and pushes man to seek a place in the eternal realms; but there is no tool for these spheres. He is numb and depressed, but hope comes to his aid, gives him courage and strengthens his will. Religion comes out on that side and tells him that "Eternal ideals" will be realized through the good deeds he will do in this world, so that everything will be earned by the sweat of his brow and not found ready. Man does not want the ready-made thing, but seeks to earn it himself.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtrton.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.

